


Shejkh Muhamed El-Gazali



E Vërteta e Hidhur

2



Muhamed El-Gazali

Ë VËRTETA Ë HIDHUR

2

Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja



Titulli në arabisht:

El-Hakkul-murr

Autor:

Muhamed El-Gazali

E Vërteta e Hidhur - 2 -

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

Redaktor:

Muhamed B. Sytari

Design & Kopertina

L.Hamja

Boton:

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Myftinia Shkodër

ISBN 978-9928-194-58-9

Shkodër, prill 2018

"Sikur njeriu të përpiquej të kënaqte Allahun me gjysmën e përpjekjeve, të cilat i shpenzon për të fituar pasuri dhe pozitë në tokë, do të kishte përshkuar distanca të mëdha në rrugën e lartësimit shpirtëror dhe moral.

Dhe, sikur njeriu të urrente djallin (shejtanin) dhe vesveset e tij me gjysmën e ndjenjave, me të cilat urren dhimbjet dhe armikun, do të kishte fituar pjesë (fat) prej pastërtisë së melekëve.

Allahu mund të pranojë gjysmë përpjekjeje në rrugën e Tij, por Ai nuk pranon gjysmë nijeti! Ose zemra të jetë e singërtë me Të, ose Ai e refuzon të tërën!"

PËRMBAJTJA

• Parathënia	7
1. A jemi ne dëshmitarë ndaj njerëzve?	10
2. Absurditet	11
3. Çfarë sugjeroni për ngritjen e nivelit të hytbeve dhe mbështetjen e mesazhit të xhamisë?	13
4. Dënimi me vdekje	20
5. Lakmitarët e shkatërrimit të familjeve	23
6. Detyra e ymetit	26
7. Urrejtja e Islamit politik është maskim i ri i urrejtjes së Islamit mbarë	29
8. Drejtimi i punëve...	32
9. Edukimi i fëmijëve	35
10. Femrat dhe varret	38
11. Fjala humanizëm	41
12. Hipokrizia	42
13. Imami që këndonte	45
14. Vëllezërit tanë koptë...	48
15. Kriza e shpirtmadhësisë	50
16. Kur'ani, mes mësimit përmendësh dhe kuptimit të tij	53
17. Kush e anuloi ajetin?	56
18. Marrëzi!	59
19. Mburravecë!	62
20. Mendja e munguar	65
21. Mëshirë për krijesat	68
22. Mexhliset e dhikrit	71
23. Njeriu, a është i lirë apo i imponuar?	74

24. Nuk janë thirrës..!	76
25. Nuk ka ngatërrim mes ajeteve...	79
26. Duam Islam shpirtëror dhe kaq!	81
27. Parimet tona	82
28. Përpara se t'i vrasë persekutimi	85
29. Përse Islami ka porositur për namazin me xhemat dhe ka obliguar namazin e xhumasë?	88
30. Qeliza shkatërrimi dhe përçarjeje	96
31. Rendja e zemrave	100
32. Rreth kuptimit të sunetit	103
33. Në xhaminë e Pejgamberit (a.s)...	107
34. Me Shpirt të thyer..!	109
35. Si dhe përse është zgjedhur ezani për thirrje në namaz?	112
36. Singëriteti	119
37. Subhanallahi ve bihamdihi!	122
38. Të fshehtat e njerëzve	125
39. Thënie të Shejkh Muhamed El-Gazalit	128

PARATHËNIA

Këto janë disa fjalë të shkurtra, apo dritësime të shpejta që përmbajnë çështje dhe dispozita, të cilat mund të jenë ndreqje të një gabimi të përhapur, ringjallje të një të vërtete të braktisur, koment i një ngjarjeje historike, apo bashkëkohore, pohim i një ideje të vyer, ose nxitje e energjive drejt një qëllimi fisnik.

Mendja besimtare është vëzhgues kuptimi që mbledh çdo gjë që prek Islamin, qoftë nga afër apo nga larg.

Ashtu siç ekzistojnë matës të fuqisë së tërmeteve, gradës së nxehtësisë, lagështisë dhe ndotjes, në një mënyrë të tillë janë edhe të interesuarit për çështjet e Islamit, të cilët vrojtojnë ato çfarë prekin vërtetësinë e mesazhit, rrugëtimin e thirrjes, problemet e ymetit të tij, faktorët e shtrirjes e të tkurrjes, të zgjimit e të hutimit dhe në fund paraqesin një përlllogaritje të saktë të asaj që kanë vrojtuar.

Kjo përlllogaritje është rreze për rrugën dhe sqarim për ata, të cilët nuk i kanë të qarta gjërat. Kjo mund të kërkojë libra të tërë të shkruar, por ne këtu u mjaftuam me disa dritësime të shpejta duke u bazuar në ndikimin e atyre që tërheqin vëmendjen dhe lëvizjen e lexuesve.

Dihet, lexuesi i sotëm zakonisht mjaftohet me pëlqimin e artikujve të shkurtër, krahas atyre të gjatë, apo shumë të gjatë. Kryesorja është që ta shfrytëzojmë këtë dëshirë për të

vendosur te lexuesi në mënyrë të shpejtë, fakte nxitëse dhe udhëzime serioze.

Nga këtu them se, fjala jonë me tematika të ndryshme që frymëzohet nga rreshtat e realitetit dhe mbështetet në nxitjen e vetëdijes së fshehur në zemrat e besimtarëve është e mjaftueshme për të qenë si drita e vetëtimës, që çan errësirën dhe ndriçon rrugën.

Këto janë mesazhe të shkurtra, por janë çelësa të shkëndijave të shumta për njerëzit xhelozë ndaj fesë dhe ymetit të tyre. Nganjëherë trajtojnë tema të besimit, të moralit, të historisë dhe të fikhut (jurisprudencës) dhe nganjëherë zhyten në realitetin tonë të gjallë për t'i vënë në lëvizje punëtorët e rrugës së Allahut, për të vendosur të drejtën dhe për të shkatërruar të kundërtën e saj.

Në kohën e sotme populli mysliman ka nevojë për këto gërshetime, sepse ngjarjet e tyre edhe pse kanë kaluar, ato sërish përsëriten me kalimin e kohës deri në atë mënyrë sa që ato, të cilat i lind e nesërmja janë pamje të së djeshmes. Mendo pak rreth këtij ajeti: "Kështu kanë thënë edhe ata që ishin përpara tyre, të njëjtën gjë sikur ata. Zemrat janë bërë identike. Ne i kemi qartësuar argumentet për popullin që është i vendosur."¹

Në këtë rrugë kam pasuar Ibn Xhevziun, sepse libri i tij "Sajdul Khatir" përmban shkrime të shkurtra, por ato janë shumë të dobishme, madje ndoshta janë më të mira se sa temat e gjata.

Unë në këtë libërth kam mbledhur tema të ndryshme nën titullin "E Vërteta e Hidhur"², të cilat m'i botonte revista

1. Kur'ani, El-Bekare: 118.

2. Libri: "E Vërteta e Hidhur" i autorit Muhamed El-Gazali ka gjashtë vëllime në gjuhën arabe. Në këtë përkthim kam sjellë disa tema nga vëllimi i katërt, të cilat kam menduar se janë më të dobishme dhe më të përshtatshme me realitetin shqiptar.

“El-Muslimune” që dilte në Londër.

Duke parë se një pjesë e madhe e lexuesve nuk u mbërrinin këto numra reviste, me gjithë dëshirën e madhe të tyre për t’i lexuar, si edhe vetë interesi im islam, vendosa t’i bashkoj në një vend të vetëm.

Një mendim kalimthi mund të jetë më i qëndrueshëm duke parë rëndësinë e tij në heqjen e pengesave, rizgjimin që lë, dyshimin që fshin dhe udhëzimin që ngulitë.

Fjala jonë, me mbarësinë e Allahut, do të mbesë shkëndijë që vetëton me iman dhe mbrojtëse e së vërtetës.

Allahu e di qëllimin tonë.

Muhammed El-Gazali

Gjithashtu, këtu kam sjell edhe disa tema të tjera nga librat e Shejkh Muhamed El-Gazalit. Lexuesi i këtyre rreshtave gjatë leximit do të vëre re vërtetësinë dhe sinqeritetin e autorit në ato çfarë ka shkruar, që edhe pse datojnë vite më përpara, janë akoma aktuale pasi autori sjell realen, të cilën e ka mësuar nga praktika e fjalës së Allahut (xh.sh) dhe Traditat e të Dërguarit të Tij (a.s). (L.Hamja)

A JEMI NE DËSHMITARË NDAJ NJERËZVE?

"Shumë herë e kam pyetur veten: A jemi ne dëshmitarë ndaj njerëzve?

Të tillë kanë qenë të parët tanë (selefët) ditën që Allahu tha për ta: "Kështu ne ju kemi bërë ymet mesatar për të qenë dëshmitarë ndaj njerëzve dhe të jetë i Dërguari ndaj jush dëshmitar".³

Ndërsa tani me çfarë do të dëshmojë ndaj njerëzve? A i kemi zgjuar gafilët (të pavëmendshmit) dhe a i kemi mësuar të padijshmit? Ne, ditën që do të pretendojmë se jemi dëshmitarë ndaj amerikanëve dhe evropianëve, do të na thonë: Mbylleni gojën, sepse duart tuaja janë lypëse, ndërsa duart tona dhënëse, ne ju ushqejmë prej urisë dhe mësoni prej nesh atë çfarë jua lartëson nivelin tuaj njerëzor!

Kjo është përgjigjja më e merituar për atë që i ka shkuar nata duke fjetur në trashëgiminë e tij të çmueshme dhe jetoi mbi sipërfaqen e tokës duke u llogaritur në peshoren e punëve me dhjetë njerëz, apo nëntë njerëz, por nuk zotëron, veçse lutjen dhe kokëfortësinë".

3. Kur'ani, El-Bekare: 143.

ABSURDITET

Ne duhet të ndeshemi me dy fronte, frontin e mohuesve të Islamit dhe frontin e injoruesve të Islamit. Secili prej këtyre dy fronteve është sherr më i keq se tjetri. Ne duam të prezantojmë Islamin e saktë, pa i shtuar dhe pa i hequr atij asgjë. Shtesat janë shtime njerëzore prej bidatesh dhe legjendash, ndërsa heqjet janë fshirje elementësh prej shpalljes së vërtetë, të cilat mund të dështojnë ndikimin e duhur të tij. Duam të mbizotërojmë udhëzimi ndaj trillimit. Sido që të jetë puna, ne nuk lëshojmë, qoftë edhe një fije peri nga ky qëndrim!

Fetarizmin e prishur nuk e rregullon, vetëm se fetarizmi i saktë dhe ilaçi i ekstremizmit dhe i neglizhizmit është kthimi në kufijtë e mesatarizmit. Mohuesit nganjëherë ndjekin metoda fatkeqe duke sulmuar të udhëzuarit me një gjuhë të ashpër. Absurditeti dhe habia ndodh atëherë, kur këta njerëz thirren për të folur për terrorizmin dhe devijimin!

Pashë në televizor balerina, në çift dhe tek, me një pamje që i mallkonte çdo njeri i drejtë dhe i ndershëm, por artistët dhe artistet që po merrnin pjesë në një shfaqje shtazore ishin armatosur për të folur kundër hixhabit dhe moralit. Të (zh)veshurat me rrobave të shkurtra paraqiteshin të mira, ndërsa simotrat e tyre të mbuluara dhe me rroba të gjata

ishin njerëz të prapambetur dhe të këqij!

A luftohet terrorizmi me artistë dhe artiste?

Kur kokat e reformimit shoqëror mund të lindin në ambiente të tilla!?

Ku janë mendimtarët, edukatorët dhe dijetarët?

Sprova (e terrorizmit) nuk mund të shuhet në këtë mënyrë, madje asaj i shtohet flaka, ashtu si zjarri, që rritet duke i hedhur benzinë.

Masat zemërohen për fenë e tyre kur shikojnë këta artistë të flasin për fé, ndërkohë që ata janë injorantë të saj. Nuk është për t'u habitur, sepse njeriu që nuk e posedon diçka, nuk mund ta japë atë.

Në qoftë se kultura e disa fetarëve është e gabuar, atë mund ta rregullojnë dijetarët e vendosur, jo artistët e ulët.

Ndoshta Çarli Çaplani në Angli i bëri njerëzit të qeshin me zgjuarsinë dhe lëvizjet e tij, por a mundet ky aktor të shuajë rolin e letërsisë, filozofisë, fesë dhe institucioneve të mëdha në mbrojtjen e së vërtetës dhe të mirësisë? Po mbështetja e mesazhit të popullit?

ÇFARË SUGJERONI PËR NGRITJEN E NIVELIT TË HYTBEVE DHE MBËSHTETJEN E MESAZHIT TË XHAMISË?

Xhamia është zemra e shoqërisë islame dhe vendtakimi i besimtarëve, nga mëngjesi deri në darkë gjatë kryerjes së të drejtave të Allahut, kërkit të udhëzimit dhe marrjes së ndihmës prej Tij (xh.sh). Ajo është burim i energjisë emocionale dhe intelektuale, veçanërisht ditëve të tubimeve, kur masat e besimtarëve rrinë në heshtje me qetësi e përkushtim përpara "imamit", ndërkohë që ai u shpjegon atyre mësimet e Islamit, u sqaron kufijtë e Allahut dhe i bën të kuptojnë atë që është në Librin e Allahut dhe Sunetin e Të Dërguarit të Tij (a.s) prej këshillave dhe moralit.

Hytbeja e xhumasë është prej ritualeve të mëdha të Islamit. Kuptimet e saj derdhen në zemra, që nga momenti i kthimit tek Allahu dhe pranimi i porosive të Tij. Prej këtu kuptojmë se, tema e saj ka ndikim të lartë dhe rëndësi të madhe.

Imami, i cili studion temën e saj dhe arrin ta përcjellë mirë atë, ka kryer një punë të madhe në pasurimin e kulturës së ymetit, udhëzimin drejt rimëkëmbjes, mbështetjen e strukturës së tij materiale e shpirtërore dhe lidhjen e të nesërmes së tij të shpresës me të kaluarën e tij të lavdishme.

Duke dashur të ngremë nivelin e hytbeve në xhami, në pozitën e saj që meriton dhe kthimin e minberit në pasqyrë të asaj çfarë përmban Islami, prej njohurive të duhura dhe edukimit të plotë, kam arritur në përfundim të këtyre sugjerimeve të shkurtra se, çfarë duhet të ketë një hytbe xhumaje prej ushqimit shpirtëror dhe kulturor:

1. Është e pëlqyeshme që hytbeja e xhumasë të ketë një temë të vetme, të qartë dhe jo të shpërndarë nëpër degë, e as në çështje të ndryshme. Hatibi, i cili zhytet në biseda të shumta i çorienton mendjet dhe i çon dëgjuesit nëpër luginë me gropë boshe dhe të largëta, shpirtërore dhe mendore. Sado që shprehjet e tij të jenë me elokuencë dhe sado që të jenë të rrjedhshme e shpërthyesë, ai nuk ka për të pasur sukses në formimin e një imazhi logjik me tipare të qarta të mësimave islame. Qartësia është bazë dhe pa të nuk bëhet në edukim, ndërsa përgjithësimi dhe paqartësia nuk sjellin asgjë të dobishme. Hytbeja e xhumasë nuk është ders (mësim) teorik, aq sa është një e vërtetë që shpjegohet dhe ngulitet.

2. Elementët e hytbes duhet të jenë të harmonizuara me njëra-tjetrën me një zinxhir logjik të pranueshëm, ashtu siç janë të harmonizuara dhëmbët e shkallës me njëri-tjetrin, pa mundim. Në mënyrë, që kur të përfundojë hatibi nga të folurit e tij, dëgjuesit të kenë arritur së bashku me të në përfundimin, që ka dashur të arrijë. Ai duhet të përzgjedhë tekstet dhe transmetimet që ia shtrojnë rrugën e këtij qëllimi.

3. Për sa kohë që hytbeja fetare thuret prej kuptimeve islame të mbështetura në "Libër dhe Sunet" dhe në gjurmët e brezave të parë të mirë (selefus-salih), atëherë fijet dhe rrjeta e saj duhet të jenë prej të vërtetave të pranueshme. Në ajetet kur'anore dhe mësimet e Sunetit të pastër ka

hapësirë boll, që të pasuron në vasë dhe këshilla; për këtë, nuk i shkon absolutisht, që hytbeja të përmbajë lajme iluzionare, e le më pastaj të fabrikua.

Nëse dijetarët kanë toleruar përdorimin e shembujve me hadithe të dobëta në punë të mira, ata e kanë kushtëzuar këtë, me mos kundërshtimin e rregullave të tërësishme islame, e as bazat e tij të përgjithshme. Në hadithet e sakta (sahih) dhe të mira (hasen) ka hapësirë të mjaftueshme për hatibin që kupton. Po ashtu në historinë e Pejgamberit (a.s), të Kalifëve të Drejtë (Rashidinë) dhe imamëve të pasueshëm, ka aq sa për të mos pasur aspak nevojë për legjenda dhe iluzione.

4. Nuk lejohet që hytbeja të përplasht me çështje të kundërshtueshme dhe as të fanatizohet për një mendim të caktuar islam, sepse xhamia bashkon dhe nuk përçan, mbledh fuqitë e ymetit me degët e besimit, tek të cilat bashkohen të gjithë, pa u zhytur në mesele që kanë vlerësime të ndryshme. Sa të shumta janë gjërat serioze dhe të mira, të cilat vlejnë për këshilla të reja dhe hytbe të suksesshme! Myslimanët kanë vuajtur shumë gjatë prej përçarjeve dhe është shumë me vend, që në xhami të gjejnë çfarë i unifikon rreshtat dhe shuan armiqësitë.

5. Mes hytbes, ngjarjeve kalimtare, dukurive përreth dhe masave dëgjuese ka lidhje, që nuk mund të neglizhohen. Ajo që ia ulë vlerën hatibit dhe ia humbë vasin (ligjëratën) e tij është të qenurit e njerëzve në një luginë dhe koha e vendi në një luginë tjetër. Për ndonjë gjë ka zbritur edhe Kur'ani gradualisht për njëzet e tre vjet, duke qenë në koherencë me ngjarjet dhe duke ia qëlluar situatave orientuese në mënyrë të mrekullueshme.

Duke qenë Kur'ani shërim për sëmundjet e përhapura

shoqërore, atëherë hatibi duhet të ekzaminojë sëmundjen me të cilën përballlet dhe ta njohë realitetin e saj me hollësi.

Dhe, kur ta njohë mirë atë, t'i sqarojë sjelljet dhe rreziqet e saj, atëherë kthehet te Kur'ani dhe Suneti dhe vendos mjekimin në vendin e sëmundjes. Kjo gjë kërkon largpamësi dhe intuitë, sepse vaizi i mangët mund të sjellë një mjekim jo të përshtatshëm, që nuk mund të ketë sukses në mjekim. Ndoshta mund të ketë gabuar që në fillim me përcaktimin e sëmundjes, e hytbeja e tij të vijë kot, edhe pse ka përmbajtur tekste të ndryshme të sakta.

6. Ka disa hadithe, që tregojnë për një shpërblim të madh nga punë të vogla. Dijetarët seriozë kanë thënë se, këto hadithe nuk janë sipas asaj që kuptohet me vështrim të parë dhe se shpërblimi i madh që kanë është për njerëzit fisnikë në adhurim dhe njerëzit e sinqertë në rrugëtimin e tyre drejt Allahut, e nuk është kjo gjë për punët e vogla që janë të shoqëruara me to. Prej këtu kuptojmë, se nuk i lejohet hatibit që hytbeja e tij t'i përmbajë këto hadithe thjesht duke i përmendur e pastaj të krijohet anarshi në fushën e obligimeve fetare, por nëse situata ia imponon që t'i përmendë këto hadithe, atëherë i përmendë të shoqëruara me një shpjegim të saktë.

7. Edukimi fetar ngrihet mbi bazën e sqarimit të aspekteve morale dhe shoqërore në Islam, shpjegimit të asaj që shoqërohet me të mirën dhe të keqen, si dhe përfundimeve të lavdërueshme dhe të dënueshme. E, nuk ka ndonjë gjë nëse anon (mbështetesh) në shpërblimin e ahiretit dhe prezantimin e asaj që Allahu ka përgatitur në ahiret për të përkushtuarit dhe për neglizhentët. Megjithëse zhytja dhe thellimi me hollësi në përmendjen e shpërblimeve të padukshme (metafizike) nuk është i domosdoshëm, por mjafton sinjalizimi me atë që ka ardhur në Kur'an dhe në

Traditën Profetike prej këtyre shpërblimeve, pa u zgjatur dhe pa u thelluar shumë.

8. Është mirë që hytbeja e xhumasë të përfshijë nganjëherë ndonjë gjë prej arritjeve të shkuara të myslimanëve të parë, qofshin ato ditore, kulturore, politike dhe prezantimin e qytetërimit të pjekur, që solli Islami, duke treguar, se burimet e këtij qytetërimi shpërthyen prej lëvizjeve intelektuale, që i frymëzoi Kur'ani Famëlartë dhe zgjuarsia njerëzore, të cilën e ndërtoi i Dërguari (a.s). Qëllimi i këtyre hytbeve, me gjithë tematikat e ndryshme, është që t'u kthejë myslimanëve besueshmërinë tek vetja dhe mesazhi i tyre mbarë botëror.

9. Dihet që ka filozofi të ndryshme të huaja dhe ide ateiste që kanë depërtuar në ymetin islam gjatë rënieve të tij historike dhe është e natyrshme që hytbeja të ndeshet me tretjen e këtyre shkatërrimeve shpirtërore dhe psikologjike tek bijtë e ymetit. Detyra e hytbes në Islam, në këto çështje, është të mënjanojë këmbimin e fjalëve pa vlerë, replikat dhe debatet e dëmshme, por edhe të prezantojë të vërtetat pozitive në Islam me fuqi dhe t'i kundërshtojë dyshimet, pa i kushtuar vëmendje përmendjes së burimeve ku janë marrë, sepse kryesorja është mbrojtja e trashëgimisë shpirtërore dhe shkencore, nuk është thelbësor cënimi i njerëzve dhe shkaktimi i disfatave të tyre.

10. Përpara se hatibi të përballet me xhematin duhet të ketë një panoramë të qartë në mendje, se çfarë dëshiron të thotë, madje duhet ta kontrollojë veten e tij, përpara se të flasë, që të sigurohet e të bindet plotësisht për saktësinë e çështjeve, që do t'i paraqesë, si dhe ndikimin paqësor të tyre, atë psikologjik dhe shoqëror.

Ai duhet të jetë i sigurt në argumentet dhe shembujt, që

do t'i sjellë në paraqitjen e ligjëratës së tij. Kështu që, nëse janë ajete kur'anore, t'i mësojë mirë përmendësh, e nëse janë hadithe t'i transmetojë me hollësi dhe nëse janë tekste letrare, apo ngjarje historike, atëherë suksesi i tij është në mirëpërdorimin e tyre, apo shoqërimin me origjinalin nga ku janë marrë.

Përgatitja e përkryer është argument i respektimit të njeriut për veten dhe për dëgjuesit e tij! Ndonjëherë njeriu mund të befasonet me qëndrime të ndryshme dhe u flet njerëzve, duke e formuluar vetvetiu atë çfarë do t'u flasë. E vërteta është, se aftësia për të formuluar (krijuar) vetë vjen pas disa kohëve të gjata praktike të përgatitjeve të mira dhe formimit të një bagazhi dituror të përshtatshëm për çdo situatë. E megjithatë, aftësia e krijimit nga vetja, nuk të ndihmon pa një mirëpërgatitje prej dijetari, i cili dëshiron ta kryejë detyrën e tij me besnikëri dhe sinqeritet. Prej dijetarëve, i cili e vlerëson dëgjimin me vëmendje të njerëzve dhe respektin e tyre ndaj asaj që thotë.

11. Të folurit pak (jo gjatë) të ndihmon më shumë në ngulitjen e të vërtetave dhe përqendrimin e ndjenjave dhe mendjeve rreth asaj që dëshiron të shpërndalet prej parimeve dhe mësimëve. Sepse, fjalët e shumta harrojnë njëra-tjetrën dhe ndoshta humbasin gjërat kryesore në rrëmujën e zgjatjeve dhe tepërimit. A nuk e ke vënë re tokën, se si ajo ka nevojë për një masë të caktuar farash që të mbijë dhe nëse mbijnë shpesh, atëherë bujku i radhon të tepërtat, për t'i dhënë të tjerave mundësinë për t'u rritur e për të dhënë fruta?! Kështu është edhe qenia njerëzore, me të cilën nuk rriten kuptimet (idetë), përveç nëse arrihet përcaktimi dhe përforcimi i tyre. Ndërsa, me fjalët e shumta dhe shkapërderdhjen e të vërtetave, dëgjuesi shndërrohet në një enë të mbyllur, ku jashtë saj rrjedhin fjalët, sado të

vlefshme qofshin ato.

Për zgjatjen dhe teprimin në fjalë ka shkaqe të njohura, prej tyre është keqpërgatitja. Sepse hatibi, i cili u flet njerëzve me tahminë dispozitash dhe këshillash, ai nuk e di në fakt, se ku ka arritur fjala e tij, a ka mbërritur kufirin e bindjes, apo jo dhe kjo gjë ia imponon të përsërisë dhe të zgjasë, e xhematit nuk i shton, vetëm se distancë.

Zgjatja ka lindur nga keqvlërësimi i kohës dhe situatave dhe atëherë hatibi mendon, se ai duhet të thotë çfarë ka për të thënë, e njerëzit duhet të heshtin me dëshirë apo me pahir, e kjo është gabim.

Rreth asaj që flitet për të folurit pak dhe shkurt, thuhet se një kryetari iu kërkua të mbajë një fjalim disa minutësh e ai tha: Më jepni afat një javë.

I thanë: Kërkojmë të flasësh çerek ore.

Tha: Pas dy javësh.

I thanë: Po nëse të kërkojmë të flasësh një orë?

Tha: Atëherë jam gati që tani!

Të folurit pak dhe shkurt kërkon ekuilibër dhe përzgjedhje, mohim dhe pohim, ndërsa fjala e lëshuar, përpjekja mendore në të është e pakët. E vërteta është, se për pesë minuta observon shumë njohuri dhe për dhjetë minuta, e pesëmbëdhjetë minuta arrin të observosh një hytbe dhe seminar të mirë.

DËNIMI ME VDEKJE

Organizata ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut kryen veprimtarinë e saj në dy anë kontradiktore. Në njërën anë, ajo vepron për të zbuluar krimet kundra njerëzimit, kudo qofshin ato, duke i bërë publike dhe duke u përpjekur për t'i pastruar shoqëritë prej këtyre krimeve. Kjo është një punë e mirë, për të cilën edhe e mbështesim. Por, në anën tjetër, ajo vepron me tërë forcën e saj për të anuluar, apo ndaluar dënimin me vdekje, nga të gjitha ligjet e botës. Kështu ajo u siguron vrasësve një të ardhme nëpër burgje, duke ngrënë e duke dëgjuar muzikë! Ky është një mendim i çuditshëm, të cilin e refuzojmë tërësisht dhe hollësisht.

Ne, përmes logjikës dhe fesë, kuptojmë se vrasësi vritet dhe humbja e jetës së tij është shpërblim i drejtë kundrejt punës së duarve të tij!

Dihet, se dënimi ka dy anë, njëra anë e tij shërben për mbrojtjen e shoqërisë dhe ana tjetër për të frikësuar të tjerët nga dënimi, në qoftë se ata kryejnë të njëjtin krim! Ky është edhe kuptimi i ajetit kur'anor "Në dënim ka jetë"⁴.

Ekzekutimi i kriminelit, i cili ka marrë jetën e një të pafajshmi, mbron jetë të tjera të shumta dhe u siguron atyre paqen dhe sigurinë. Këtë gjë kishin arritur ta kuptonin

4. Kur'ani, El-Bekare: 179.

edhe arabët e vjetër kur thonin: "Vrasja është gjëja më e dobishme për vrasjen".

E vërteta është se dënimi me vdekje është një ndalues i mirë për njerëzit me shpirt të mbushur me zullum!

Ndërsa, ana tjetër ka lidhje me vetë vrasësin. Përse të marrim përsipër të mbrojmë jetën e tij, kur ai nuk ka mbrojtur jetën e të tjerëve?

Përse të mos shijoi edhe ai shijen e vdekjes, të cilën ua bëri ta shijojnë të tjerët?

Përse ta mëshirojmë atë, kur ai nuk mëshiroi të tjerët?

Bari i keq shkulet. Pinjolli i shtrembër pritet. Dhe mëshira ndaj tij është padrejtësi ndaj dikujt tjetër!

Organizata e të Drejtave të Njeriut po ecën në rrugën që kanë shkelur ligjet e tjera njerëzore, të cilat prishin e përkeqësojnë. Sepse, gjykatat në pjesën më të madhe të shteteve tregohen të mëshirshme me vrasësit dhe nuk gjykojnë me dënime të drejta, përveç në 1/10 e krimeve të vrasjeve; e si ka qenë përfundimi? Rrethi i krimeve është rritur dhe toka nuk është tharë nga gjaku i derdhur në kërkim të hakmarrjes, apo përhapjes së krimit.

Nëse, sikur çdo vrasës të ishte vrarë, numri i krimeve do të ishte zvogëluar deri në kufijtë e zhdukjes së tij.

Ky dënim nuk është detyrë vetëm për vrasësin dhe kaq mjafton! Por, edhe shkatërrimi dhe fesadi në tokë meriton të njëjtin dënim, sepse nxitësit e rrëmujeve, cënuesit e nderit dhe përhapësit e terrorit në mesin e njerëzve, nuk duhet neglizhuar ndaj rrezikut të tyre për jetën e shoqërisë. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: "Për këtë shkak, ne ua bëmë obligim beni israilëve, se ai që vret një njeri të pafajshëm, apo bën shkatërtime në tokë, është sikur të ketë vrarë gjithë njerëzit mbarë. Dhe kush e shpëton atë, është

sikur të ketë shpëtuar gjithë njerëzit mbarë".⁵

Ky është një ligj i natyrshëm, sepse ne i luftojmë mikrobet dhe i zhdukim insektet e dëmshme, për të ruajtur shëndetin e përgjithshëm. Njerëzimi do të fitonte shumë në qoftë se do të zhdukte plaçkitësit e rrugëve dhe përdhunuesit e nderit dhe nuk do të humbiste asgjë nëse ata do t'i groposte nën shtresat e tokës.

Ajo që kërkohet është që kjo gjë të arrihet përmes një gjykatësi të drejtë, të pastër e të aftë. Dhe, mendoj se dënimi të kryhet në shesh përpara njerëzve, në mënyrë që të ndalojë prirjet kriminale tek disa njerëz të sëmurë, sepse drejtësia arrihet përmes faktorëve me dëshirë dhe me pahir së bashku!

Së fundmi, i tërheqim vëmendjen aktivistëve të degës së Organizatës së të Drejtave të Njeriut në vendin tonë se ne e refuzojmë neglizhimin e çdo ajeti të Librit të Allahut. Por, ne do të bashkëpunojmë me çdo njeri të ndershëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, do të qëndrojmë përballë çdokujt që përpiqet t'i thyejë ato, duke i shtrirë dorën e bashkëpunimit e të mbështetjes!

Ndërsa, ligjet tokësore, tashmë atyre u ka ardhur koha të groposen dhe për ta shpëtuar njerëzimin prej tyre!

5. Kur'ani, El-Maide: 32.

LAKMITARËT E SHKATËRRIMIT TË FAMILJEVE

Një burrë i lodhur më trokiti në derë dhe po fliste me shqetësim për familjen dhe pasurinë e tij. Ndjeva se po më kërkonte ndihmë!

I thashë me qetësi: Çfarë ke?

Më tha: Në një moment zemërimi, humba durimin dhe i thashë gruas time: "Ti je haram për mua!" Hoxhallarët më kanë dhënë fetva, se me këtë veprim unë e kam humbur gruan time dhe nuk më lejohet më kurrë.

I thashë: A i falë pesë kohët e namazit?

Tha: Po.

I thashë: Po gruaja jote?

Hezitoi pak, pastaj tha: Falet, nganjëherë...

I thashë: Po fëmijët tuaj?

Tha: Disa prej tyre falen, ndërsa disa të tjerë nuk i kushtojnë rëndësi namazit!

Heshta gjatë, sikur po kërkoja ndonjë zgjidhje për të, pastaj i thashë: Ta kthejmë gruan tënde në shtëpi, por me një kusht!

Tha: Çfarë kushti?

I thashë: Të kujdeseni për namazin, ti dhe gruaja jote, e të mbikqyrni lidhjet e fëmijëve me xhaminë, derisa

të siguroheni se ata i kryejnë rregullisht pesë kohët e detyrueshme (farz) të namazit. Ndërsa ti, duhet të kryesh edhe shpagimin (kefaretin) e betimit; të ushqesh dhjetë të varfër, nëse je i pasur, ose të agjërosh tre ditë, nëse je i varfër., dhe mbaje gruan në shtëpi!

Burri u largua dhe pas disa ditësh më erdhën hoxhallarët, të cilët i kishin dhënë fetva, se gruaja e tij konsiderohej e ndarë, me divorc të përhershëm. Më pyeten: Si i ke dhënë fetva për lejimin e gruas së tij? Ne këtu jemi maliki në medhheb dhe këtë që ka ndodhur e konsiderojmë divorc të madh.

U thashë: Medhhebi im është tjetër dhe ne shikojmë, se ndalimi i hallallit është betim, e shpagimi (kefaretin) i tij është shpagim (kefaret) i betimit. Në librin e saktë të Muslimit, transmetohet se Ibn Abasi ka thënë: "Nëse burri e bën haram gruan e tij, ky është betim dhe për të bën shpagim (kefaret)". Në një transmetim tjetër: Një njeri shkoi tek ai dhe i tha: Unë e kam bërë haram gruan time. Ibn Abasi i tha: "Gënjën, ajo nuk është haram për ty! Pastaj i lexoi ajetin: "O ti i Dërguar, përse po bën haram, atë që ta ka lejuar Allahu, duke kërkuar razinë e bashkëshorteve tuaja. Allahu është Falës, Mëshirues. Allahu jua ka bërë obligim legjitimitetin e betimeve tuaja"⁶. Ti ke për detyrë të bësh kefaret betimin tënd!

Përderisa ekziston një mendim i konsiderueshëm islam, atëherë përse të fanatizohet ndaj asaj që jemi mësuar, ndërkohë ajo që nuk e njohim, është më e mirë dhe më e përshtatshme për njerëzit!?

Njëri prej tyre dyshues, më ths: Siç duket, ti nuk e do Malikun dhe medhhebin e tij!

6. Kur'ani, Et-Tahrimë: 1-2.

I thashë: Eudhubil'lah (i kërkoj mbrojtje Allahut) prej urrejtjes së njerëzve të mirë. Unë në namaz, pasoj Malikun, ku nuk e këndoj Fatihanë, kur imami falet me zë dhe e këndoj atë kur imami falet pa zë, duke ditur, se Ebu Hanife, medhhebin e të cilit e kam mësuar, e ndalon leximin e Fatijasë, pa marrë parasysh, se imami e lexon me zë, apo pa zë! E kam parë më të arsyeshme këtu, ta pasoj Malikun!

Unë e urrej fanatizmin e verbër dhe për sa i përket çështjeve të familjes dhe marrëdhënieve shoqërore, parapëlqej çdo mendim që siguron interesin dhe dobinë publike e private dhe miratoj atë çfarë njerëzimi bashkëkohor hedh në të prej respektit të të natyrshmes dhe të drejtave të njeriut! Unë nuk jam i mashtruar, që të tërheq dyshimet e të prish imazhin e Islamit.

DETYRA E YMETIT

Duke përkufizuar detyrën e ymetit arab dhe Ligës së tyre thashë: "Allahu edukoi Muhammedin (a.s) për të edukuar me të arabët dhe edukoi arabët me Muhammedin për të edukuar me ta mbarë njerëzit. Kështu që ymeti jonë ka një mesazh të qartë, që duhet të punojë me të, të thërrasë drejt tij, të ngrejë lart flamurin dhe të ndjejë të afërmit dhe të largët për realitetin e tij. Ky është kuptimi i universalizmit të Islamit, prandaj ai nuk është rimëkëmbje arabe, ashtu siç pretendojnë, apo revolucion popullor siç broçkullisin gënjeshtarët.

Ai është mëshira e Allahut për botët dhe udhëzimi i Tij për njerëzit mbarë.

E, nëse arabët janë tkurrur në këtë kohë, janë bërë popuj copa-copa në tokë, aq sa çdo popull rend pas kafshatës së gojës dhe kujdeset për jetën e tij të veçantë, atëherë kjo është një lloj harrese poshtëruese, në mos jetë fare një kthim prapa i urryer xhahilijeti?

Megjithatë ekzistojnë grupe, e për këtë Allahut i takon falënderimi, që refuzojnë këtë gjendje dhe dinë se Islami ka një mesazh të përgjithshëm e të përhershëm. Aprior kanë lidhjen e Islamit para çdo lidhjeje tjetër dhe qëllimin e tij përpara çdo qëllimi. Ajetet në Kur'an janë të shumta për

universalizmin e mesazhit dhe për të qënurit e ymetit tonë dëshmitar i ymeteve. Ashtu siç është i Dërguari dëshmitar ndaj nesh, domethënë ne jemi kumtues të trashëgimisë së Shpalljes, ashtu si na e ka kumtuar ai neve. Jemi dëshmitarë ndaj popujve, ashtu siç është i Dërguari dëshmitar ndaj nesh. Allahu i Madhëruar thotë: "Kështu ne ju kemi bërë ymet të mesëm për të qenë dëshmitarë ndaj njerëzve dhe të jetë i Dërguari dëshmitar ndaj jush"⁷.

Ndërsa në një ajet tjetër thuhet: "Ai ju quajti myslimanë më përpara, dhe në këtë që të jetë i Dërguari dëshmitar ndaj jush, e të jeni ju dëshmitar ndaj njerëzve. Prandaj, faleni namazin, jepeni zekatin dhe kapuni për Allahun"⁸.

Jam mërzhitur kur u befasova me një person, që mohonte këto të vërteta dhe hiqte prej shpatullave barrën e Thirrjes së përgjithshme dhe i zinte myslimanët me çështje të veçanta. Pretendonte se dëshmia ndaj njerëzve është në ahiret dhe jo në dynja, e për këtë sillte një hadith, që nuk e kishte kuptuar.

I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: "Në Ditën e kiametit vjen Pejgamberi dhe me të një person. Vjen Pejgamberi tjetër dhe me të dy persona. Madje më shumë se kaq. Thirret populli i tij dhe atyre u thuhet: A jua ka kumtuar mesazhin? Ata thonë: Jo! Atij i thuhet: A ia ke kumtuar popullit tënd? Thotë: Po! I thuhet atij: Kush dëshmon për ty? Dhe ai thotë: Muhammedi dhe ymeti i tij! Thirret Muhammedi dhe ymeti i tij dhe u thuhet atyre: A ia ka kumtuar ky popullit të tij? Ata thonë: Po! Thuhet: Si e dini? Thonë: Neve na ka ardhur Pejgamberi ynë dhe na ka treguar, se të Dërguarit e kanë kumtuar mesazhin! E, kjo është fjala e Allahut: "Kështu ne

7. Kur'ani, El-Bekare: 143.

8. Kur'ani, El-Haxh: 78.

ju kemi bërë ymet të mesëm për të qenë dëshmitarë ndaj njerëzve..."⁹.

Atij që e solli këtë hadith i thashë, se ai ka ardhur me një shtesë të re, përveç atij aspekti që flet ajeti, se myslimanët janë ymet i thirrjes së përgjithshme, përfshinë popujt në të pesë kontinentet dhe kjo shtesa është, se ne jemi dëshmitarë ndaj njerëzve në dynja dhe në ahiret së bashku. Kështu që nuk ka përplasje mes ajeteve dhe hadithit, veçse në mendjet e zhurmuesve dhe mendjelehtëve!

Myslimanët, ndërkohë që mbartin me vete Librin e Allahut dhe Synetin e të Dërguarit të Tij, kanë kujdestarinë ndaj njerëzve, të cilët mbushin të gjitha anët e botës, e që nuk kanë punë tjetër, veçse të hanë e të shtrihen. Ashtu siç i nxori i Dërguari prej errësirave në dritë, duhet ta bëjnë këtë me njerëzit dhe, do të meritojnë ndëshkimin, nëse e lënë këtë detyrë të lartë.

9. Transmetuar nga Ahmedî, Nesaiu, Ibn Maxhe dhe Bejhakiu nga Ebu Seid.

URREJTJA E ISLAMIT POLITIK ËSHTË MASKIM I RI I URREJTJES SË ISLAMIT MBARË

Tha: E urrej Islamin politik dhe ndihem ngusht prej pasuesve të tij. Kam përshtypjen se pas thirrjeve të tyre fshihen qëllime të tjera!

I thashë: Termi "Islam politik" është i ri për veshët tanë! A mos ndoshta ke për qëllim ndjekjen e Islamit në fushat e moralit, adhurimit, traditës dhe grupet e tjera të legjislacionit të brendshëm, mbi të cilat ngrihet? Dhe, urren orientimet e Islamit në arenën botërore dhe në arenat e tjera politike?

Duke u munduar të shmangej, tha: Ndoshta...

Ajo, që unë di prej jetës tënde është, se ti kurrë nuk je parë duke u falur, apo të hysh në ndonjë xhami!

Tha: Këta politikanët faleshin, pastaj vranë turistët. Po qe kështu, atëherë ky namaz më mirë mos qoftë!?

I thashë: Falu me ne dhe ruaje jetën e këtyre turistëve dhe mos e lër namazin! A beson me të vërtetë në Allah?

Tha: Ata i besuan Atij, mohuan popullin dhe ua hëngrën të drejtat, ndërsa ne e mbështetëm popullin dhe qëndruam përkrah tyre. Prandaj, ky besim më mirë mos qoftë!?

I thashë: Lëri gënjeshttrat. Ne jemi të parët që luftuam zullumin shoqëror dhe thirrëm për të drejtat e popujve për një jetë fisnike dhe plot krenari. Ka një gjysmë shekulli që

kemi botuar disa libra, të cilët e bëjnë fenë mbrojtëse të të dobëtëve dhe lexojmë ajetin kur'anor: "Dhe duam t'i ndihmojmë, ata të cilët janë shtypur në tokë"¹⁰, prandaj ku ke qenë deri tani? Keni qenë duke përkrahur ateizmin dhe keni menduar se drejtësia shoqërore vjen vetëm nga Moska. Keni menduar se filozofia tokësore ju mjafton nga Shpallja e Allahut, linit namazin e shkonit pas epsheve, dhe akoma vazhdoni ta ndiqni këtë rrugë!

Urrejtja e Islamit politik është maskim i ri i urrejtjes së Islamit mbarë, dhe veprimtari dinake për fshirjen e tij nga mësimi, edukimi, shoqëria dhe shteti. Ne në Egjipt jemi përpjekur shumë duke sakrifikuar një pas një për ta bërë Sheriatin Islam burim kryesor të të gjitha ligjeve. Këtë e kemi bërë esencë të kushtetutës dhe e dimë mirë, se ajo që është shkatërruar për vite të tëra nuk ndreqet në disa ditë. Gjatë kësaj kohe kemi qenë vigjilentë që Sheriati të sundojë në çdo gjë, për të mos mbetur ligj që të kundërshtojë udhëzimet e Allahut dhe mësimet e të Dërguarve.

Por, ju ishit ngulur thellë në strofkullat tuaja duke urryer Zotin dhe të Dërguarit e Tij. Mendonit se, nuk ka zot dhe se jeta është materie. Luftonit çdo lëvizje islame me ligësi dhe mllef, nën moton e luftimit të Islamit politik!

E dimë se ka islamistë që u mungon kuptimi dhe kanë qëndrime trashanike dhe ne e luftojmë të kuptuarit e tyre të shtrembër! Ndihe mi ngusht prej tyre më shumë se sa ju, por përse përzieri mes Islamit dhe mes atyre që i bëjnë keq atij? Shfrytëzoni rastin për të goditur Islamin në zemër të tij nën moton e urrejtjes së Islamit politik? Nëse jeni myslimanë me të vërtetë, ngrini lart flamurin dhe ne do të falemi pas jush, e mallkimi i Allahut qoftë për njerëzit me

10. Kur'ani, Ek-Kasas: 5.

qëllime mashtruese!

Unë e urrej mohimin e Allahut dhe e urrej këdo që e bën Allahun të urrueshëm për robët e Tij. E urrej këdo që bëhet pengesë në rrugën e Tij dhe e shpall publikisht se komunizmi i ri nuk do të ketë kurrë vend mes nesh.

DREJTIMI I PUNËVE...

Qytetërimi i Perëndimit dallohet për posedimin e aparatit të drejtimit; zbatim i mirë dhe rezultat i lartë. Kjo gjë bazohet në tërësinë e sjelljeve morale të larta dhe dliresi e mahnitshme në përzgjedhjen e punëtorëve në fushën ushtarake dhe civile në të njëjtën kohë. Ndoqa me vëmendje zgjedhjen e Sekretarit të ri të Mbrojtjes së Amerikës dhe më mahniti natyra, e cila çoi në këtë zgjedhje. Kisha shumë dëshirë, sikur ne në botën islame, të përfitonim e të merrnim mësim!

Sekretari i ri i mbrojtjes nuk kishte rendur pas këtij posti, madje as e kishte kërkuar atë! Por, e kishte pranuar kur i kishin ngarkuar detyrën e obliguar në shërbim të vendit të tij. Ministri, të cilin e kishte zgjedhur presidenti i ri i Amerikës, në zgjedhjet presidenciale ia kishte dhënë votën, konkurrentit të presidentit, që nuk kishte fituar!? Pra, ai nuk ishte pasues i personit, që e kishte zgjedhur. Fjalë që tregon shumë, ku ajo të tregon se Presidenti i Amerikës kërkon për të aftët edhe sikur ata të jenë prej kundërshtarëve, duke paraqitur për postin personin më të merituar për të. E kjo në të njëjtën kohë, tregon se mbështetja e sekretarit të zgjedhur është për vatanin e tij, fillim e mbarim..!

E vështrova këtë pamje të ndritshme të zënies së postit

dhe kujtova brezat (selefët) e parë dhe rregullat morale, të cilat i pasonin.

Drejtimi i punëve nuk i jepet atyre që rendin pas tyre, apo kanë interesa në to, sepse kërkuesi i postit, në pjesën më të madhe të rasteve, e kërkon si dëshirë për t'u lartësuar në tokë dhe për t'u dukur në mesin e njerëzve, e kjo në Islam është diçka e ulët, ndërkohë që zgjidhet për drejtim, kush e bën detyrën (funksionin) e tij adhurim të Allahut dhe realizim të të drejtave. Auf ibn Malik transmeton se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Nëse doni, ju tregoj për drejtimin, se çfarë është ai". Thirra me gjithë zërin tim, e çfarë është ai, o i Dërguar i Allahut? Tha: "E para e tij është qortim, e dyta është dëshpërim dhe e treta është dënim në Ditën e kiametit, përveç atij që ka bërë drejtësi".

E si të bëjë drejtësi me të afërmit e tij?

Omer ibnul Hattabi i tha dikujt: Pasha Allahun nuk të dua! (Ky person i kishte vrarë vëllanë në xhahilijet).

Personi i tha: A do ma ndalojë kjo gjë të drejtën time, o prijësi i besimtarëve? Omeri i tha: Jo!

Personi tha: Nuk ka gjë, sepse frikë kam vetëm për dashurinë e grave!!

Nomadi interesohej për të drejtën (hakun) dhe nuk i bënte përshtypje nga Omeri, nëse e donte atë, apo e urrente!

Në mjedisin e drejtimit të pastër trajtohet çështja fillikat, çdo pjesëmarrës thotë çfarë anon ndërgjegjja e tij drejt saj, nuk ka vend për dëshira dhe nuk ka vend për të kënaqur ndonjë të madh, apo të vogël! Kërkimi vetëm i interesit të përgjithshëm dhe qëllimi është vetëm kënaqja e Allahut.

Në hadith ka ardhur: "Kush kërkon kënaqësinë e Allahut me zemërimin e njerëzve, Allahu kënaqet me të dhe i bën njerëzit të kënaqur me të. Dhe, kush kërkon kënaqësinë e njerëzve me zemërimin e Allahut, Allahu zemërohet me të dhe i bën njerëzit të zemërohen ndaj tij".

Bota islame është e varfër (ka nevojë) për një mjedis drejtues të pastër, që nuk i mjegullohet horizonti i tij me epshe e dyshime, dhe as e turbullon interesi dhe sëmundja! A është kjo e vështirë? Kjo ka ndodhur në vende të tjera, që i ngjan historia e tyre, historisë së baballarëve tanë të mëdhenj! Mundemi, nëse duam të përfitojmë prej trashëgimisë sonë, apo të marrim prej bashkëkohësve, armiq qofshin, apo miq.

EDUKIMI I FËMIJËVE

Prindërimi është një instinkt real në të gjitha gjallesat, të cilat jetojnë në këtë tokë! Edhe pse ne njerëzit, sakrifikojmë çdo gjë për fëmijët tanë, po ashtu edhe shpendët në foletë e tyre dhe kafshët në pyll, tek ato lëvizin instinktet e amësisë dhe atësisë. Ato i ushqejnë të vegjlit e tyre dhe i mbrojnë nga çdo e keqe, me gjithë fuqitë që kanë.

Por, aty ka një ndryshim real mes dashurisë dhe dashurisë, edukimit dhe edukimit, sepse njeriu nuk edukon vetëm trupin, por së bashku me të edukon edhe mendjen dhe ndjenjat. Përgjegjësia e prindërve e tejkalon sigurimin e ushqimit për tek sigurimi i edukimit të lartë dhe moralit të plotë.

E vërteta tregon se fëmijëria është një faqe e bardhë, ku prindërit dhe mësuesit shkruajnë çfarë të duan.

Abdullah ibn Amir tregon: Më thirri nëna, ndërkohë që i Dërguari i Allahut ishte ulur në shtëpinë tonë dhe, më tha: Eja, të të jap diçka! I Dërguari i Allahut i tha: "Çfarë deshe t'i jepje"? - Desha t'i jepja një hurmë! Pejgamberi (a.s) i tha: "Sikur ti të mos i kishe dhënë gjë, do të të shkruhej një gënjeshtëri!"

Gjithashtu Ebu Hurejra (r.a) transmeton se Pejgabmeri (a.s) ka thënë: "Kush i thotë një fëmije: Eja, të të jap diçka, pastaj nuk ia jep, ajo është gënjeshtëri!"

Prandaj, shiko se si Islami e respekton fjalën? Dhe si i

praktikon të vegjlit për ta vlerësuar dhe për ta besuar atë?

Nuk është e rëndësishme t'u sigurosh fëmijëve pasuri të madhe, por me rëndësi është t'u sigurosh mendje të zgjuar, moral të fortë, rrugë të pastër dhe ky është kuptimi i hadithit sherif: "Asnjë prind nuk i ka dhënë diçka më të mirë fëmijës së tij, se sa edukatën e mirë", e në një transmetim tjetër "Nëse një njeri edukon mirë fëmijën e tij është më e mirë për të, se sa të japë sadaka (lëmoshë)!"

Fëmijët janë mëshira e rizku i Allahut dhe prej dhuratave më të shtrenjta. Prandaj është detyrë që t'u premtojmë se prej tyre do të rrisim burra të mençur e gra fisnike.

Morali nuk është bimë kacavjerrëse që rritet e vetme, por ajo është bimë që i përzgjidhet dheu, duhet të ujitet, të krasitet dhe të mbrohet prej insekteve dhe barërave të këqija deri sa të piqet e të japë frytet e saj.

Tek fëmija ekzistojnë talente (zotësi) të fshehta që ushqehen me ato çfarë janë të dobishme derisa të kuptojnë. Kam vënë re se, televizionet japin filma për fëmijë me plot fantazi, që ngopin imagjinatën, e cila nuk ka kufi.

Jam i mendimit se, ne e kemi tepruar në këto tregime mitologjike dhe i kemi ekspozuar fëmijët ndaj disa gjërave që u mungon kontrolli. Baballarët tanë kanë qenë më të mprehtë në rritjen e memories dhe e kanë mbushur atë me lloje të ndryshme memorizimesh, të cilat bëjnë dobi në të ardhmen e afërt dhe të largët. Ne nuk e kemi memorizuar Kur'anin, veçse përmes këtyre mënyrave.

Nuk bëjnë thirrje për ta memorizuar Kur'anin nga të gjithë fëmijët, sepse kjo nuk ka ndodhur as në kohën e sahabeve dhe të tabinëve! Por, parapëlqej në aktivizimin e memories me aktivizimin e imagjinatës. Shpresoj të pakësohen filmat karton për fëmijë, të cilët i mahnisin të vegjlit, por nuk i bëjnë

dobi në kujtesë.

Edukimi në vegjëli ka nevojë për mëshirë, maturi dhe zemërgjerësi, sepse mbështetja te thupra është kotësi e dëmshme. Ndoshta fëmijët kanë nevojë për një çikë seriozitet, por ky seriozitet nuk do të thotë ashpërsi dhe frikë. Prindi i plotë e edukon fëmijën me dashuri dhe butësi.

Njerëzit në kohën e xhahilijetit (injurancës) silleshin ftohtë me fëmijët dhe mendonin se është prej burrërisë që të silleshin ashpër ndaj tyre. Një ditë, dikush prej tyre e shikoi Pejgamberin (a.s) duke puthur nipat e tij, Hasanin dhe Husejnin (r.a). I çuditur i tha: A i puthni ju fëmijët? Unë kam dhjetë fëmijë dhe asnjërin prej tyre nuk e kam puthur! Pejgamberi (a.s) iu ktheu: "A posedoj diçka për ty, nëse Allahu ta ka hequr mëshirën nga zemra jote?"

Jetimi zë një vend të veçantë në mësimet e Islamit. Në një hadith thuhet: "Kush ia përkëdhel kokën një jetimi, nuk ia ka përkëdhelur, veçse për hir të Allahut, ai ka të mira për çdo fije floku që ka prekur dora e tij! Dhe, kush sillet mirë ndaj një jetimi, apo jetimeje që jeton me të, unë dhe ai në Ditën e kiametit do të jemi si këto dy gishta! - (dhe bashkoi gishtin tregues me atë të mesit)".

Shumica e njerëzve i shohin fëmijët si një pasuri të madhe për të tashmen dhe të ardhmen. Nuk është për t'u habitur, sepse Kur'ani Fisnik e shpreh qartë këtë ndjesi: "Pasuria dhe fëmijët janë zbukurim i jetës së dynjasë"¹¹.

Në Islamin e pastër, ka hadithe të shumta për lidhjet mes prindërve dhe fëmijëve, që duhet të shkëmbehen me respekt dhe mëshirë dhe, që janë themeli i familjes së lidhur dhe shoqërisë së konsoliduar e të fortifikuar.

11. Kur'ani, El-Kehf: 46.

FEMRAT DHE VARRET

Një njeri më pyeti i zemëruar: Përse nuk i flet grave të mos i vizitojnë varrezat, ndërkohë që ti flet për gjëra të shumta?

- Mos ke për qëllim, t'u flas atyre për etikën e vizitës (së varrezave)?

- Jo, por t'i ndalosh ato, që të mos i vizitojnë në mënyrë të prerë, ashtu siç ka urdhëruar Islami!

E meta juaj është se ju, njihni një anë të vetme prej anëve të çështjeve juridike (fikhore), pastaj fanatizoheni për të dhe përpiqeni të arrini me të deri në instancat më të larta!

Eja së bashku te më i afërti dhe më i hollësishmi referim në këto çështje, te "Fikhu Sunne" i Shejkh Sejjid Sabik dhe do të shohim këtë pohim: "E ka lejuar Maliku, disa hanefi, një transmetim nga Ahmedi dhe pjesa më e madhe e dijetarëve, vizitat e varrezave nga gratë. Transmetohet në një hadith se Aisheja (r.a) po kthehej një ditë prej varrezave dhe i thashë: O nëna e besimtarëve, prej nga po vjen?"

- Prej varrit të vëllait tim, Abdurrahmanit.

- A nuk ka ndaluar i Dërguari i Allahut nga vizita e varrezave?

- Po, fillimisht e ka ndaluar vizitën e varrezave, pastaj ka urdhëruar të vizitohen!

Transmeton Buhariu dhe Muslimi se i Dërguari i Allahut, kaloi pranë një gruaje tek një varr, ku po qante për një fëmijë të vogël që i kishte vdekur dhe i tha: "Kije frikë Allahun dhe duro!" Ajo i tha: Çfarë ke ti me fatkeqësinë time... Kur ai u largua, dikush i tha se ai ishte i Dërguari i Allahut, ndërkohë ajo nuk e njihte. Ajo sa nuk vdiq prej këtij gjesti dhe i shkoi te shtëpia. I tha: O i Dërguar i Allahut, nuk të njoha!

Pejgamberi (a.s) i tha asaj: "Durimi është në goditjen e parë" dhe nuk e qortoi atë për çfarë po bënte tek varri...".

Është transmetuar një hadith i dobët nga Ahmed ibn Hanbeli: "I mallkoftë Allahu vizitoret e varrezave". Ky hadith, edhe nëse do të ishte i vërtetë, ai refuzon qëndrimin e vazhdueshëm, vizitat e shpeshta, sjelljen e trishtimit të varrezave në shtëpia dhe nxitjen e dhimbjes që nuk mbaron, e këtë e refuzon natyra normale.

U zgjata pak në shpjegimin e kësaj çështjeje, sepse kam parë disa njerëz, që nuk njohin, vetëm se një mendim të vetëm në mesele juridike (fikhere) dhe ndoshta njohin mendimin më të dobët, pastaj e ekzagjerojnë me të dhe duan t'i imponojnë të gjithë në atë mendim dhe fillojnë e ankohen se, është prishur bota (dynjaja) e feja, sepse njerëzit nuk e pasojnë mendimin e tyre!

Janë shtuar trazirat mes masave për çështje kontraktore dhe kemi parë djelmosha, që nuk zotërojnë, vetëm se lëvozhga, duan ta shqyejnë ymetin duke i dhënë përparësi një medhhebi ndaj një medhhebi, apo animin nga një mendim, ndaj një mendimi. Këta janë fitne dhe ne ua tërheqim vëmendjen njerëzve prej fatkeqësisë së tyre!

Fikhu islam është i mbushur me mijëra mendime në dispozita të ndryshme dhe kuptimi i ndryshimit të ymetit është se në këto çështje ka hapësirë. Dhe se për gabimtarin

dhe për interpretuesin kanë shpërblimin e tyre, e në Islam nuk ekziston, që dijetari gabimtar ta ketë kundërshtuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe se ai mbart peshën e gabimit të tij!

Ata, të cilët përhapin fanatizmin dhe ndezin beteja për triumfin e një mendimi të një imami ndaj një imami të ngjashëm, janë rrezik për unitetin e ymetit tonë dhe të ardhmen e tij, në kohën kur ndaj Islamit janë vërsulur armiqtë dhe kërkojnë ta zhdukin atë!

FJALA HUMANIZËM

Unë, në emër të Islamit dhe ymetit të tij, jam plotësisht i gatshëm të shpreh gëzimin tim për fjalën "humanizëm", në ditën kur të jetë titull me përmbajtje. Kur ta bëj këtë, atëherë unë kryej amanetin e fesë sime dhe nuk dal jashtë saj, madje e konsideroj prej mbështetjes së fesë: Ta konsideroj të bukurën të bukur dhe të shëmtuarën të shëmtuar, t'i dal për zot të nëpërkëmburit, të përhapim mëshirën, të mbaj drejtësi dhe të sillem butë me kafshët, bile me njeriun, çfarëdo qoftë ngjyra dhe feja e tij!

"Unë jam mysliman", do të thotë: Unë kam përqafuar një fé të natyrshme, që nderon origjinën njerëzore dhe instinktet e tij të natyrshme. Nderon mendjen njerëzore dhe rregullat e saj logjike. I parashikon gabimet dhe nuk e gjykon gabimtarin me vdekje, por ia shtron rrugën e pendimit dhe ia hap dyert e shpresës. I vë re urtësitë e kaderit në diversitetin fetar dhe thërret në mendimin e tij me urtësi e këshillë të mirë dhe refuzon fitnet e vrazhdësinë.

Kjo është njerëzorja, të cilën e duam dhe e shohim të përhapur në Mesazhin e Allahut, sinonim i Islamit!

HIPOKRIZIA

Njeriu hipokrit dhe shoqëria hipokrite kanë disa shenja me të cilat njihen, ashtu siç ka ardhur në Sunet: "gënjeshtria, mashtrimi, tradhtia dhe armiku i poshtër".

Përqindja e hipokrizisë shtohet, ose pakësohet sipas vlerës së këtyre sjelljeve të ulëta në karakterin e njerëzve!

Disa, me të cilët marrim e japim, nuk ia dinë vlerën dhe shenjtërinë fjalës. Ata rrotullojnë gjuhën në gojë dhe vetëm kaq, nuk u besohet as në përshkrim e as në tregim. Ndoshta fjalët e tyre mbulojnë të vërtetën e nuk e zbulojnë atë.

Lidhja në mesin e njerëzve të mençur është fjala, e cila jep garancinë për premtimet, marrëveshjet dhe zotimet, megjithëse shumë premtojnë, por nuk e mbajnë premtimin, lidhin marrëveshje dhe i thyjnë ato, japin zotime e nuk i realizojnë. Përhapja e këtyre veseve të këqija ndikon në përhapjen e kaosit në të gjitha anët e jetës. Prandaj Allahu (xh.sh) thotë: "Mos u bëni si ajo që e prish tjerrën e saj pasi ta ketë dredhur fort, të betoheni për të mashtruar njëri-tjetrin, për shkak se një popull është më i madh në numër se tjetri. Me këtë Allahu ju sprovon dhe për t'ju bërë të qartë në Ditën e kiametit për çfarë keni kontradiktuar"¹².

Fatkeqësia e madhe është të urresh një njeri e të

12. Kur'ani, En-Nahl: 92.

përpiqesh ta përulësh atë me të gjitha mënyrat. Përpiqesh me të gjitha forcat për ta dëmtuar, dhe këtë e ka quajtur Pejgamberi (a.s): "Poshtërsi në armiqësi..."

Kam parë disa njerëz që nuk ngopen duke e ulur thellë e më thellë armikun e tyre, t'ia derdhin gjakun, t'ia shkatërrojnë pasurinë, ta ç'nderojnë dhe t'ia bëjnë zi jetën kudo që të shkojë.

Populli nuk shpëton prej njerëzve të tillë me një vasë (ligjëratë) kalimtare, por patjetër duhet vështirim serioz në bazat e edukimit, përbërësit e moralit në shtëpi, në rrugë dhe në të gjithë ambientin. Kjo është një punë e pastër për shoqëritë e singerta islame, të cilat i ka mbuluar mallkimi e nëma për mjerim!

Gjithashtu, kam vënë re dhe anë të tjera në drejtim të ymetit tonë, të cilat kanë efektin e tyre!

Një miku im më tha: Kam qenë në Hong Kong dhe më pëlqeu një pallto, por ajo ishte më e shkurtër se sa masa ime. I tregova shitësit pallton që kisha veshur dhe ai më nxori stofin e më tha merr sa të duhet, t'ia çoj rrobaqepësit dhe pas një ore e ke gati!

- Vendosa ta marr. Fiks pas një ore unë vesha pallton e re!

I thashë: Tek ne kjo gjë ndodh për një javë, ose më shumë!

Rrobaqepësitë private tek ne janë të çuditshme dhe prej tyre vinë shumë dëme të mëdha. Sa e sa zjarre janë ndezur për shkak të neglizhencës së punëtorëve në shtrirjen e telave të elektrikut! Sa e sa ndërtesa janë kërcënuar nga puna jo e mirë e hidraulikëve në vendosjen e tubave të ujërave, të ujtisen muret e të pikojnë brenda e jashtë!

Nuk ka dyshim se ndryshimi i njerëzve, për t'u shëruar

prej këtyre sëmundjeve, është bazë e domosdoshme për ndërtimin e ymetit me një Mesazh të Madh. Madje, është bazë e domosdoshme për ndërtimin e shoqërisë që mund të jetojë. Ky është mundi i parë për punën e shoqërive islame, duke u nisur nga fjala e Allahut: "Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata ta ndryshojnë gjendjen e tyre"¹³.

Me një peshore të drejtë, vëmë re se realiteti i njeriut tek ne është i deformuar, i lëkundur dhe i tretur shumë larg. Nëse mendimi është i çmendur dhe zemra është e sëmurë, atëherë prej nga do të vijë shpëtimi? Dhe si do të afrohet fitorja?

I thashë një të përvëluari: Vë re tek ti një mall të zjarhtë në vendosjen e rregullit islam, por a të anoj nga papunësia dhe klithmat, derisa të realizohet fitorja?

Dyert e punëve janë të shumta dhe Islami është fé e individit, shoqërisë dhe shtetit. E kemi për detyrë që, nëse na ka humbur pushteti, të përvishemi në pastrimin e shpirtit, në moralin e lartë dhe ta mbështesim shoqërinë në traditat e sakta (të mira).

Me të vërtetë, nuk ka Islam pa një mendje që kupton dhe ndërgjegje që zgjon. Prandaj, le t'i shtojmë përpjekjet në këto fusha dhe në suksesin e tyre është realizimi i shpresave.

13. Kur'ani, Err-Rrad: 11.

IMAMI QË KËNDONTE

Nuk njoh asnjë prej dijetarëve fukaha (juristë) që të ketë refuzuar këngën fetare, prandaj kush është ai që urren nxitësit e dashurisë për Allahun, madhërimin e emrave dhe falënderimin për begatitë e Tij? Dhe, kush e urren nxitimin drejt Tij, të qarët për neglizhencën dhe humbjen e hakut të Tij?

Dijetarët (fukahatë) kanë refuzuar atë që quhet "rrethet e dhikrit", në të cilat shtohen zhurmat dhe britmat, fishkëllimat e zërat e ndryshëm, vallet e kërcimet, të cilat në të vërtetë janë gjendje harrese dhe jo gjendje kujtese (dhikri), e rrethe kërcimesh të shëmtuara, të mbushura me bidate dhe legjenda, që nuk i pranon mendja.

Në trashëgiminë tonë të vyer ka gjëra që meritojnë të promovohen e të gjallërohen. Sufisti Ebu El-Hasen El-Kurafi tregon nga El-Hasen, se disa njerëz shkuan te Omer ibnul-Hatabi (r.a) dhe i thanë: O prijësi i besimtarëve, kemi një imam, që kur mbaron faljen e namazit fillon e këndon! Këtë ngjarje e transmeton Imam Shatibiu në volumnin e parë të librit të tij "El-I'tisam".

Omeri tha: Kush është ai?

I treguan për kë bëhej fjalë.

Tha: Ngrihuni të shkojmë tek ai, sepse nëse ne shkojmë

atje, mendon se e kemi përgjuar punën e tij.

Shikoni respektimin e të drejtave të njeriut dhe ruajtjen e nderit të tyre. Omeri me disa shokë të Pejgamberit (a.s) u nisën shkuan tek ai, ndërkohë që ai ishte në xhami! Sa e pa Omerin, u ngrit për ta pritur dhe i tha: O prijësi i besimtarëve, çfarë halli ke? Dhe, çfarë të ka sjellur këtu? Nëse është nevojë e jona, ne na takon më tepër të vimë tek ty, e nëse është nevojë e jotja, atëherë e meriton më shumë të madhërohet, kalifi i Resulullahut (a.s)

Omeri i tha: Mjer për ty! Më ka ardhur një lajm i keq për ty.

Imami: Po, çfarë është ai, o prijësi i besimtarëve?

Omeri: A tallesh në ibadetin tënd?

Imami: Jo, o prijësi i besimtarëve, por ajo është një këshillë që ia drejtoj vetes sime.

Omeri: Thuaje, sepse nëse është fjalë e mirë, e them edhe unë me ty! E, nëse është e shëmtuar, të ndaloj prej saj!

Imami:

Zemra, e sa herë që e qorto
për largimin, kërkon të më lodhë

Kohën, nuk e shoh, veçse duke luajtur
në vazhdimësinë e saj, ajo po më mundon

O shok i keq, çfarë është kjo papjekuri
jeta iku kështu në lojë

Rinia më shkoi dhe iku
përpara se ta mbaroj, u plak

Nuk shpresoj pas saj, veçse të tretim
thinjat ma ngushtuan qëllimin tim

Mjer për veten, që nuk e shoh kurrë
të jetë mirë, e as në edukim

Vetja ime, nuk ka qenë e as nuk është epshi
Ji i përkushtuar ndaj Zotit! Frikësoju dhe kije frikë Atë!

Omeri tha:

"Vetja ime, nuk ka qenë e as nuk është epshi
Ji i përkushtuar ndaj Zotit! Frikësoju dhe kije frikë Atë"

Për këtë, le të këndojë, kush dëshiron të këndojë!

Unë i dua ndjenjat e sinqerta dhe tingujt që frymëzojnë
të mirën, shërbyese të së vërtetës! Kush refuzon, ai le të
pohojë për veten e tij, por të mos i kundërshtojë të tjerët
në emër të fesë!

VËLLEZËRIT TANË KOPTË...

Në qoftë se vëllezërit tanë koptë dëshirojnë të jetojnë si myslimanët e njëjtë në numër me ta, unë jam dakord me këtë gjë. Tani, ata janë afërsisht dy milion e gjysmë dhe duhet të jetojnë sikurse jetojnë dy milion e gjysmë myslimanë.

Ata kanë të drejtat e tyre dhe njëkohësisht edhe detyrat që u takojnë. Ndërsa, të përpiqen që parimet e tyre t'ua imponojnë myslimanëve dhe të shtien në dorë çështjet e jetës shoqërore dhe politike, këtë jo!

Nëse dëshirojnë të ndërtojnë kisha për aq sa janë në numër për t'u falur dhe për të shprehur parimet e fesë së tyre, askush nuk do t'i kundërshtojë! Ndërsa, po të dëshirojnë që tokës egjiptiane t'i japin ngjyra të krishtera dhe ta shfaqin krishtërimin sikur ai është feja mbizotëruese në këtë vend, këtë jo!

Në qoftë se dëshirojnë të ruajnë personalitetin dhe parimet e tyre nuk do të paragjykoen dhe as nuk do të kërcënohen, u takon kjo gjë. Ndërsa të dëshirojnë të largojnë myslimanët nga feja islame e të zemërohen sa herë që ne kërkojmë të praktikohet sheriatu islam e të përhapet edukimi fetar, këtë nuk e pranojmë!

Kolonizatori ua ka injektuar disave prej tyre që të qëndrojnë agallarë të myslimanëve, por ne dëshirojmë

mirëkuptim të ndershëm me njerëz që kuptojnë!

Kolonizatori ka përhapur në mesin e atyre që u ka dhënë zemrën dhe veshët e tij se myslimanët në Egjipt janë të huaj dhe kalimthi në të, prandaj duhet të shporren, në qoftë se jo sot, atëherë nesër patjetër!?

Prej këtij parimi janë nisur shumë prej aventurierëve duke iu vërsulur Islamit dhe myslimanëve, e sa herë shikojnë myslimanët, që kthehen te feja e tyre, çojnë zërin dhe bërtasin: U rikthye ekstremizmi, koptët janë në rrezik!?

KRIZA E SHPIRTMADHËSISË

Ndjej se mes bijve të vendit tim ka një "krizë shpirtmadhësie" që nuk njihet kurrë më parë! Nëse hajduti dikur u vidhte diçka kalimtarëve, njerëzit e tjerë e kapnin për fyti, ia jepnin dy-tre shpulla dhe e dorëzonin te polici!

Thirrja "hajduti", akoma pa u dëgjuar mirë i bënte njerëzit të vraponin drejt zërit për ta ndihmuar...

Ndërsa tani, gjendja ka ndryshuar. Hajdutët sulmojnë autobus të mbushur me njerëz, burra e gra. Njëri ua merr sendet e çmuara e tjetri u rri me armë mbi kokë! Njerëzit heshtin e sytë u treten derisa krimi të marrë fund e hajdutët të fshihen në stacionin më të afërt!

Çfarë do të ndodhte nëse dikush do të kundërshtonte? Të ngriheshin njerëzit shpirtmëdhenj e të bënin rezistencë edhe në qoftë se do pësonin ndonjë të keqe? Ata, patjetër që do të triumfonin, sepse nuk mundet që dy veta të mposhtin njëzet, apo tridhjetë pasagjerë, por "kriza e shpirtmadhësisë" mbizotëron dhe hajdutët marrin forcë e sherri i tyre ndizet!

Sikur ta kishin hedhur hajdutin nga autobusi e gjaku i tij të derdhej, askush nuk do të kishte ndjerë keqardhje për të, por njerëzit nga frika e poshtërimit, jetojnë në poshtërim!

Është kjo "kriza e shpirtmadhësisë" që e lejon hajdutin

të vjedhë një motor, të grabisë zinxhirin e një vajze, apo byzylykun nga dora e saj dhe të ecë rrugës i pa shqetësuar për asgjë!

Sikur njerëzit në rrugë të ishin zgjuar do ta ndiqnin duke thirrur, për ta ndaluar, ta zbrisnin prej motorit, e t'ia kthenin gjënë e vjedhur të zotit dhe hajdutin ta dorëzonin në polici.

Nuk e di, a thua njerëzit janë në gjendje shoku dhe kanë humbur ndjesinë për atë që ndodh rreth tyre, apo ata kanë ndjesi, por çështja nuk u intereson dhe nuk ua zgjon vëmendjen?

Prej mësimëve të para të Islamit është se "myslimani është vëlla i myslimanit, nuk i bën padrejtësi, nuk e zhgënjen dhe nuk e poshtëron". Transmeton Ebu Davudi nga Xhabiri dhe Ebu Talha, se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Nuk ka mysliman që e zhgënjen (lë në baltë) një njeri mysliman në një vend që është duke u çnderuar dhe duke u përdhosur, përveç se Allahu do ta zhgënjejë atë (do ta lë pa ndihmë) në një situatë që dëshiron të ndihmohet. Dhe, nuk ka mysliman që e ndihmon një mysliman në një vend që është duke u çnderuar dhe duke u përdhosur, përveç se Allahu do ta ndihmojë në një situatë që dëshiron të ndihmohet".

Transmetohet po ashtu: "Pasha Madhërinë dhe Krenarinë Time, patjetër do të hakmerrem ndaj zullumqarit, shpejt ose vonë dhe patjetër do të hakmerrem ndaj atij që shikon një të keqtrajtuar, ka fuqi ta ndihmojë dhe nuk vepron".

Përse nuk vepron?

Moskokëçarje ndaj krimit! Mungesë keqardhjeje për të poshtëruarin! Mungesë ndjesie për vëllazërimin e përbashkët!

Situatat përsëriten, jeta vazhdon e një ditë do të ndihesh

i braktisur dhe do të kërkosh për dikë që të ndihmojë e nuk do ta gjesh, sepse ti kështu ke vepruar më parë me dikë tjetër!

Dikur njerëzit nuk e kursenin neveritjen për një krim që ndodhte. Kujtoj një herë e një kohë, kur isha student dhe po udhëtoja nga Turami për në shkollë. Pashë një djalë që qëlloi një tjetër, i cili ishte ulur pranë meje. E shikova në mënyrë akuzuese dhe ai me të shpejtë ma ktheu: Ai po ngacmonte vajzën që është ulur në karrigen tjetër. Heshta dhe bashkë me mua heshtën edhe pasagjerët e tjerë duke e miratuar për veprimin që bëri!

Kur një zonjë hynte në autobus të mbushur plot me njerëz, burrat menjëherë ngriheshin në këmbë për t'i liruar vendin, në shenjë respekti për femrën dhe nderin e saj.

Ndërsa tani, dëgjojmë për histori përdhunimi të ulëta, mashtrim të vajzave të dobëta dhe shfrytëzim poshtërues i vështirësive të saj, për ta shtjerë në dorë.

Kriza e shpirtmadhësisë është argument i rënies së shpirtit fetar dhe burrëror dhe përhapjes së çmendurisë shtazarake pa asnjë shqetësim. Çështja ka nevojë për mjekim të shpejtë, sepse ulja këmbëkryq e së keqes deri në këtë pikë është alarm i degradimit, humbjes dhe vazhdimësisë së disfatave poshtëruese.

KUR'ANI, MES MËSIMIT PËRMENDËSH DHE KUPTIMIT TË TIJ

Vështrova foton e një fëmije dhjetë vjeçar, fitues i një çmimi, sepse kishte përfunduar hifzin (mësimin përmendësh) e Kur'anit Famëlartë dhe kishte perfeksionuar leximin e tij!

U shikoja me vëmendje fytyrën e tij dhe pashë që shenja çiltërsie e kishin mbuluar! Ndërkohë që unë nuk e fshihja mahnitjen time për memorien e tij observuese me gjithë moshën e re!

E kisha kaluar një gjendje të tillë, sepse e pata mësuar përmendësh Kur'anin në moshën dhjetë vjeçare dhe pas disa muajsh isha regjistruar në Ez'her, pastaj m'u harrua, por më vonë e ri-mësova, e për këtë Allahut i qoftë falënderimi!

Nëse ky mësim përmendësh i hershëm ka ndonjë gjurmë, ai është thesar, që përfitojmë prej tij kur të rritemi dhe mburojë që na mbron jetën tonë individuale! (Ndërsa ky hafiz i brishtë të ketë përfshirë profetësinë përpara duarve të tij, e me memorien e mirë që ka të quhet dijetar, kjo jo!)

Akoma edhe sot, kur lexoj disa ajete dhe sure, kujtoj mësuesin, që më qortonte për ndonjë ajet, më linte për ndonjë tjetër dhe më shpërblente për të tjerë!

E, që unë të kuptoja qëllimin e tyre, kjo nuk më shkante ndër mend! Ishim kaseta të regjistruara vetëm për shkronja.

Tashi pyes veten: A është Kur'ani libër leximi dhe tekst, që mjaftohemi prej tij me një lexim kalimtar?

Meditova rreth qëndrimit të myslimanëve ndaj librit të tyre (Kur'anit), pastaj thashë: Sa i ngjan qëndrimit të këtij fëmije dhjetëvjeçar! Sikur kjo botë islame është fëmijë i madh. Ajo, në kuvendet e Kur'anit, hap veshët, por është larg dhe jo prezent. Lëviz vetëm valët e dëgjimit, por nuk lëviz shpirtrat, apo shoqëritë që të gjykojnë me të. E ndërkohë që Kur'ani nuk ka zbritur për një gjë të tillë: "Ky është kumtim për njerëzit, që t'u tërhiqet vëmendja me të dhe që ta dinë se Ai është Një Zot dhe që të përkujtojnë të zotët e mendjes"¹⁴.

Kur ndizet drita e kuqe e semaforit, makinat qëndrojnë, i nxituari ndalet dhe lëvizjet ngadalësojnë dhe sa të ndizet ngjyra jeshile, u lejohet të vazhdojnë e të lëvizin!

Kështu vepron edhe urdhri dhe ndalimi i Kur'anit për njerëzit! Por, përderisa Kur'ani të ngelet lexim i shkëputur prej shoqërisë, ai do të ecë në një luginë, e njerëzit do të lëvizin në një luginë tjetër. Kjo është tragjedi, apo krim, siç na bën të ditur edhe vetë Kur'ani: "Kush është më zullumqar, se sa ai që përkujtohet me ajetet e Zotit të tij, pastaj ia kthen shpinën atyre. Ne, me të vërtetë, do të hakmerremi ndaj keqbërësve"¹⁵.

Kur'ani në kohën tonë është i shkëputur prej jetës së përditshme. Ndoshta mund të ketë lidhje me shkencat e sheriatit, apo shkencat gjuhësore, por të ketë lidhje me shkencat e universit, kjo jo! Ky është libër që flet për qiejt dhe tokën e ç'ka ka mes tyre, e të mos ketë lidhje me shkencat e biologjisë, kimisë, kafshëve, bimëve, shtresave

14. Kur'ani, Ibrahim: 52.

15. Kur'ani, Es-Sexhde: 22.

të tokës dhe shkencave të jetës?!

E të mos ketë lidhje me shkencat e astronomisë dhe hapësirës?

Baballarët tanë kanë qenë profesorë në këto lëmi, por çfarë na largoi prej tyre?

Nëse përqaşja jonë në këto njohuri (lëmi) është mbështetje e ateizmit dhe largimit prej Zotit, atëherë a kemi qenë të drejtë ndaj vetes dhe ndaj Kur'anit tonë me paaftësinë në artet e jetës dhe studimin e universit? Imani (besimi) në logjikën e Kur'anit ndërtohet mbi vëzhgimin, meditimin dhe zbulimin, e ku qëndron vlera e besimit të shkëputur prej këtyre kuptimeve?

Uli kokën dhe hesht, duke qeshur e duke u pikëlluar, kur ndonjë ceremoni çelet me Kur'an, pastaj fytyrat e njerëzve përvëlohen prej dashurisë në çdo lëmi, pa i lidhur asgjë me Librin Famëlartë (Kur'anin) dhe pa depërtuar në zemrat e tyre asnjë rreze!

KUSH E ANULOI AJETIN?

Nëse përhapet pazotësia në mendim dhe anarshia në gjykim, atëherë në mendje asgjë nuk është më e saktë.

Një njeri ishte ulur dhe po u komentonte njerëzve Kur'anin, duke thënë: Ajeti i sures El-Bekare "Luftoni në rrugën e Allahut, ata të cilët ju luftojnë dhe mos mësyni (sulmoni). Me të vërtetë Allahu nuk i do mësymësit (ata që fillojnë luftën të parët)"¹⁶ është i anuluar. Sahabët (r.a) e kanë vërtetuar këtë anulim me mësymjen e tyre ndaj romakëve dhe persianëve, duke e shoqëruar me ajetin: "Luftoni, ata të cilët kufizohen me ju prej jobesimtarëve dhe le të gjejnë tek ju ashpërsi ..." ¹⁷.

Kjo injorancë më ngacmoi dhe i thashë komentuesit gabimtar: Kush të ka thënë se romakët dhe persianët nuk kanë qenë mësymës ndaj arabëve dhe myslimanëve?

Nëse rusët pushtojnë Afganistanin dhe aty instalojnë pushtetin e tyre, pastaj afganët fillojnë të rezistojnë duke sulmuar, a konsiderohen mësymës të fajësuar?

Nëse hebrejtë pushtojnë Palestinën dhe arabët fillojnë të kundërshtojnë pushtimin e shporrin dhunën, a konsiderohen sulmues të fajësuar?

16. Kur'ani, El-Bekare: 190.

17. Kur'ani, Et-Teube: 123.

Romakët erdhën nga Evropa dhe pushtuan Sirinë, Libanin, Jordaninë dhe Palestinën. Zbarkuan mësymës (sulmues) në Tebuk dhe Mu'teh në tokën e gadishullit! Nëse myslimanët fillojnë t'i shporrin nga Shami, Egjipti dhe mbarë vendet e tjera, të cilat janë pushtuar prej tyre, a konsiderohen myslimanët mësymës (sulmues), dhe u thuhet se ajeti i ndalimit të mësymjes (sulmit) është i anuluar?

Kjo është marrëzi e pastër, dhe një të marri, që është i paaftë të shohë realitetin, nuk i lejohet të komentojë Kur'anin dhe të përpiqet të dëmtojë kuptimet e tij.

Ju me këtë lloj komentimi, i cili anulon çfarë jeni të pazotë ta kuptoni, lejoni politikën e plaçkitjes në rrugë dhe terrorizimin e të pafajshmëve.

Lufta me romakët ka qenë më e drejta luftë, që ka ndodhur mbi sipërfaqen e tokës, dhe në kohën tonë, asaj i ngjet lufta ndaj sionizmit dhe kolonizmit, derisa toka t'u kthehet të zotëve të tyre dhe këto zullume të marrin fund.

Si pretendon dikush se ajeti: "Luftoni në rrugën e Allahut, ata të cilët ju luftojnë dhe mos mësyni (sulmoni). Me të vërtetë Allahu nuk i do mësymësit (ata që sulmojnë)"¹⁸, është ajet i anuluar?

A është kthyer Allahu i dashur me mësymësit, pasi ka qenë më përpara urryes i tyre?

Ose, si mundet të vijë dikush me hanxhar e me të t'i bjerë ajetit dhe ta ndajë në dy pjesë, të zhdukë njëërën pjesë dhe të mbajë tjetrën?

Këto mendje të sëmura duhet të shporren prej kuptimit të Kur'anit dhe Sunetit, e të mos ia prishin njerëzve fenë e tyre.

18. Kur'ani, El-Bekare: 190.

Atë që thamë për ajetin e mësipërm e themi edhe për ajetin tjetër: "Nuk ka detyrim (imponim) në fé. Është qartësuar udhëzimi prej humbjes"¹⁹. Disa jonormalë kanë thënë se ajeti është i anuluar. Ata me këtë lloj kuptimi kanë devijuar nga e vërteta (e sakta), sepse nuk ka ndodhur kurrë në jetën e Pejgamberit (a.s) dhe të shokëve të tij, të jetë detyruar dikush të hyjë në Islam. Bile, detyrimi në fé është i papranueshëm që nga koha e Nuhut (a.s) dhe deri në kohën e Muhammedit (a.s).

Nuhu (a.s) i tha popullit të tij: "Çfarë mendoni ju, nëse unë jam në të vërtetën prej Zotit tim, më ka dhënë mëshirë prej Tij, dhe ju jeni të verbuar, a do t'ju detyrojmë në të, ndërkohë që ju jeni refuzues të saj"²⁰?

Pastaj, iu tha Muhammedit (a.s) pas kësaj me dhjetëra shekuj "Sikur të kishte dashur Zoti yt, nuk ka dyshim se të gjithë njerëzit në tokë, pa përjashtim do të kishin besuar. A, ti do t'i detyrosh njerëzit, në mënyrë që ata të jenë besimtarë"²¹?

Të gjithë Profetët e Allahut e refuzojnë imponimin dhe pranojnë vetëm bindjen e lirë. Prandaj, si i lejohet një mendjeje të prishur ta komentojë Kur'anin sipas epshit të tij dhe ta cilësojë ajetin e qartë (muhkem) se ai është i anuluar?

Në këto ditë, po më shqetësojnë dy gjëra, prej njerëzve që nuk arrijnë të kuptojnë një vepër tokësore të një njeriu të zakonshëm, pastaj vijnë me paaftësinë e tyre në raport me Librin e Allahut, që të ngatërrojnë të vërtetën me të kotën!

Nuk ka dyshim, se feja e Allahut është më e dliër se sa të merret prej gojëve të budallenjve!

19. Kur'ani, El-Bekare: 256.

20. Kur'ani, Hud: 28.

21. Kur'ani, Junus: 99.

MARRËZI!

Mendjemprehtësia është prej cilësive të pejgamberëve Ajo është vështrimi që arrin të kuptojë thellësitë e fshehta dhe distancat e largëta. I shikon gjërat ashtu siç janë, pa shtuar, ose pa pakësuar dhe me butësi arrin të veprojë e të nxjerrë rezultatet e duhura. Kjo, sepse ka sy të shtrembër, apo shikime të shtrembra që i shikojnë gjërat e drejta të shtrembra dhe njëshin e bëjnë shumës e i nxjerrin përfundimet sipas orekseve të tyre, prandaj mes tyre dhe realitetit ka distancë të madhe dhe pak mund të jenë të saktë!

Njerëzit që e meritojnë më tepër mendjemprehtësinë janë njerëzit e thirrjes (daveitit), të cilët pasojnë pejgamberët dhe veprojnë sipas mesazhit të tyre duke paraqitur, me sjelljet dhe rrugën e tyre, shembuj të së mirës dhe përkushtimit. Dhe, nuk ka shpresë në fé e në dynja së bashku, me shikimin e shtrembër!

Po mendoja rreth një ngjarjeje të ndodhur mes banorëve të Suvejf-it, viktimave dhe të plagosurve të tij, të cilët lindën si pasojë e betejës së verbër për festimin e Fitër Bajramit përpara konfirmimit të kohës së tij në Egjipt, apo pas datës së konfirmimit të tij në një vend tjetër. Dhe, kujtova historinë e profesorit dëshmor, Hasan El-Benna kur hyri në një fshat

dhe gjeti banorët e tij të ndarë në dy grupe. Njëri grup dëshironte ta falte teravinë me 8 rekatë, ndërsa të tjerët kërkonin ta falnin me 20 rekatë. Plasi rebelimi, u nxorën thikat dhe filluan kërcënimet e marrëzive të bezdisshme!

Profesori rahmetli urdhëroi mbylljen e xhamisë menjëherë pas namazit të jaciesë dhe anulimin e faljes së teravisë dhe tha: Secili të falë në shtëpinë e tij sa të dëshirojë rekatë teravije!

Namazi i teravisë është nafile (vullnetar), ndërsa pajtimi mes njerëzve është farz (detyrë) dhe nëse detyra humbet me kryerjen e një nafiles (vullnetares), atëherë Allahu mos e dhashtë atë nafile!

Po pyesja veten; pas vrasjes së disa personave dhe plagosjes së disa të tjerëve: Në rrugën e kujt e gjithë kjo marrëzi?

Namazi i Bajramit është sunet, sikur të ishte e konfirmuar koha e tij, e koha e tij për masat akoma nuk ka hyrë, po përse të derdhet gjaku për të e të vdesin njerëz?!

Me vete thashë: Kjo është prej ngatërtimeve të iblisit (shejtanit) për disa adhurues, ashtu siç e ka thënë Ibnul-Xheuzi. Por, u habita prej një personi që tha: Ibnul-Xheuzi nuk merret për bazë (argument)!

I thashë: Imam, historian, mufessir (komentues i Kur'anit), thirrës, letrar; nuk merret për bazë ai, atëherë kush mund të merret për bazë?

Tha: Kemi lexuar se Ibnul-Xheuzi bënte shirk në lutjen e tij ndaj Allahut dhe shkante tek varret për t'u lutur!

- I lutej Allahut dhe nuk i lutej të vdekurve! Çfarë ka, në goftë se dikush i kujton vetes së tij fundin e njeriut në atë gropë (varr), ngrirjen e lëvizjeve dhe zhurmave të tij nën ato pllaka dhe t'i zbutet zemra e t'i drejtohet Zotit me përgjërëm

në lutjen e tij, a kjo është shirk, o budalla? Nuk ka dyshim, se të menduarit tuaj është i njollosur (ndotur), prandaj ju keni guxim të flisni për imamët e fikhut (jurisprudencës) dhe këta kolosë nuk ju shtojnë, veçse sherr e fesad!

A nuk jeni të gjendje të mësoni se kërkimi i të metave të njerëzve të pafajshëm është krim që shkatërron veprat tuaja, duke ditur se i Dërguari jonë ka thënë: "Nuk është prej nesh, ai që nuk nderon të mëdhenjtë tanë, nuk mëshiron të vegjlit dhe nuk ia di dijetarit tonë vlerën e tij"²².

Nëse Ebul-Ferexh, Abdurrahman ibnul-Xheuziu është mushrik (idhujtar), atëherë kujt i vlen besimi pas këtij njeriu?

Pastaj, duhet ta dini se ymeti (populli), i cili nuk ka histori, nuk ka të tashme e as të ardhme dhe nëse puna juaj që ju zë, është kritika ndaj kolosëve dhe shembja e maleve, atëherë gërmadhat do t'ju bien mbi koka dhe do t'ju zënë frymën!

Pak mendjemprehtësi, pak edukatë, pak drejtësi derisa të shpëtojmë ymetin tonë prej kurtheve e intrigave që e rrethojnë.

22. Transmetuar nga Bezzari.

MBURRAVECË!

Njerëzit e thjeshtë dhe shembujt e tyre prej pseudo të diturve, dinë pak e nuk njohin shumë dhe nuk e kanë frikë Allahun në atë që dinë. Madje, mund të bëjnë edhe gjynah me të duke nxitur fitne (trazira)!? Ndoshta kjo është ajo që e ka nxitur Gazaliun të shkruajë librin e tij: "Pengimi i masave (njerëzve të thjeshtë) prej filozofisë".

Përse këta njerëz nuk i perfeksionojnë zanatet, prodhimtaritë e mundshme të tyre dhe të bëjnë mirë mjekimin e defekteve të përhapura, në vend që të merren me fetva e të llafollozojnë me rregullime?

Ajo që njerëzit kanë nevojë, prej dispozitave të shariatit, nuk është diçka e vështirë. Ajo është e paktë prej të lehtës, pastaj atë e përfshin sinqeriteti, aktiviteti dhe dashuria për rregullim, e atëherë gjërat ndreqen. Gjysma e pseudo të diturve, apo një e dhjeta e tyre, duan të mburren me atë që zotërojnë, me gjithë cektësinë e saj, ashtu siç nxitojnë të përulin të tjerët e t'i shfaqin si njerëz me njohuri të pakta.

Po i flisja disa njerëzve dhe njërit prej tyre i thashë: O zoti filani, çështja është kështu e ashtu...

Ai nxitoi duke më thënë: "O zoti filani", kjo është shirk! Zoti është Allahu!

Menjëherë iu përgjigja: Zoti absolut mbi tërë botët

është Allahu, nuk ka dyshim, ashtu si dituria e plotë i takon Atij, i lartësuar qoftë Emri i Tij. Kjo nuk pengon, që mes njerëzve të ketë dijetarë, e Kur'ani e ka përdorur fjalën "zot" në përshkrimin e Jahjasë (a.s): "Dhe zotëri, të dliër dhe profet prej të mirëve"²³. Dhe në përshkrimin e bashkëshortit të gruas në ndodhinë e Jusufit (a.s): "E ia behu zotëria i saj në derë"²⁴.

Dhe, i Dërguari i Allahut e ka përshkruar Hasen ibn Aliun (r.a) duke i thënë: "Biri im ky, është zotëri..."²⁵!

I ka thënë fisit Eus, kur po vinte Sead ibn Muadhi (r.a): "Ngrihuni në këmbë zotërisë suaj"²⁶.

Ti, o zotëri, ke mësuar një gjë dhe nuk di shumë gjëra. Ti ke oreks të fyesh njerëzit dhe, edhe nëse je i saktë, Allahu nuk do ta pranojë prej teje, derisa të jesh i sigurt me Zotin tënd dhe të mësosh edukatën!

Në fushën e fikhut islam - ku ndryshimet janë det pa breg - kam gjetur këtë lloj, që mëson disa dispozita dhe kërkon të debatojë e të dalë mbi të tjerët. Shtrin gjuhën me fyerje ndaj disa imamëve të mëdhenj, pa pasur nderim për asnjërin, që kundërshton atë çfarë ai njeh!!

Unë e fali sabahun pas imamëve që bëjnë kunutin dhe pas imamëve që nuk e bëjnë kunutin, duke ditur se të katër Imamët e mëdhenj kanë mendime të ndryshme në këtë sunet; Maliku dhe Shafiu bëjnë kunut, ndërsa Ahmedi dhe Ebu Hanife, jo... polemika është e lehtë, ndërsa mbyllja e xhamisë, për mua, është më e lehtë se sa zgjidhja e këtij problemi me shkop.

23. Kur'ani, Ali Imran: 39.

24. Kur'ani, Jusuf: 25.

25. Transmetuar nga Buhariu.

26. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

Ymeti islam përballet me ditë të zymta dhe armiq dinakë të zgjuar, prandaj a t'i takojmë me burrat tanë të mençur, apo t'i vendosim punët tona në duart e barinjve e dhjetëra pseudo të diturve për të na udhëhequr drejt greminës?

Disa, që i përkasin Islamit, i bëjnë zullum atij me mungesën e të kuptuarit të tyre dhe refuzimin që bëjnë për të pyetur njerëzit e dhikrit (dijes), prandaj a po e shpejtojmë dështimin shkatërrues me këtë fanatizëm?

MENDJA E MUNGUAR

Islami ngrihet mbi disa shtylla dhe baza, të cilat i ngjajnë ajeteve të qarta, që janë baza e fesë dhe esenca e saj! Këto shtylla dhe baza nuk janë çështje ndryshimi, edhe pse mund të ketë qëndrime të ndryshme, ato janë qëndrime sipërfaqësore dhe me peshë të lehtë.

Le të sjellim një shembull që e qartëson këtë qëllim. Allahu (xh.sh) thotë në Kur'an: "...Ose, nëse i prekni gratë dhe nuk gjeni ujë, atëherë merrni tejemum me dhé të pastër"²⁷. Prekja, a ka kuptimin e përgjithshëm dhe çdo prekje e prishë abdesin, apo ka kuptim figurativ dhe nënkupton prekje të veçantë?

Fukahatë (juristët islamë) kanë mendime të ndryshme dhe fusha e fikhut (jurisprudencës) është e gjerë për këndvështrime të ndryshme. Dijetarët kanë rënë në konsensus se ky ndryshim nuk sjell problem, nuk ka dëm, nuk i bën keq Islamit dhe nuk ia prish qejfin askujt.

Por, nëse Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Katër cilësi kush i ka, ai është hipokrit i pastër, e kush ka njëren prej tyre, ka një pjesë prej pjesëve të hipokritit, derisa ta lërë atë gjë. Kur flet gënjen, kur premtion thyen premtimin, kur i lihet amanet mashtron, kur bën pakt tradhton dhe, kur

27. Kur'ani, En-Nisa: 43.

konfliktuon poshtëron"²⁸. Kuptimi është i qartë dhe i prerë, nëse në fikh ka vend për ndryshim, në moral nuk ka vend për një gjë të tillë.

Kam vënë re se janë shfaqur disa grupe njerëzish, lidhja e tyre me akiden është e zymtë, moralin e kanë të dobët dhe nuk kanë interes për ymetin. Lënë bazat e fesë dhe virtytet e saj dhe marrin përsipër disa këndvështrime të veçanta juridike (fikhu) dhe kapen me shumë fanatizëm për to. Me të tilla gjëra i ndajnë njerëzit, kush nuk merr pjesë në mendimin e tyre, atëherë ai nuk konsiderohet mysliman!?

P.sh, çështja e pantallonave dhe rrobave, nikabi (mbulesa e fytyrës), fotografimi, muzika, numri i shkallëve të minberit etj.

Moti i rizgjimit islam është mjegulluar prej stërgjatjes së zhurmës në këto çështje. Debatimi rreth tyre e ka mundur vështrimin në të ardhmen e popujve të kërcënuar islamë dhe qëllimet kryesore fetare! Bile, kundërshtarët e Islamit, të jashtëm dhe të brendshëm, e kanë goditur rëndë Islamin për shkak të kësaj situate fatkeqe dhe përçarjeje artificiale.

Në këto ambiente gjenden ekstremistët, të cilët bëjnë më shumë keq se sa mirë dhe me metodën e tyre vënë pengesa përpara njerëzve të mençur.

Kundërshtarët e Islamit në këto ditë zotërojnë fuqi përçarëse dhe kanë gjetur mbështetje prej kushteve të favorshme! Ne vuajmë prej të metave të trashëguara dhe bashkëkohore, nëse e zëmë veten me to, armiqtë do të na eliminojnë!

Le të jemi të qartë në mësimin e djemve fanatikë të disa mendimeve në fikh, se gjendja botërore e myslimanëve nuk e përballon këtë ngurtësi! Dhe se, është prej hajrit ta

28. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

përvetësojmë këtë rregull: "Të bashkëpunojmë për çfarë jemi dakord dhe ta justifikojmë njëri-tjetrin për ato gjëra që ndryshojmë".

Me të vërtetë i shkruaj këto rreshta dhe kundërshtarët e Islamit kanë filluar ta fshijnë atë nga Evropa, ku janë shuar minare e minberë, të cilët kanë qenë të mbushur me dhikrin (përmendjen) e Allahut!

Ndërkohë, disa burra e djelmosha tanë merren me debate të hidhura se, a duhet të jepet sadakaja e vitrit në vlerë, apo në kokrra (drithë).

Ky është debat që shkëput lidhjet e të afërmve, ndërkohë që shtëpia islame po lëkundet! Prandaj, a po kthehet mendja e munguar?

MËSHIRË PËR KRIJESAT

Islami e mëshiron dobësinë njerëzore, gabimtarit i jep shanse për t'u penduar dhe devijuesit për t'u drejtuar. Të bësh njerëzit të dëshpërohen prej mëshirës së Allahut është krim, ndërsa edukatori i drejtë hap dritaret e shpresës për devijuesit derisa ata të kthehen te Zoti i tyre.

Disa thirrës, sikur të jenë caktuar roje të gabimtarëve, i fajësojnë, i zbulojnë dhe ua zënë frymën!? Do të ishte më mirë për ta, të sillen me mëshirë derisa t'i drejtojnë në rrugën e shpëtimit tek Allahu dhe nënshtrimit ndaj Tij, sepse Allahu meriton çdo dashuri.

Transmeton Nesaiu se një njeri kurrë nuk kishte punuar asnjë të mirë, por u jepte borxh njerëzve. Ai i thoshte shegertit të tij: Merru sa munden të paguajnë, lëri kur janë në vështirësi dhe falua, sepse ndoshta Allahu na fal edhe neve!

Kur ai vdiq, Allahu e pyeti: A ke punuar ndonjë të mirë?
- Jo, përveçse kam pasur një shegert dhe u jepja borxh njerëzve. Kur atë e dërgoja për të mbledh borxhet, i thoja: Merru sa munden të paguajnë, lëri kur janë në vështirësi dhe falua, sepse ndoshta Allahu na fal edhe neve! Allahu i Madhëruar i tha: Patjetër që të kam falur edhe ty..!

Transmetohet në ëndrrën e vërtetë të Pejgamberit (a.s)

se: "Ndërkohë që ai ishte në gjumë erdhën dhe e morën dy melekë e së bashku me të shkuan në një qytet. Trokitën në portën e qytetit dhe dera u hap. Hynë brenda dhe panë disa burra, gjysma e tyre ishte në formën më të bukur, ndërsa gjysma tjetër në pamjen më të shëmtuar që mund të shikojë një njeri. Dy melekët u thanë: Shkoni dhe hidhuni në lumë. Uji i lumit përballë ishte i bardhë, safi. Ata u hodhën në të, pastaj u kthyen dhe gjithë shëmtimi ishte larguar prej tyre. Ata morën pamjen më të bukur..."!

Dy melekët ia komentuan pamjen Pejgamberit (a.s) duke i thënë: "Këta njerëz kanë përzier punë të mira me punë të këqija dhe Allahu ua ka falur atyre!"²⁹

Hadithi është i transmetuar te Buhariu dhe Muslimi dhe vërtetësinë e tij e kam hasur disa herë në Librin e Allahut: "Dhe të tjerë që pohojnë për gjynahet e tyre, kanë përzier punë të mira me të tjera të këqija. Ndoshta Allahu ua pranon pendimin e tyre. Me të vërtetë, Allahu është Falës dhe Mëshirues..."³⁰, e shpresë-lutja tek Allahu është e pranueshme!

Përsëri, Allahu (xh.sh) thotë: "Ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, patjetër Ne do t'ua fshijmë atyre të këqijat dhe do t'i shpërblejmë ata me më të mirën e asaj që kanë punuar"³¹. Duket qartë prej krahasimit të ajeteve, të premtimit dhe dënimit se, dyert e shpresës janë të hapura për njerëzit me vullnet të mirë, të cilët i kanë kapluar humbjet, edhe po qe se ato janë shumë, ndërsa njerëzit me vullnet të ndërlikuar me gjynahun, puna e tyre është ndryshe.

Pastaj, ai që mohon Allahun, apo refuzon ligjin e Tij, ai

29. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

30. Kur'ani, Et-Teube: 102.

31. Kur'ani, El-Ankebut: 7.

që në fillim është i larguar nga hapësira e magfiritit (faljes). Sepse, kur mohon detyrat, lejon haramet (të ndaluarat) dhe guxon ndaj Madhërisë së Zotit; ai nuk do të korrë, vetëm se një të ardhme të zyrtë!

Ka thirrës që janë mjekues plagësh dhe i dëshirojnë shërimin të sëmurit. Ia shtrojnë rrugën e hajrit (të mirës) me lule dhe i buzëqeshin çdokujt që shkel në ato rrugë. Nëse dikujt i rrëshqet këmba e ndihmojnë për t'u ngritur dhe ia ndreqin gjendjen, derisa të rinisë sërish rrugëtimin, krenar dhe i mbrojtur.

Por, ka edhe të tjerë thirrës, që nuk dëgjon prej tyre, veçse mjerim, kërcënim dhe shkatërrim!

Si të thuash, ata a janë më xhelozë për fenë, se sa Zoti i fesë? Apo janë më të mëshirshëm për njerëzit, se sa Zoti i njerëzve?

Mëshirë për krijesat dhe le të kujtojmë transmetimin e butësisë "Njerëzit janë dy llojesh, i sprovuar dhe i shëruar. Prandaj, mëshironi njerëzit e sprovuar dhe falënderoni Allahun për shërimin (shëndetin) tuaj"³².

32. Transmetuar nga Maliku në Muvatta.

MEXH LISET E DHIKRIT

Po qëndroja në bibliotekën time i zhytur në mendime. Pastaj, sytë m'u ndalën tek diçka shumë e vogël mbi fletë. Sikur të ishte thërrime e vogël, ndoshta pastruesja nuk e kishte pastruar si duhet bibliotekën.

Zgjata dorën për ta larguar këtë papastërti, kur thërrimja më doli nga dora dhe fluturoi në ajër. E kuptova se ajo ishte flutur e vogël. Mundet të ketë qenë fjetur, ose duke pushuar dhe kur ka ndjerë gishtat e mi se po e prekin ka fluturuar! Por, unë nuk i shikoja krahët e saj. Ato krahë, pothuajse nuk i duken! Bile, nuk e di se ku e kishte kokën e ku e kishte bishtin. Aparatin e jetës së saj nuk mund ta shikojë njeriu!

Por, atë mund ta shikojë Krijuesi i saj, që e ushqen, i jep të pijë dhe i jep jetën!

Në kokë më vluan mendimet. Ai, i Cili u ka dhënë jetë këtyre fluturave dhe i ka lëshuar në ajër, nuk e ka penguar kujdesi ndaj tyre nga çështjet e qiellit. Ai, në të njëjtën kohë që frymëzon fluturat për të fluturuar, frymëzon trupat qiellorë të rrotullohen në orbitat e tyre, që nuk devijojnë e as nuk ndalen! Atë nuk e pengon asnjë çështje, ndaj një çështjeje tjetër. Ai "E di çfarë hyn në tokë dhe çfarë del prej saj, çfarë zbret prej qiellit dhe çfarë ngjitet në të. Ai është

Mëshiruesi, Falësi"³³.

U ktheva duke pyetur veten: Përse m'u duk e vogël puna e fluturës?!

Virusi i AIDS-it është 70 mijë herë më i vogël se ajo dhe megjithatë, ai dhe shokët e tij hynë në trupin e të shthururve, i pushton dhe i shkakton vdekjen duke sfiduar shkencën dhe rraskapitur mjekët!?

Sa nevojtar jemi ne njerëzit për të medituar në krijesat e Allahut dhe për të nxjerrë cilësitë e Krijuesit nga shpikjet (krijimet) e Tij në univers, çfarë kemi në duar, çfarë na rrethon dhe çfarë kemi poshtë këmbëve tona!

Çfarë do të na gjente sikur të uleshim e të bisedonim për gjurmët e Allahut në krijesa, për robërit e Tij. Këto janë mexhliset e dhikrit, për të cilat kërkojnë melekët, marrin pjesë në to dhe mahniten e janë të gëzuar!

Në një hadith kudsij transmetohet se: "Allahu ka disa melekë që sillen rrugëve duke kërkuar për njerëzit e dhikrit, e kur ata gjejnë njerëz duke përmendur Allahun, thërrasin njëri-tjetrin: Ejani tek nevoja juaj!

Pejgamberi (a.s) tha: I mbartin me krahët e tyre për në qiellin e dynjasë!

Zoti i tyre i pyet, e (Ai e di më mirë se ata): Çfarë thonë robërit e Mi?

- Të lavdërojnë, të madhërojnë, të falënderojnë dhe të shenjtërojnë!

- A më kanë parë?

- Jo, pasha Allahun, nuk të kanë parë!

- Po sikur të më kishin parë?

- Sikur të të kishin parë, do të kishin adhuruar edhe më

33. Kur'ani, Sebe': 3.

shumë! Do të kishin shenjtëruar, do të kishin falënderuar dhe do të kishin lavdëruar më shumë ..."34 etj.

Përpjekjet e meditimeve në njohjen e Allahut janë pamja e parë e adhurimit të saktë: "Ata të cilët e përmendin Allahun, në këmbë, ulur, shtrirë dhe meditojnë në krijimin e qiejve dhe të tokës; Zoti ynë, këto nuk i ke krijuar kot; lavdi të qoftë Ty, na mbro nga dënimi i zjarrit"35.

Dhikri është detyrë mendore serioze e vetëdijshme që lartëson përmendësit nga toka në qiell. Ndërkohë njerëzit sot janë dy grupesh, ateistë që nuk e njohin Allahun dhe nuk e llogarisin se Ai do t'i tubojë në takimin me Të! Dhe, myslimanë që nuk dinë ta bëjnë dhikrin dhe përkujtimin e Zotit të tyre! Njohja e tyre me Allahun është lëvozhgë (sipërfaqësore) që nuk i pastron zemrat e as nuk i edukon njerëzit.

34. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

35. Kur'ani, Ali Imran: 191.

NJERIU, A ËSHTË I LIRË APO I IMPONUAR?

Dikush më pyeti: Njeriu, a është i imponuar, apo i lirë?

E shikova me një shtrëngim të fortë dhe vendosa të përfshihem në përgjigje, ashtu siç ishte përfshirë në natyrshmërinë e tij për këtë pyetje.

I thashë: Njeriu është dy llojesh. Njëri lloj jeton në lindje dhe lloji tjetër në perëndim. I pari është i imponuar, ndërsa tjetri është i lirë!

Burri hapi gojën me një buzëqeshje, e cila ishte tamam si hapja e gojës së përtacëve, dështakëve e llafazanëve, të cilët janë përhapur gjithandej nëpër vendet tona.

Pastaj tha: Çfarë është kjo fjalë? Unë të pyes: A ka njeriu vullnet të lirë dhe aftësi të pavarur, me të cilat vepron çfarë vepron dhe lë çfarë lë, apo është i imponuar?!

I thashë: Të jam përgjigjur! Njeriu në perëndim është i pavarur, ndërsa në lindje është i kolonizuar! Atje ka vullnet dhe mundësi, ndërsa këtu ai s'ka asgjë!

Njëri nga ata që na rrethonin qeshi e tha: Kjo është përgjigje politike!

I thashë: Bile, edhe fetare gjithashtu..!

O ti njeri! Njerëzit në perëndim e kanë ndjerë se kanë mendje dhe menduan me të, deri aty sa kanë zbuluar edhe

metër për të matur mrekullitë e universit.

E kanë ndjerë se kanë vullnet dhe kanë këmbëngulur në të, deri aty sa shtien në dorë fatet e popujve dhe krizat politike.

E kanë ndjerë se kanë mundësi dhe iu vërsulën lindjes e perëndimit e kanë bërë çudira dhe mrekullira.

Ndërsa ne, jemi këta që jemi... prej mijëra e miliona njerëz që bëjnë kallaballëk në këtë tokë, vjen për të pyetur (për të marrë fetva) rreth kësaj dileme, të cilës nuk ia di zgjidhjen.

Vërtet, ky njeri a ka mendje të lirë me të cilën mund të mendojë?

A ka vullnet me të cilin mund të këmbëngulë?

A ka fuqi me të cilën mund të lëvizë?

E, derisa t'ia vërtetojmë këtë gjë, atëherë do të fillojë të mendojë, pastaj të këmbëngulë, pastaj të punojë.

Ndërsa tani, ai me të vërtetë është i imponuar prej këtij njeriut të lirë që është në perëndim.

Sa diferencë e madhe është mes këtyre dy personave!

Njeriu në perëndim u hedh në rrjedhjen e jetës, e kuptoi se ka gjymtyrë e mundet të notojë me to dhe vazhdoi të notojë nëpër rrjedhë, herë në drejtim të saj e herë kundër, derisa arriti në breg.

NUK JANË THIRRËS..!

I kam vështruar disa njerëz në fushën e thirrjes, pastaj shpresoja sikur të ishin zënë me ndonjë profesion tjetër! Nuk e mendoj se profesioni, të cilin e zgjedhin për veten e tyre, do të jetë i lumtur me ta! Nëse feja është lehtësim, ata janë vështirësim dhe nëse ajo është përgëzim, ata janë largim, ndërkohë që njihet në moralin e Pejgamberit (a.s) se, ai ka qenë fytyrëqeshur dhe fytyrëçiltër. Por, këta tipa në tipare i pëlqen dhe në qeniet e tyre janë të egjër.

Gjithë veprimtaria e tyre është disa dispozita dytësore; i japin përparësi një mendimi dhe e mbysin një mendim tjetër. Sikur të ishin treguar të sinqertë në nijetet e tyre me Allahun, do të kishin gjetur një mijë rrugë për t'i shërbyer Islamit, larg këtij debati të zjarhtë.

Mbaj mend se, një ditë u pyeta për një person, që e zë imamin në ruku të rekatit të parë dhe e plotëson rukunë me të, pastaj sigurisht e plotëson tërë namazin, a duhet të shtojë gjë ky person?

Iu përgjigja, pa u vonuar: Jo!

Një njeri me zë të fortë tha: Po, duhet të plotësojë rekatën e parë! E shikova, e ai ishte bërë gati të zhytej në betejë trupore dhe i thashë, duke e anashkaluar komplet çështjen: Ajo që thashë, është mendimi më i pëlqyer, e nëse

dëshiron diçka tjetër, veç këtij mendimi, atëherë je i lirë! E pashë, që kishte dëshirë të konfliktohej, të merrte dhe të jepte, kështu që ika prej aty...

Këta nuk janë as dijetarë (fukaha) e as thirrës dhe feja jonë është shumë e nevojshme për moralin e mirë, horizontin e gjerë dhe maturinë në çështje të fushës së lehtësisë dhe edukatës.

Armiqtë e Islamit kanë shpërthyer atomin dhe zotërojnë armë të tjera, që nuk i dimë dhe, neve nuk na mbetet gjë tjetër, veçse të përsosim idetë, të nxisim mirësinë, ta shpалosim të vërtetën në mënyrat më fisnike dhe kjo është ajo, të cilën e kemi mësuar prej fesë tonë.

Ka edhe diçka tjetër. Jo çdo gjë, që ka kaluar prej historisë sonë, është e vlefshme për t'iu rikthyer dhe të qetësohemi me të. Në historinë tonë të gjatë ka ngërçe të frikshme të përngjashme me ditët tona, të cilat po i jetojmë!

Periodha, në të cilën Bagdadi ra në kthetrat e tatarëve, apo Kudsi në prangat e kryqëzatave, nuk janë pozita të shembullit të mirë. Ato janë periudha, që gjykohen dhe jo të merren si shembuj. Shembulli merret prej shekujve më të mirë dhe prej njerëzve më të mëdhenj, pasues të zotërisë së Mesazhit madhështor. Kam parë njerëz, që ngatërrojnë ditët e ëmbla me ditët e hidhura të historisë sonë dhe thërrasin për t'iu kthyer së kaluarës dhe kaq!

Përpara nesh janë Libri (Kur'ani) e Suneti dhe imazhi i Islamit në to është i qartë, prandaj puna më e mirë me këto të dyja është të gjemë mirëkuptimin dhe dashurinë! Përndryshe i kemi braktisur dhe, dështimet, të cilat myslimanët i kanë kaluar gjatë historisë së afërt dhe të largët, duhet t'ua studiojmë shkaqet e tyre dhe t'i vendosim në mikroskop për të zbuluar edhe mikrobet më të vogla,

pastaj të marrim masat mbrojtëse ndaj tyre dhe kështu të ndërtojmë një të ardhme më fisnike.

Kam parë disa njerëz, që konsiderojnë breza të mirë të mëparshëm (selef salih), gjyshërit e tyre të afërt dhe mendojnë se biografia e tyre në fé dhe në këtë botë, ajo është shembulli më i lartë. Jo! Brezat tanë të mirë (selefuna es-salih) janë ata, ndërtuesit e shtetit islam, qytetërimit dhe kulturës së tij të lartë; janë ata, rrënuesit e së kotës, duke e lënë atë të gjejë vrimë për t'u futur, nga lindja në perëndim.

NUK KA NGATËRRIM MES AJETEVE...

Nuk lejohet ngatërrimi mes ajeteve, të cilat prezantojnë thirrjen dhe, ajeteve, të cilat ndërtojnë shtetin. Ajetet e para i drejtohen (flasin) një mendjeje bosh, që të njohë Zotin, ku ajo ndaj Tij është e paditur dhe mohuese dhe, sapo të udhëzohet me besim, i themi: Jeta ka parime të tjera dhe obligime të reja!

Kur thirret, ai që është bosh nga Islami, i vjen ajeti: "Dhe, thuaj: E vërteta është prej Zotit tuaj, kështu që kush do le të besojë dhe kush do le të mohojë"³⁶, pas dhunë, detyrim, apo imponim në fé. Nëse preferon të vërtetën dhe hyn në besim, i themi: Ekzistojnë detyra të ndryshme, që i presin besimtarët dhe ata duhet t'i kryejnë, si: "O ju që keni besuar, kijeni frikë Allahun dhe thoni fjalë të duhura (të sakta, të drejta)"³⁷.

Sepse, fjala e duhur, pas zemrës së përkushtuar është baza e moralit të myslimanit. Ashtu siç u thuhet në përgjithësi myslimanëve: "O ju që keni besuar, përkuluni (bëni ruku), bini në sexhde, adhuronit Zotin tuaj dhe bëni vepra të mira, që të shpëtoni"³⁸.

Shoqëria myslimane është familje blete rreth xhamisë, i

36. Kur'ani, El-Kehf: 19.

37. Kur'ani, El-Ahzab: 70.

38. Kur'ani, El-Haxh: 77.

përgjigjet thirrjes së saj, kohë pas kohe, duke kryer detyrat ndaj Allahut, ashtu siç kërkohet prej besimtarëve përgatitja për përballje të armikut të tyre dhe rezistenca ndaj sulmit të tij, i cili nuk rend asnjëherë: "O ju që keni besuar, luftoni ata të cilët janë pranë jush prej jobesimtarëve dhe le të gjejnë tek ju ashpërsi"³⁹.

Ekziston një rrjet urdhrash dhe ndalesash, që ruajnë shoqërinë e brishtë dhe forcojnë strukturën e saj, e nuk pranohet prej askujt të neglizhojë, apo të tejkalojë me to.

Kam parë disa njerëz, që komentojnë: "kush do le të besojë dhe kush do le të mohojë", kush do falet dhe kush do e lë atë, kush do dehet dhe kush do rri esëll!? Kush do ruan nderin dhe kush do shturet!?

Pra, duan një shoqëri rrëmuje, bosh prej të drejtave dhe obligimeve.

Mikrobi i këtij kuptimi është krijuar në mesin e abuzuesve me fenë, të cilët i ka edukuar kolonizatori në vatrën e tij dhe i ka ushqyer pushtimi kulturor me mësimet e veta afetare.

Ky kolonizator, pasi që anuloi dënimet e ndëshkimet dhe mënjanoi sheriatin prej botës së ligjeve, ia mësyu goditjes së akides dhe adhurimeve, moralit të Islamit dhe vlerave të tij! Shpërndau mashtrimet e tij në fushat e arsimit dhe të medias, për të krijuar breza bosh, që nuk njohin të mirën dhe as nuk refuzojnë të keqen.

Kemi dëgjuar thirrje perëndimore, që thonë: Nuk duam Islam politik!

Po, çfarë doni?

39. Kur'ani, Et-Teube: 123.

DUAM ISLAM SHPIRTËROR DHE KAQ!

Në të vërtetë, ata refuzojnë Islamin komplet, duke filluar nga Fjala e teuhidit (njësimit) deri te largimi i pengesave nga rruga!

Ata duan një Islam, që lejon imoralitetin, dehjen dhe nuk njeh të drejtën e Allahut në asnjë gjë.

Ekziston një besë mes Allahut dhe robërve të Tij, ku Allahu thotë: "Kam urdhëruar". Ndërsa besimtarët thonë: Dëgjuam dhe u bindëm!

Prandaj, kushdo që refuzon dëgjimin dhe bindjen ndaj Allahut, nuk quhet mysliman dhe as nuk e pranojmë në reshtat e besimtarëve.

PARIMET TONA

Ekzistojnë britma të larta rreth sjelljeve seksuale të banorëve të globit, e unë në emër të Islamit dhe ndoshta në emër të feve qiellore mbarë, po paraqes këto parime, si rregulla të konferencës , që do të trajtojë ecurinë e këtyre sjelljeve të tronditura:

1- Njeriu është pronar i trupit dhe është prej të drejtës së tij të bëjë me të çfarë të dojë, ashtu siç thonë shumica e laikëve, por ne kujtojmë se Allahu është Pronari i Parë i Vërtetë i këtij trupi, sepse Ai është Krijuesi i tij, Kujdestari i kësaj çështje, Burimi i legjislacionit, i cili i bën dobi, e lartëson dhe e pastron, e nuk pranojmë absolutisht asnjë debat në këtë të drejtë!

2- Shtrati bashkëshortor është i vetmi takim i pranueshëm mes burrit dhe gruas, e përveç kësaj është gjynah. Marrëdhëniet intime janë mbështetje e shtëpisë së ndershme dhe edukim moral për çfarë dhuron Allahu prej fëmijëve. Martesa me motivet e dëlirësisë dhe me përkujdesjen e lindshmërisë është adhurim (ibadet) prej adhurimeve më të pastra, kështu që duhet të krijohen kushte lehtësuese dhe të largohet çdo pengesë përpara saj.

3- Prostitucioni, homoseksualizmi, lezbizmi dhe të gjitha ndyrësitë epshore janë ndalesa të refuzuara. Legjitimiteti i

tyre është luftë ndaj Zotit, zullum ndaj natyrës së origjinës dhe shkatërrim për shoqërinë.

4- Lejohet për rrethana të veçanta largimi (moskryerja e marrëdhënieve intime) në periudhën e shtatzënisë dhe vlerësimi u lihet bashkëshortëve.

5- Origjina e abortit është se ai konsiderohet krim dhe asnjë mjek nuk i drejtohet atij, veçse për të mbrojtur jetën e nënës.

6- Krijuesi i kësaj toke ka vendosur në të aq sa të ushqejë banorët e saj, mbi bazën që të bashkëpunojnë forcat për punimin e tokës dhe nxjerrjen e begative të saj. Dhe, kjo tokë mundet të ushqejë shumëfishin e banorëve të saj prezentë, me kusht që të ndalet gjynahu dhe armiqësia, si dhe të bashkëpunojë njerëzia në mirësi e përkushtim.

7- Kur shejtani ia arriti të ndezë luftërat, u shkatërruan qytete e fshatra dhe u ngurtësuan miliona e miliarda për armët e shkatërrimit në masë, ndërkohë që ishte i mundshëm parandalimi i urisë, sikur këto fuqi të shkonin për ushqyerjen e të uriturve.

8- Konferenca e popullsisë, e cila u mbajt në Kajro⁴⁰ nuk solli asnjë fjalë të vetme për ndalimin e devijimeve dhe luftimin e ligjeve, të cilat i rregullojnë këto fenomene negative, por madje doli nga trajtimet e tyre të gjata e të lodhshme, se ajo pranon lirinë seksuale në kufijtë e ndalimit të rrezikut!

Nëse mbrohen prej sëmundjes së AIDS-it dhe të ngjashmeve me të, atëherë nuk ka kufij për këtë liri të ulët! Ashtu siç u duk qartë dëshira e tyre për pakësimin e banorëve të botës së tretë dhe sigurimi i nivelit të lartë të jetesës për botën e parë, e cila sundon tani botën tonë.

40. Konferenca Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin, Kajro 1994.

9- Konferenca e lartpërmendur nuk i ngriti sytë nga qielli asnjë ditë, a thua nuk e njeh Zotin e qiellit? Por, ne si myslimanë besojmë në Zotin e tokës dhe të qiellit, e respektojmë Shpalljen e Tij, të cilën e trashëgoi Nuhu, Ibrahim, Musai, Isai dhe Muhammedi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi ta. E, nëse të tjerët e tradhtojnë fenë e tyre, ne do të mbesim duke i thënë Zotit tonë: "Dëgjuam dhe u bindëm. Faljen Tënde (kërkojmë) o Zoti ynë dhe tek Ti është përfundimi"⁴¹.

41. Kur'ani, El-Bekare: 285.

PËRPARA SE T'I VRASË PERSEKUTIMI

Disa qeveri arabe i urrejnë xhematet islame me një urrejtje të paparë. Torturojnë të akuzuarin dhe akuzojnë të pafajshmin. Kjo rrugë ka nevojë për analizë në dy drejtime: islam dhe qytetërues, sepse është shumë larg së drejtës...!

Unë e di se, tek islamistët ka njerëz që nuk dallojnë detyrimin me vullnetaren, adetin me ibadetin dhe formën me përmbajtjen!

Ashtu siç di, se ka prej tyre që më urrejnë emrin dhe mendimet, por di se në mesin e tyre ka njerëz që Allahu i ka dhënë udhëzimin e mbarësinë dhe me mundin e tyre i shërbejnë Islamit e nuk kërkojnë shpërblim, veçse tek Allahu i Vetëm! Të tillë janë të shumtë, madje masë e madhe!

Mendimi im është se, qeveritë e irrituara duhet të ndjekin shembullin e qeverive evropiane në këtë qëndrim ndaj ekstremistëve. Ato u garantojnë atyre të drejtat e njeriut, mbështesin akuzat në fakte dhe largohen nga torturat e dhunimet.

Në Evropë janë krijuar parti ekstremiste rebeliste që deklarojnë hapur për largimin e arabëve dhe myslimanëve dhe rrethi i mbështetjes së tyre sa vazhdon e rritet. Ndikimi i tyre shtrihet deri te partitë që janë në pushtet! Megjithatë, ata nuk largojnë e nuk persekutojnë njeri...

Atëherë, përse këtyre partive atje u jepet atje e drejta të jetojnë dhe të tilla të drejta konsiderohen shumë, ose mohohen tek ne për partitë e ashtëquajtura islame?

Dr. Ahmed El-Kadirij, në gazetën "Esh-Sherk" ka shkruar: "Revista katolike mesatariste franceze "Golias", në numrin e saj 27-28, boton një studim të qartë, të cilin ajo e quan: "Kthimi i kryqëzatave", duke e vërtetuar me prova, se organizata ekstremiste, e quajtur "Vëllazëria e krishterë" dhe organizata tjetër, e quajtur "Vëllazëria e shenjtit Pjetër" kanë lidhur marrëveshje politike me partinë Fronti i Djathë Patriotik, të cilin e udhëheq Jean Le Pen i njohur për urrejtjen e tij të madhe ndaj Islamit dhe kundërshtimin e tij për emigrantët myslimanë. Këta të gjithë kanë lidhur marrëveshjen e tyre: "Patriotët Katolikë", që është një lloj i partive raciste ekstremiste.

Prifti Lagiri në artikullin e tij të gazetës "Le Monde", 17.8.1990 shkruan se: "Myslimanët, të gjithë janë si gratë, dobësohen nëse sillesh ashpër me ta dhe rebelohen nëse sillesh dobët ndaj tyre". Kështu flet shkrimtari i vëllazërisë katolike!

Ndërsa, organizata e dytë boton revistën me titull: "Rikthim i pushtimit" dhe në numrin e fundit të saj, Bernard Antony shkruan, duke bashkuar në një linjë të vetme mes blasfemisë, nazizmit, komunizmit dhe Islamit.

Më e habitshmja dhe më e papranueshmja është se këto organizata ekstremiste kanë marrë nga presidenti i Zairesë, gjenerali Moboto, një shumë tepër të madhe parashë, si pjesëmarrje nga ana e tij, në ndërtimin e tempullit të ri Benedict, për ndërtimin e të cilit shpenzimet kanë arritur në 20 milion dollarë! Kështu pra, kryqëzatat janë duke u rikthyer!

Tani pyes: A mundet myslimani, në mbretërinë Moboto, të gjejë një rreze drite, apo shprese në jetë? Mbështetja, të cilën e marrin ekstremistët fetarë kudo qofshin, në Izrael, Evropë dhe Amerikë, bën thirrje për meditim të thellë, se si është gjendja në botën arabe? Fushata ka përfshirë të gjithë të njollosurit me ekstremizëm. Madje, rrezja e fushatës ka kapur edhe thirrësit e pafajshëm, dijetarët mesataristë dhe çdokush që thërret për lejimin e hallallit dhe ndalimin e haramit, faljen e namazit dhe ringjalljen e dispozitave të sheriatit, është kthyer në njeri të akuzuar!

Ngatërrimi i letrave në këtë mënyrë është rrëshqitje për tek luftimi i vetë Islamit, neglizhimi i Librit të Allahut, Sunetit të të Dërguarit të Tij dhe pohimi se grupet islame, kushdo qofshin ato, të gjitha janë fjalë që u mungojnë saktësia, ose pakicë që u mungon sinqeriteti. Dhe, ky është zbatim i planit kolonizues që kërkon zbehjen (dobësimin) e rizgjimit islam dhe eliminimin e tij.

Ditën që i riu mysliman i zgjuar e xheloz mungon në arenë, atëherë pushtimi kulturor do të shndërrohet në pushtim ushtarak dhe atëkohë kërkojmë për ndihmën e parë dhe nuk e gjejmë, atë e ka vlarë persekutimi përpara se ta vrasin armiq të safi të Islamit, prej zionëve dhe kryqëzatave!

PËRSE ISLAMI KA POROSITUR PËR NAMAZIN ME XHEMAT DHE KA OBLIGUAR NAMAZIN E XHUMASË?

Namazi është pjesë e aktivitetit islam mbi çdo pëllëmbë toke ku jeton Islami dhe xhamia është tipari i parë i qytetërimit islam në çdo fshat dhe qytet. Kur besimtarët të korrin sukses në ndërtimin e shoqërisë së tyre, larg prej nënçmimit të provokatorëve dhe mashtimit të jobesimtarëve, atëherë ndërtimi i parë që mendojnë për të dhe nxitojnë drejt tij, është falja e namazit, si përgjigje e ajetit: "Të cilët, kur Ne i mundësojmë në tokë, e falin namazin, e japin zekatin, urdhërojnë për mirë dhe ndalojnë nga e keqja".⁴² Disa u përpoqën të hynë në Islam, duke kërkuar të lehtësohen prej namazit, por i Dërguari refuzoi rreptësisht duke thënë: "Nuk ka mirësi në një fé pa namaz"⁴³.

Kur'ani Famëlartë na tregon se, qytetërimet që u zhdukën dhe ato, në të cilat u thanë burimet shpirtërore, e mbizotëruan mbi ta epshet materiale dhe u shkëput me Allahun lidhja e tyre, u ndërpre bereqeti i Tij! Allahu i Madhëruar, në përshkrimin e brezave të shkuara thotë: "E pas tyre erdhën pasardhës, që e humbën namazin dhe

42. Kur'ani, El-Haxh: 41.

43. Bëhet fjalë për delegacionin e fisit Thekif, kur e vizituan Pejgamberin (a.s) në Ramazan, në vitin e nëntë të hixhretit (L.H).

pasuan epshet, e do të shijojnë humbjen”⁴⁴.

Lidhja e dëlirësisë dhe e drejtësisë me namazin është e kuptueshme dhe shtimi i zjarrit epshëror me largimin nga Allahu është realitet, e qytetërimet e zhytura në materializëm nuk do të fitojnë, vetëm se konflikt iluzionist, shkatërrim pas një mirazhi që shkëlqen dhe që nuk ka shpëtim prej tij!

Islami ka këshilluar për të shkuar në xhami pesë herë në ditë dhe myslimanët e kanë zbatuar këtë gjë, derisa Ibn Mes’udi thoshte: Na shikoje neve, saqë askush nuk e linte namazin, veçse ndonjë munafik (hipokrit) që njihej për hipokrizinë e tij, ose ndonjë i sëmurë. Ibn Mes’udi ka thënë: I dërguari i Allahut na ka mësuar sunetet e udhëzimit dhe prej suneteve të udhëzimit është namazi në xhaminë që thërritet ezani.

Duket se armiqtë e Islamit, që në kohën e Shpalljes i ka bezdisur kjo pamje e mahnitshme e përsëritshme, prej mëngjesit deri në mbrëmje; pamja e myslimanëve, ndërkohë që ata vinin prej skajeve të Medinës për tu falur pas Pejgamberit të tyre. Nuk mbaronte një xhemat, derisa fillonte një tjetër: “Me të vërtetë, namazi për besimtarët është obligim i caktuar në kohë.”⁴⁵ dhe, çfarë bënin? Filluan ta shfryjnë urrejtjen e tyre duke u tallur e përqeshur, ndoshta edhe duke qeshur me zë të lartë. Mbanin kuvende kur dëgjonin ezanin dhe krijonin tubime për të bërë komente tallëse e fyerse! kjo është një rrugë e keqe, që mund të lihet. Zbriti Shpallja, duke u kërkuar besimtarëve të shkëputeshin prej këtyre tipave tallës e të mos i zinin miq, kjo është më e pakta që mund të bëhet në këtë drejtim: “O ju që keni besuar, mos i zini, ata të cilët e kanë marrë fenë tuaj tallje

44. Kur’ani, Merjem: 59.

45. Kur’ani, En-Nisa: 103.

e lojë, prej atyre që u është dhënë libri përpara jush dhe jobesimtarët, miq. Kijeni frikë Allahun, nëse jeni besimtarë. E nëse thirrni për namaz, e marrin atë tallje e lojë. Kjo për shkak se ata janë popull, që nuk kuptojnë”⁴⁶.

Çfarë ishte ajo, që i bashkoi çifutët, idhujtarët dhe hipokritët në tallje të fesë së re dhe sharje të dispozitave të saj? Zhytja në mosbesim dhe sfidim!

Pejgamberi (a.s) e urreu, që Islami të ndeshet me këtë tallje, e dispozitat e tij me këtë kotësi dhe që hipokritët të gjenin mbështetje, në mesin e jobesimtarëve duke i ndihmuar ata të fyenin myslimanët me këto mënyra të ulëta, prandaj dhe dërgoi këtë paralajmërim, jehona e të cilit arriti deri te njerëzit, e ua prishi rehatinë e gjumit, tha: “Më vjen ndërmend të urdhëroj për namaz e të fillojë të falet, të urdhëroj dikënd që tu prikë në namaz njerëzve, pastaj të dal me disa njerëz, që mbajnë pishtarë e të shkoj tek ata që nuk prezantojnë namazin e tua djegë shtëpitë e tyre”⁴⁷. Prandaj, dhe namazi më i rëndë për hipokritët, ishte namazi i jaciesë dhe i sabahut! Nuk ka dyshim se, ata janë të nënkuptuar në kërcënimin e mësipërm, sepse çifutët dhe të krishterët, nuk janë të obliguar me namaz.

Kuptimi i hadithit nuk është që t'i tubojë njerëzit për namaz me kërcënim, kjo është e pamundur, sepse masat e besimtarëve, në kërkim të kënaqësisë së Allahut, shkonin me nxitim në xhami, sa herë që dëgjonin ezanin dhe shpresa e tyre ishte kursimi i shpërblimit të madh tek Allahu. Ibn Mes'udi thoshte: “Edhe i sëmuri shkonte, duke e mbajtur përkrahësh deri në xhami dhe njerëzit më të largët ecnin duke shpresuar që çdo hap të shkruhej tek Allahu, e

46. Kur'ani, El-Maide: 57-58.

47. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

kujdeseshin në rregullimin e safeve (rreshtave)".

Por, është në të drejtën e besimtarëve, ndërkohë që po falet një namaz me xhemat në përgjithësi, që të mos tubohet xhemat tjetër kot, të mos krijohen tubime serioze, apo dëfryese dhe të mos bëhet tregti për zhurmë.

Njerëzit e kishin vënë re se, kur ngriheshin komisione bisedimesh për paqe mes egjiptianëve dhe çifutëve, çifutët zgjidhnin ditët e xhuma për negociata, sikur ata e bënë me qëllim prishjen e kohës së xhumasë dhe humbjen e dispozitave të saj!

Kërcënimi për tallësit dhe përqeshësit me djegie të shtëpive, ka lënë gjurmët e tij, e nuk është transmetuar absolutisht asgjë prej Profetit (a.s), apo kohës së Kalifëve Rashidinë, që të ketë ndodhur diçka e tillë. Keqkuptimet e këtij kërcënimi i kemi shpjeguar, siç ka ardhur në Librin Famëlartë, prandaj nuk ka vend për frikësim e të thuhet se Islami urdhëron të digjen ata që mungojnë në namaz.

Umu Derda transmeton, se hyri tek unë Ebu Derda, ndërkohë që ai ishte i zemëruar dhe i thashë: "Çfarë të ka zemëruar?" Tha: "Pasha Allahun, nuk di asgjë prej ymetit të Muhammedit (a.s), përveç se ata falen të tërë".

Enesi transmeton, se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Unë hyj në namaz dhe kam dëshirë ta zgjas atë, dëgjoj të qarat e fëmijës dhe shpejtoj në namaz duke e shkurtuar, duke ditur se sa dhembshuri ka nëna për të qarët e tij"⁴⁸.

Umu Seleme transmeton se Pejgamberi (a.s) pasi jepte selam në namaz, qëndronte për pak çaste dhe mendonim se, Allahu e di më mirë, qëndronte në mënyrë që gratë të largoheshin përpara se burrat të dilnin.

48. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

Ebu Hurejra (r.a) transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: "Safat (rreshtat) më të mirë për burrat janë safi (rreshti) i parë dhe më i keqi i tyre është i fundit, ndërsa safat (rreshtat) më të mirë për gratë janë të fundit dhe më të këqijtë e tyre janë të parët"⁴⁹. Siç duket, cilësimi për keq është për atë që mundohet të përzihet mes dy gjinive! Ndërsa, atij që nuk i shkon në mendje asnjë dyshim, për të nuk ka gjynah, qëllimi është krijimi i ambientit të dëlirë dhe të devotshëm në xhami.

Këto transmetime të pakta prej një shumice sunetesh, që tregojnë se xhamia priste mbarë ymetin dhe largimi i grave prej saj, nuk është njohur tek selefi (brezi) i parë i ymetit, madje shpirti i xhamisë dhe kultura e saj rridhnin përgjatë rrugëve dhe brenda shtëpive.

Nëse xhemati për pesë vaktet e namazeve është sunet i fortë (muekkede), atëherë prezenca në xhuma është farz (obligim) individual për çdo mysliman të aftë. Allahu i Madhëruar thotë: "Kur të thirret për namaz në ditën e xhuma, nxitoni për në përmendjen (dhikrin) e Allahut dhe lini shitblerjen. Kjo është më e mirë për ju, nëse jeni besimtarë".⁵⁰

Abdullah ibn Amër transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: "Xhumanë e prezantojnë tre lloj njerëzish: Një njeri që vjen kot, atij aq i takon prej saj. Një njeri që vjen për tu lutur, ai është një njeri që i ka bërë dua Allahut, nëse do ia jep, e nëse do nuk ia jep. Dhe, një njeri tjetër që vjen në heshtje dhe në prehje, nuk shkapërcen mbi kokat e besimtarëve dhe nuk bezdis askënd, ajo për të është pastrim deri në xhumanë tjetër dhe shtesë tre ditë. Allahu

49. Transmetuar nga Muslimi dhe Ahmedi.

50. Kur'ani, El-Xhumua: 9.

i Madhëruar thotë: "Kush vjen me një të mirë, atij i takon dhjetë të tilla si ajo"⁵¹.⁵²

Ali ibn Ebi Talib (r.a) ndërkohë që po mbante hytbe në minberin e Kufes tha: "Kur është dita e xhuma, shejtanët dalin në mëngjes me flamujt e tyre nëpër tregje dhe i spërkasin njerëzit me pengesa, duke e penguar njeriun prej punës së tij dhe duke e larguar prej obligimit, e i ndalojnë prej xhumasë. Dhe, Melekët dalin herët e ulen në dyert e xhamive, shkruajnë atë njeri që vjen në orën e parë dhe atë njeri që vjen në orën e dytë, derisa të dalë imamë.

Nëse njeriu zë vend, prej ku mund të dëgjojë dhe shikojë, heshtë dhe nuk bën gjëra kot, ka shpërblim dy sevape të mëdha. Nëse mënjanohet dhe zë vend ku nuk dëgjon, heshtë dhe nuk bën veprime kot, ka shpërblim një sevap.

Nëse ulet e zë vend, prej ku mund të dëgjojë dhe shikojë, bën veprime kot dhe nuk heshtë, ka ndëshkim dy gjynahe. E, nëse zë vend, prej ku nuk mund të dëgjojë dhe shikojë, bën veprime kot dhe nuk heshtë, ka ndëshkim një gjynah. Dhe, kush i thotë shokut të tij ditën e xhuma: Hesht, ai ka fol kot, e kush flet kot, ai nuk ka prej xhumasë së tij asgjë (prej sevapit)". Pastaj në fund të hytbes së tij tha: "E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut ta thotë këtë".

Xhumaja është dispozitë që ia kalon aparateve më të mëdha të propagandës, tek të cilat ka arritur bota. Nëse myslimanët janë sot një miliard banorë, atëherë supozohet që të mbajnë çdo javë një milion, apo dy milion hytbe! Del njeriu dhe flet përpara njerëzve me Emrin e Allahut, flet atë që ka për të folur e besimtarët heshtin she dëgjojnë me

51. Kur'ani, El-En'am: 160.

52. Transmetuar na Ebu Davudi.

vëmendje çfarë thotë. Askush e largon vëmendjen prej tij dhe nuk largohet prej vendit, derisa ta dëgjojë komplet hytben e të falë namazin e xhumasë.

Një ymet i tillë me këtë rregull, duhet patjetër të jetë i unifikuar në pamje dhe në formë, të rritet niveli i tij intelektual dhe emocional, e t'i anashkalojë shkaqet e ndarjes dhe të përçarjes.

Urrej që hytbeja të jetë irritim personal, sulm politik, apo komentim i ngjarjeve kalimtare, sepse xhamitë nuk janë ndërtuar për qëllime të tilla. Obligimi i hytbes është ashtu siç ka ardhur në Kur'anin Famëlartë: "Nxitoni për tek përmendja (dhikri) i Allahut"⁵³, dhe përmendja (dhikri) i kërkuar është lidhja e njerëzve me Zotin e tyre, përmes vështimit në horizontet e universit dhe çështjeve të njerëzve, sipas asaj që e ka sqaruar Kur'ani Famëlartë: "Do t'ua shfaqim argumentet tona në horizonte dhe në vetet e tyre, derisa atyre t'u bëhet e qartë se ai është i vërtetë"⁵⁴.

Zgjatja e hytbes nuk është e duhur e as e obliguar. Ebu Vail tregon se, Ammar ibn Jasir na mbajti hytbe, shkurt dhe saktë, e kur zbriti i thamë: Ke mbajtur saktë dhe shkurt, sikur të kishe marrë pak frymë (ta kishe zgjatur)! Tha: Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (a.s) duke thënë: "Zgjatja e namazit të njeriut dhe shkurtimi i hytbes, janë shenja të të kuptuarit të tij, prandaj shkurtojeni hytben dhe zgjateni namazin"⁵⁵.

Pjesa më e madhe e hytbeve të të Dërguarit të Allahut kanë qenë Kur'an Famëlartë, për këtë arsye nuk janë mësuar përmendësh hytbe prej ligjërimit të tij (a.s), përveçse pak. Ummu Hisham bint Harithe ibn En-Nu'man thotë: "Nuk e

53. Kur'ani, El-Xhumua: 9.

54. Kur'ani, Fussilet: 53.

55. Transmetuar nga Ebu Davudi.

kam mësuar përmendësh "Kaf. Pasha Kur'anin Famëlartë",
veçse nga goja e të Dërguarit të Allahut (a.s) ditën e xhuma".
E lexonte atë në minber çdo ditë xhumaje... Pas hixhretit të
Pejgamberit (a.s), llogaritet, se ai ka mbajtur rreth pesëqind
hytbe xhumaje.

QELIZA SHKATËRRIMI DHE PËRÇARJEJE

Ka disa shekuj që myslimanët kanë humbur ndjesinë, se ata janë një ymet që mbart një Mesazh për mbarë botën dhe se, do të pyeten përpara Allahut dhe njerëzve rreth mënyrës së kumtimit të tij! Kanë lënë këtë detyrë dhe janë zënë me kontradikta dytësore, grindje të përgjithshme, ego personale, apo nacionaliste që ia kanë dobësuar fuqinë dhe e kanë poshtëruar.

Gjatë kësaj jave lexova një fetva të imamet të madh, Shejkut të Ez'herit për faljen e namazit, me duar të lidhura, apo të zgjidhura. Rreth kësaj çështje kanë ndryshuar medhhebet e Ehli Sunetit, ashtu siç kanë ndryshuar edhe Shiitët me Sunitët! Shejkhu i madh kishte dhënë fetva për lejin e të dy mënyrave të faljes. Falënderova Allahun që çështja nuk kishte shkuar në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe debati ishte mbyllur në këtë pikë!?

Myslimanët kanë një prirje të çuditshme për debat dhe përçarje, ndërkohë që janë të sëmurë me ftohje, kancer, tumore, obezitet; ashtu siç kanë edhe aftësi të habitshme për të lënë pas dore e për të mos i përfillur shtyllat e fesë. Dhe nuk e di se, deri kur do të vazhdojnë në këtë gjendje?

Por, unë e di se armiqtë e tyre u rrinë në pritë, i perfeksionojnë komplotet dhe kërcënojnë të tashmen dhe

të ardhmen. Ndryshimet në çështjet dytësore u ngjajnë pak a shumë, në një formë apo në një tjetër, ndryshimeve mes konservatorëve dhe liberalëve, apo mes demokratëve dhe republikanëve. Ndryshimet mes këtyre partive perëndimore shuhen përpara çështjeve kombëtare të mëdha; të largët it afrohen dhe tërë populli bëhet një i vetëm.

Ndërsa tek ne myslimanët, çështja ka nevojë për sinqeritet dhe çiltërsi. Jam i mendimit se ndryshimet fikhere (juridike) të vjetra, sa vetë mosha e Islamit, të cilat janë ndryshime larmie, jo ndryshime kundërshtie dhe se të gjithë me mendime të ndryshme e kanë shpërbllimin tek Allahu.

Kur ishim studentë në Ez'her, hanefiu dhe shafiiu faleshin me xhemat edhe pse njëri e konsideronte leximin e Fatisë pas imamet vaxhib (detyrë), ndërsa tjetri atë e konsideronte të ndaluar! Apo, njëri e konsideronte prekjen e një femre si prishje të abdesit, ndërsa tjetri këtë veprim nuk e quante asgjë, pra abdesi vazhdon të jetë i rregullt!!

Shejkh Muhamed Sheltuti dhe Shejkh Muhamed El-Medeniju kanë qenë dy pionierë të tolerancës së bukur. Sepse çdo muxhtehid (interpretues) është i shpërblyer, pa marrë parasysh se ia ka qëlluar, apo ka gabuar dhe shuarja e zjarrit të fitnes (trazirës) në të gjitha ndryshimet medhhebore është i domosdoshëm. Rrethi i gjerë i Islamit duhet t'i përfshijë të gjithë, por aty ka diçka tjetër që e tejkalon dytësoren për në parësore dhe kërkohet tërheqja e vëmendjes prej saj për të mbrojtur ymetin dhe Mesazhin e tij.

Janë shfaqur disa grupime, ashtu siç janë krijuar pushtete mbi baza laike dhe nacionaliste që zyrtohen prej fesë, trashëgimisë dhe vlerës së saj. Njoh komunistë të vjetër që fshihen brenda këtyre udhëheqjeve të reja

duke folur haptazi se ngritja e nivelit të popullit është më i rëndësishëm se sa ringjallja e sheriatit dhe se ecja në anijen e qytetërimit perëndimor është më e vlefshme se sa ringjallja e trashëgimisë islame.

Duke menduar arrita të kuptoj se qeveria e Sudanit luftohet, sepse ajo bën thirrje për ringjalljen e sheriatit islam dhe qeveria e Iranit luftohet, sepse ajo refuzon heqjen e rrobës fetare dhe kapjen për Kur'anin dhe Sunetin.

Siç duket, Perëndimi nuk lëkundet në luftën ndaj Islamit dhe as në mbështetjen e tij të rrymave ateiste, të cilat na i ka krijuar në vendet tona.

Situatat e reja, me të cilat ndeshen myslimanët, na detyrojnë të përcaktojmë qartë parësoret dhe dytësoret në fenë tonë. Pra, të përcaktojmë se çfarë mund të tolerojmë në të dhe çfarë nuk mund të pranojmë ndryshime për të. Ky qëndrim i mbyll rrugën intrigave, mashtrimit dhe manipulimeve të ulëta!

Në kohën tonë ka njerëz që duan të flasin për Islamin dhe kurrë nuk kanë shkelur në xhami, e as që nuk kanë bërë ndonjë punë për Allahun. Ka prej tyre që e shprehin hapur se duhet hedhur pas shpine i tërë fikhu (legjislacioni) islam dhe megjithatë ai thotë se është mysliman e ty të akuzon se ke dalur kundër Islamit.

Jam i mendimit se ka ardhur koha për një marrëveshje të përgjithshme në fushën e dispozitave dytësore dhe për një marrëveshje të përbashkët për mbrojtjen e bazave të fikhut (legjislacionit) në fushën e edukimit, moralit, legjislacionit penal, e ndërkombëtar dhe kushtetues.

Qytetërimi i Perëndimit e urren Zotin dhe largohet prej bisedave për Të dhe prej takimit me Allahun në Ditën e Llogarisë. Ashtu siç urren lidhjen e ligjit me trashëgiminë

fetare në përgjithësi. Ai (Perëndimi) pretendon se është laik për të gjitha fetë pa përjashtim, por kjo është gënjeshtër, sepse ai është aktiv në luftën vetëm ndaj Islamit. Është ngritur shteti çifut mbi rrënojat e arabëve myslimanë, ashtu siç vepron edhe kolonizimi botëror mbi bazën e përhapjes së krishtërimit!? Nuk ka dyshim se kërcënimi i drejtohet Islamit, ymetit dhe zgjimit të tij dhe në qoftë se nuk zgjohemi shpejt, atëherë do të zhdukemi!

RENDJA E ZEMRAVE

Ndjeva një ngushtim në shpirt dhe një luhajtje në mendime! Kuptova se, gjykimi im përmbi çështje të caktuara do të më largojë nga e sakta nëse vazhdoj të jem i burgosuri i kësaj gjendjeje të ulët, kështu që thashë: Të kërkoj falje, o Zot dhe pendohem tek Ti, ndoshta më çlirohet kraharori dhe ekuilibri më rregullohet!

Por, një zë i mekur në shpirt me thotë: Përse të kërkoj falje? Ti nuk ke gabuar në diçka dhe as i ke bërë ndokujt zullum, prandaj rri i qetë..!

Me vete thashë: A duhet të pres derisa të sillem keq, apo të mësyj, pastaj të kërkoj falje?

Gjendja prej të cilës shqetësohesh, ajo është ena, në të cilën lindin të këqijat, pastaj rriten derisa, sapo të vijë rasti për t'u shfaqur, ato lëvizin. Dhe, zemra e ngurtë, ajo është e cila të shtyn, herë drejt të mëdhave, herë drejt ankesave dhe herë drejt padrejtësive ndaj të tjerëve. Nëse ndien se zemra jote ka filluar të ngurtësohet, paraprijë rrezikut dhe përkujto fjalën e Allahut: "Mjerë për njerëzit, që zemrat e tyre janë të ngurta prej përmendjes së Allahut..."⁵⁶.

Allahu e begaton ndonjë prej krijesave të Tij dhe ai i mjeri thotë: Këto janë frytet e gjenialitetit tim, rezultat i

56. Kur'ani, Ez-Zumer: 22.

mundit dhe vendosmërisë sime, e mbushet me mburrje e krenari: "E nëse njeriun e godet ndonjë e keqe, na lutet neve, pastaj nëse ia shndërrojmë në një të mirë prej Nesh thotë: Kjo më është dhënë prej ditorisë, ndërkohë që ajo është sprovë (fitne), por shumica e tyre nuk e dinë. Atë e kanë thënë edhe të tjerët përpara tyre, e asgjë nuk u bëri dobi prej asaj që kanë punuar".⁵⁷ Prandaj, le t'i shikojë njeriu punët e tij të brendshme, sepse fesadi i jashtëm, pjesa më e madhe e tij, vjen prej prishjes së brendshme...

Në librat e hidithit, transmetohet se një njeriu të ditor, i erdhi një kriminel, që e kishte bërë zakon të vriste dhe e pyeti: A ka pendim për mua? I ditori iu përgjigj: Kush të pengon prej pendimit? Lëshoje tokën tënde, në të cilën jeton dhe shko te një tokë e mirë, të të ndihmojë që të drejtohesh! Njeriu u drejtua për te fshati, i cili do ta ndihmonte drejt përkushtimit ndaj Allahut.

Por, vdekja e tij e zuri në rrugë! Thuhet se, kur e ndjeu se po i afrohet exheli, filloi të bëjë me gjoks përpara, por exheli nxitoi. Pejgamberi (a.s) tha: "Për të, debatuan melekët e mëshirës dhe melekët e dënimit. Melekët e mëshirës thanë: Ai ka ardhur i penduar, me zemër të drejtuar nga Allahu (xh.sh). Melekët e dënimit thanë: Ai nuk ka punuar kurrë asnjë të mirë! Ndërkohë vjen një melek tjetër në formën e një njeriu. E bënë gjykatës mes tyre. Ai tha: Matni distancën mes dy tokave dhe në cilën prej tyre ka qenë më afër, ai i përket asaj. E matën dhe e gjetën më afër tokës, për të cilën ishte nisur, me një pëllëmbë, e kështu e morën melekët e mëshirës..!

Një pëllëmbë e vetme përcaktoi përfundimin e tij! Nuk ishte këmbë që lëvizte, por ishte përpjekje zemre e një të

57. Kur'ani, Ez-Zumer: 49-50.

penduari, që vdiq rrugës duke u kthyer për tek Allahu. E bëri të zotin e saj - e ai po kacafytej me vdekjen - të lëvizte përpara.

Besimtari gjithmonë shikon drejt përsosjes, shqetësohet përherë për të metat dhe nuk prehet në një situatë, nëse mbështet tek ajo, mund të bie në fund. Ndoshta për këtë ka thënë Pejgamberi (a.s): "O ju njerëz, pendohuni tek Allahu, sepse unë pendohem tek Allahu, çdo ditë njëqind herë"⁵⁸.

Kjo është një ftesë aktive për lartësim, për sa kohë jeta ekziston!

58. Transmetuar nga Muslimi.

RRETH KUPTIMIT TË SUNETIT

Një djalë i ri erdhi të më pyeste për një mesele, në një çështje që i interesonte dhe më tha: A është e vërtetë, se ti, kur ke qenë drejtor për xhamitë, i ke këshilluar imamët, ndërkohë që po mbajnë hytben, të mos urdhërojnë askënd që është ulur ndejë në xhami, të mos çohet për të falur dy rekatë namaz, tehijetul-mesxhid (përsëritja e xhamisë), e të mos urdhërojnë për t'u ulur, ata që dëshirojnë t'i falin këto dy rekatë?

I thashë: Po, kush hyn dhe imami po mban hytben, ulet e ne nuk e urdhërojmë për asnjë gjë dhe kush fillon të falë dy rekatë namaz, e lëmë dhe nuk e ndalojmë për të. Nuk dua të nxis përçarje dhe as të ndez fitne!

Tha: Sikur ti, je dakord për lënien e sunetit?

I thashë: Sikur të ishte konfirmuar se ato dy rekatë janë sunet, askush nuk do ta kishte lënë. Imam Maliku dhe Ebu Hanife janë të mendimit se është sunet dëgjimi me vëmendje i hatibit, ndërsa Imam Shafiu dhe Ahmedi mendojnë se është sunet, së pari të falen dy rekatë tehijetul-mesxhid (përsëritja e xhamisë). Kështu që, njerëzit të zgjedhin çfarë të duan!

Tha: Përse i barazove të dy mendimet?

I thashë: 99 % e hytbeve të Pejgamberit (a.s) kanë qenë

Kur'an, që lexohej për namazlitë dhe dëgjimi me vëmendje i tij është vaxhib (detyrë). Imagjino, që i Dërguari i Allahut e urdhëroi atë njeri të falë namaz, pastaj vazhdoi në hytben e tij!? Është e palogjikshme, sepse ne kur mbajmë hytbe besojmë se të gjithë duhet të na dëgjojnë, e jo të na dëgjojnë një pjesë dhe të tjerët të falen! Kush e ka pranuar hadithin e transmetuar për këtë çështje, ka thënë që, ai është sipas shprehjes së juristëve (fukahave) situatë e rastit, apo çështje e veçantë. Ai njeri ishte në një gjendje të dhimbshme dhe Pejgamberi (a.s) kishte dëshirë të tërhiqte vëmendjen e të tjerëve, në mënyrë që t'i jepnin sadaka (lëmoshë), përndryshe urdhri i përgjithshëm është që të pranishmit të dëgjojnë hytben..!

Djaloshi tha: Këto fjalë janë të papranueshme! Nuk i takon Imam Malikut dhe Ebu Hanifes të refuzojnë një sunet të konfirmuar!

I thashë: Nuk ka asnjë mysliman, që refuzon një sunet të konfirmuar. Kundërshtimi a është sunet? I kam lënë të dy mendimet e përhapura ndër njerëz, kush dëshiron falet dhe nuk e urdhëroj të ulet, e kush dëshiron ulet ndenjor dhe nuk e urdhëroj të ngrihet e të falet! Nuk lejoj poterë në xhami! Nëse i Dërguari ynë na ka mësuar se muxhtehidi (interpretuesi) është i shpërblyer, gabo apo ia qëlloi, atëherë përse t'i them atij që mendoj se është i gabuar: Qofsh i mallkuar dhe nuk do të lë ta shikosh mendimin tënd! Unë zbatoj fjalën e Tij (xh.sh): "Dhe, mos u bëni si ata, të cilët u përçanë e u konfliktuan, pasi që u erdhën sqarimet".

Mbeta i befasuar prej djaloshit, që më thoshte: Ju talleni me sunetin!

I thashë: Bashkoju xhematit, në atë që mbledh çështjen e myslimanëve dhe lufto nën flamurin e tyre! Ndërsa,

kur mendimet ndryshojnë, mos përhap fitne dhe mos u bëj fanatik ndaj një medhhebi të veçantë, sepse të tërë myslimanët janë vëllezër!

Një djalë tjetër më tha: Përse i mbani hytбет nëpër xhamia në minbere, që ndoshta ndonjë prej tyre arrin nëntë shkallë, duke ditur se minberi i hytbes në kohën e Pejgamberit (a.s), nuk ka qenë më i lartë se tre këmbë shkallë?

E shikova për pak çaste, pastaj i thashë: E, përse faleni në xhaminë e shtruar me tapet, apo me diçka tjetër, ndërkohë që në kohën e Pejgamberit (a.s) ka qenë e shtruar me rrogoza, apo me dhé?

Transmeton Buhariu se Pejgamberi (a.s) duke kërkuar Natën e Kadrit, ka bërë sexhde në ujë dhe baltë, sepse ra shi dhe xhamia nuk kishte çati, siç ka sot!

Çatia e saj ishte prej degëve të hurmave (palmave), dhe a është sunet t'i heqim tapetat prej xhamive, e t'ia kthejmë degët e hurmave dhe trungjet e tyre?

O ti djalë, e shembuj të tjerë si ti, ju nuk arrini ta kuptoni fenë, e as dynjanë. Mendimet tuaja fëminore për Islamin dhe jetën, nuk i shërbejnë, përveçse armiqve të Islamit. Më ka gëzuar pa masë zgjerimi i fundit i dy Haremeve të Shenjta dhe dëshiroja që mermeri i shtrenjtë t'i kishte shtruar të gjitha Shtëpitë e Allahut, e minberet të lartësoheshin si kulla, duke pushtuar horizontet me tekbiere dhe teuhid.

Mirëqenia, madhështia dhe bukuria janë të kërkuara në arkitekturën e objekteve të kultit, shkollat e dijes dhe dispozitat e vërteta. Kur mbaja hytbe në Universitetin e Ez'herit, ndjeja kënaqësi, sepse unë shikoja safat (rreshtat) përpara meje dhe e shikoja gjendjen e dëgjuesve!

E megjithatë, kryesorja është sundimi i rrymës së besimit, dëgjimi i të pranishmëve, bashkimi i rreshtave në unitet dhe vëllazëri, si dhe gatishmëria e tyre për sakrificë e vetëmohim. Asgjë prej saj nuk mund të arrihet, vetëm se me gumëzhitjen e Kur'anit në zemra, lidhjen e ymetit me historinë dhe trashëgiminë e vet dhe rendjen e tij në fushat e punës me seriozitet.

Unë shpresoj që myslimanët ta kenë të qartë se çfarë kanë përpara tyre. Ndoshta dikur kemi mbyllur sytë ndaj disa ndasive medhhebore, ndërsa angazhimi i myslimanëve sot, me këto ndasi, nuk ndodh, vetëm se, për llogari të sionizmit dhe kolonizimit.

NË XHAMINË E PEJGAMBERIT (A.S)...

Në xhaminë e Pejgamberit (a.s) kam parë dyndje të mëdha njerëzish që preknin murin e Raudas Sherife, duke dëshiruar që ndonjëri prej tyre ta kalonte gjithë jetën pranë atij muri.

Sikur të dilte Pejgamberi (a.s) i gjallë përpara tyre, patjetër që do ta mohonte atë pamje dhe do ta urrente atë lloj pranie.

Veshja e tyre e lodhur, mungesa e të kuptuarit, duarbosh, humbja e kohës dhe hutimi i gjatë, e bën lidhjen e tyre me të Dërguarin e Allahut më të dobët se sa rrjeta e merimangës.

U thashë: Çfarë përfitoni prej ndenjës afër me të Dërguarin? Dhe, çfarë përfiton ai vetë prej jush?!

Ata, të cilët e kuptojnë Mesazhin e tij dhe e jetojnë atë pas maleve e deteve, janë më të njohur me realitetin e Muhammedit (a.s) sesa ju!

Afërsia shpirtërore dhe mendore, ajo është lidhja e vetme mes Muhammedit (a.s) dhe atyre që i përkasin atij.

E, si mundet prej shpirtrave të sëmurë dhe mendjeve të lehta të lidhen me atë, që ka ardhur për të vendosur në

shpirtra dhe mendje lartësimin (të kuptuarit e drejtë) të fesë dhe të dynjasë?

A, kjo prani është argument i dashurisë dhe mjet i faljes?!!

(nga libri: Fikhus-Sire)

ME SHPIRT TË THYER..!

Shpirtin e kisha të thyer, ndërkohë që po udhëtoja me disa dashamirës drejt Zagrebit për te kampet e refugjatëve të banorëve të Bosnjës dhe Hercegovinës. Isha i mbushur me dhimbje, e nuk kisha nevojë për t'i shtuar më tepër! Por, patjetër duhej kjo vizitë, në mënyrë që myslimanët atje të ndjenin se kanë vëllezër, që i mbështesin dhe u vjen keq për gjendjen e tyre.

Në fillim të rrugës kaluam në një shesh të madh. Në qendër kishte një ndërtesë të madhe dhe shoferi tha: Ky është sheshi i xhamisë!

I thashë: Ku është xhamia?

Tha: Ka qenë këtu dhe Titoja ia shembi katër minaret e shndërroi bazën e xhamisë në muzeum, të cilin po e shohim tani!

Ndjeva një ngushtim që po më mbyste! Thashë, ndërkohë që po mërmërisja: Titoja, i cili vetes ia atribuoi titullin marshall, ai është njëri nga udhëheqësit që refuzoi të aderojë mes fuqive të mëdha, dhe duket se goditja e Islamit është prej dukurive të mosaderimit. Sepse unë, sa herë që shfletoj historinë e ndonjërit prej udhëheqësve të kësaj lëvizjeje, shikoj qëndrimin e tij ndaj Islamit, si mos më keq!

Makina jonë çante rrugën e saj, derisa arritëm në

kampin e refugjatëve. Turmat e burrave dhe të fëmijëve po na prisnin. Çfarë t'u thoja këtyre njerëzve? Me vete kishim disa ëmbëlsira dhe shumë shpejt i përpinë të uriturit. M'u kujtua kur Aisheja, nëna e besimtarëve i dha një gruas një hurmë, me vete kishte dy vajzat e saj dhe gruaja e ndau hurmën në dy pjesë, i dha secilës vajzë nga një gjysmë.

Pashë që disa nëna vepruan kështu e disa të tjera i mundi uria e përpinë atë që morën! Veshur kishin disa rroba të lehta, aq sa kishin mundur të arratiseshin me to prej shtëpive të tyre. Ata kishin filluar të ndjenin frikë prej dimrit që po vinte, duke ditur se temperaturat atje, nganjëherë shkonin deri në 30 gradë nën zero!

U premtuam se do t'u dërgonim batanije për të përballuar të ftohtin.

Ndjeva një urrejtje, që më pushtoi shqisat e mia, ndërkohë që kujtova se Kombet e Bashkuara janë pas gjithë kësaj fatkeqësie. Ato kanë qenë të aftë për ta edukuar egërsinë e serbëve, por me qëllim, nuk e bënë këtë gjë!

A është ky, i pari veprim i tyre?

Që dyzet e pesë vjet më parë, Ez'heri më dërgoi për të jetuar mes refugjatëve palestinezë në Rripin e Gazës, që aq shumë i ngjante natës së shkuar! Turma të mëdha rënkonin dhe përpara tyre nuk kishin, veçse një të ardhme të panjohur. U flisja për një kthim të afërt! Në fakt ndodhi që mijëra hebre rusë e nga gjithë vendet e tjera, erdhën për të zënë vendin nëpër shtëpitë e tyre, si përgatitje për të themelimin e Izraelit të madh!?

Përse të mos e themi hapur: Kartat e të drejtave të njeriut janë të mbrojtura në çdo vend, përveç aty ku gjenden myslimanët?

Myslimanët vetëm, janë të dëbuarit e këtyre organizmave

ndërkombëtarë.

Dhe, ajo që të bën të qeshësh në këtë fatkeqësi, është se Këshilli i Sigurimit vendosi të mos furnizojë me armë asnjërën prej palëve, ndërkohë që ai e dinte se serbët trashëguan një ushtri, prej ushtrive më të forta të Evropës dhe se myslimanët kishin qenë punëtorë dhe bujq, duke mos zotëruar gjë për të mbrojtur veten e tyre. Sapo ndodhi lufta, të gjymtuarit tanë mbushnin sheshet, ndërkohë që armiqtë nënshkruanin kushtet e tyre!

Nëse nuk na kthehet vetëdija jonë fetare, atëherë tragjeditë do të përsëriten në vende të tjera. Prandaj, le të zgjohemi, përpara se të jetë vonë!

SI DHE PËRSE ËSHTË ZGJEDHUR EZANI PËR THIRRJE NË NAMAZ? DHE, PËRSE NUK KA ARDHUR PËRMES SHPALLJES SË DREJTPËRDREJTË?

Nuk di ndonjë fjalë tjetër, që meriton të dëgjohet dhe ia vlen të meditohet në të, se sa fjalët e ezanit. Dhe, nuk gjej ndonjë thirrës tjetër, që të thërrasë në udhëzim, se sa muezini. Fjalët me zë të lartë që ushtojnë në horizonte të përkujtojnë Allahun dhe të drejtat e Tij, të kujtojnë punën për të hirë të së cilës jemi krijuar. Ajo (thirrje) është ftesë për bijtë e Ademit që të njohin rrugën e drejtë e të jenë të patundur në të dhe të kenë kujdes nga rrugët e shtrembërta e të largohen prej tyre.

Kur muezini thotë: "Allahu Ekber, Allahu Ekber" dhe e përforcon duke e përsëritur, sikur ai i thotë njeriut: Mos u sill rreth vetes dhe kujto Atë që të krijoj e të përsosi, e bëje Atë qëllimin jetës, të të begatojë në kohën dhe mundin tënd: "Kush dëshiron shpërblimin e ahiretit, Ne ia shtojmë atij shpërblimin".⁵⁹

Dhe, kur thotë: "Eshhedu en la ilahe il'lallah" (dëshmoj se nuk ka zot tjetër, përveç Allahut) dhe e përsërit edhe një herë tjetër, sikur ai i thotë njeriut: Mos ju frikëso zotëve të tjerë në tokë, të gjitha punët i përkasin vetëm Atij. Tek Ai

59. Kur'ani, Esh-Shura: 20.

përfundojnë dhe nuk ka kush e kundërshton vendimin e Tij. Nuk ka kush e ndalon atë, që Ai jep dhe nuk ka kush të jap diçka, nëse Ai e ndalon, prandaj qëndro krenar dhe mbaje kokën lart, e shko për t'i bërë sexhde Allahut, sepse ti kurrë nuk do të poshtërohesh pas Tij!

E, kur thotë: "Eshhedu enne Muhammeden resulullah" (dëshmoj se Muhammedi është i dërguari i Allahut) dhe e përsërit edhe një herë tjetër, ai pikturon përpara ndërgjegjes tënde pamjen e plotë njerëzore për ta marrë shembull dhe për të pasuar gjurmët e tij. Vetëm Muhammedi është shembulli i mirë në besim, përkushtim, moral dhe rrugën e drejtë.

Kur thotë: "Hajja ales-salah" (eja në namaz) dhe e përsërit edhe një herë tjetër, ai të fton të të nderohesh duke qëndruar përpara duarve të Zotit, që ta lavdërosh me falënderimin e Tij, t'i kërkosht mbështetje shtesë dhe të marrësh pjesë me vëllezërit e besimit në tubimin dhe të dashurit për hir Tijin.

Kur thotë: "Hajja alel-felah" (eja në shpëtim) dhe e përforcon me një herë tjetër, ai të bën me dije për një përpjekje frutdhënëse dhe mundim të mbarë, sepse sa të shumtë janë ata të cilët mbjellin e nuk korrin, apo vrapojnë dhe nuk mbërrijnë! Ndërsa, njerëzit namazli nuk humbasin: "Me të vërtetë Allahu i udhëzon ata të cilët kanë besuar, në rrugën e drejtë".⁶⁰

Dhe, kur thotë për të tretën herë: "Allahu Ekber, Allahu Ekber" (Allahu është më i Madhi), ai përforcon qëllimin e saktë nga kjo jetë dhe përpjekjen e mundimshme gjatë gjithë jetës. Njeriu kur del nga shtëpia për punën e tij dhe për t'ia arritur asaj që mundet prej dobive për veten dhe

60. Kur'ani, El-Haxh: 54.

familjen e tij, ndërkohë buçitja e tekbitit (Allahu Ekber), të cilën e dëgjon e thërret që të ketë për qëllim Zotin e tij, e ta bëjë për Të punën e tij. Dhe, kur e paraqet veten përpara Zotit të tij, do ta gjejë atë të favorizuar e të aftë, ndërsa kush i jep përparësi vetes, do ta humbasë atë: "Mos u bëni si ata që harruan Allahun, e Ai i bëri të harrojnë veten e tyre".⁶¹

Ezani mbyllet me thirrjen e Teuhidit (Njësimit), për t'i rrëzuar idhujtaritë e tëra. Tani bota nuk i përkulet ndonjë idhudhi të gurtë, por ajo i këndon idhujve të gjallë, trupave të frikshëm në botën e pushtetit dhe të pasurisë, rë cilëve njerëzit u frikësohen më shumë se Zotit të zotëve.

Fjalët e ezanit janë platformë e plotë dhe thirrje e kompletuar, të cilat nuk i zëvendëson flaka e zjarrit, tingulli i kampanës, e as ushtria e bririt. Ato janë fjalë prej Zotit të Lartë, që i fton njerëzit të kthehen në origjinën e tyre qiellore të pastër.

Këto fjalë kanë zbritur nga qielli dhe nuk kanë dalë prej tokës. I dëgjuan një grup prej sahabësh në ëndrra të ngjashme dhe dikush nga melekët i shqiptoi ato pas një konference, në të cilën kërkohet, sahabët me të Dërguarin e Allahut (a.s) për mënyrën më të bukur në thirrjen për namaz! Biseda këtu na kthen te përgjigja e mëparshme, se si melekët i afroheshin tokës për të dëgjuar dhikrin (përmendjen) nga përmendësi, ndërkohë që ai me to thërriste Zotin e tij, e na kthen te ndikimi shpirtëror i Muhammedit në sahabët e tij!

Një sahabij e mohoi veten e tij kur ndjeu dallimin e madh mes gjendjes së tij me të Dërguarin e Allahut dhe gjendjes së tij, pasi përzihej me familjen dhe lodhej me shqetësimet e kërkimit të rizikut. Ai mendoi se kishte bërë hipokrizi me këtë ndryshim. Ai me të Dërguarin e Allahut,

61. Kur'ani, El-Hashr: 19.

ishte zemërndriçuar, vërtitej në pozitat e perfeksionit, sikur e shikonte Zotin e tij dhe e ndjente Madhështinë e Tij! Derisa, kur kthehej në shtëpi, në rrugë, tek familja dhe tek njerëzit e lëshonte veten dhe turbullohej! Pejgamberi (a.s) i tha: "Nëse do të qëndronit në këtë gjendje tuajën me mua, do t'ju kishin takuar me duar melekët, por sahata, sahata".

Shumë prej sahabëve qëndronin gjatë në orët e dritësimit, të cilat i bashkonte i zoti i mesazhit të madh dhe triumfonin shpesh ndaj natyrës njerëzore, shqetësimeve të jetës dhe hijeve njerëzore. Në sunet ka ardhue se, Ebu Umejri transmeton nga një prej xhaxhallarëve të ti nga ensarët, se i Dërguari i Allahut u interesua shumë për namazin, si t'i tubojë njerëzit në të? Dikush tha: Të valëvitet një flamur kur hynë koha e namazit, e kur ta shohin, lajmërojnë njëri-tjetrin. Kjo nuk e tërhoqi dhe i kujtuan borinë (bririn) e hebregjeve, që i fryhej për të lajmëruar për faljen e tyre. Edhe kjo nuk e tërhoqi dhe tha: "Kjo i përket jehudive". Dikush i kujtoi kampanën, por ai tha: "Kjo i përket të krishterëve". Abdullah ibn Zejd El-Ensariu u largua dhe ai ishte i preokupuar për shqetësimin e Pejgamberit (a.s), e iu shfaq në ëndërr.

Në transmetim tjetër të hollësishëm, transmetuesi tregon se një ensar shkoi dhe i tha: O i Dërguar i Allahut, unë kur u ktheva në shtëpi dhe pasi vura re shqetësimin tënd, pashë një njeri me dy palë rroba të gjelbërta. U ngrit në këmbë në xhami dhe thirri ezanin, pastaj u ul pak dhe u ngrit përsëri dhe tha të njëjtën gjë, përveçse ai thoshte: "Kad kametis-salah" (filloi falja e namazit). Sikur të mos flasin njerëzit, do të kisha thënë se, isha zgjuar dhe jo në gjumë. I Dërguari i Allahut tha: "Allahu të ka shfaqur diçka të mirë, prandaj urdhëro Bilalin të thërrasë ezanin". Umer ibnul-Khatabi tha: Edhe unë e kam parë atë, të cilën ai ka parë, por kur pashë se ai foli para meje, pata turp. Tha për

të: Meleku, të cilën e pa Umeri u soll nga kibla dhe tha: "Allahu Ekber, Allahu Ekber" dy herë, "Eshhedu el-la ilahe il'lall-llah" dy herë, "Eshhedu enne Muhammeden Resulull-llah" dy herë, "Hajja ales-salah" dy herë, "Hajja alel-felah" dy herë, "Allahu Ekber, Allahu Ekber, La ilahe il'lall-llah", pastaj pushoi një copë herë, më pas u ngrit përsëri në këmbë dhe tha të njëjtën gjë, përveçse shtoi pas "Hajja alel-felah": "Kad kametis-salah, kad kametis-salah". I Dërguari i Allahut (a.s) tha: "Thuaja Bilalit", e Bilali thirri me to; Bilali ka qenë zëbukur dhe muezin i mirë.

Transmetimet dallojnë nga njëri-tjetri me dallime të vogla në disa fjalë, por me përputhjen e të gjithave në origjinën e kësaj ngjarjeje dhe burimin e marrjes.

Ndërkohë që, zhvishem prej ndikimit të asaj që transmetohet, më gjen duke anuar nga dëgjimi i ezanit dhe pasimin e fjalëve të tij që qeta, sepse unë kam dëshirë të udhëhiqem nga mendja dhe jo nga veshi! Ezani më zgjon zemrën time dhe më njeh me Zotin tim në atë mënyrë që harmonizohet me natyrën e shëndoshë. Prej këtui mësojmë, se feja ka pëlqyer për dëgjuesit e ezanit, t'i përsërisin fjalët e tij dhe t'i ngulisë në ndjenjat e tyre.

Ebu Hurejra (r.a) tregon se: Ishim me të Dërguarin e Allahut (a.s), ndërkohë Bilali u ngrit dhe thirri ezanin për namaz, e kur mbaroi, Pejgamberi (a.s) tha: "Kush thotë sikur ky, me bindje, ka hyrë në xhenet"⁶².

Sead inb Ebi Vekasi transmeton se, i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: "Kush thotë kur dëgjon muezinin: Edhe unë dëshmoj se, nuk ka zot tjetër, përveç Allahut, i Vetëm dhe i pa shoq, dhe se Muhammedi është robi dhe i dërguari i Tij. Jam i kënaqur që Allahun kam për Zot, Muhammedin për

62. Transmetuar nga Muslimi.

të dërguar, Islamin për fe, Allahu ia ka falë gjynahun e tij”⁶³. Gjithashtu, Xhabiri tregon se, i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “Kush thotë kur dëgjon thirrjen (ezanin): O Zot i kësaj thirrjeje të plotë dhe i namazit që po falet, jepi Muhammedit lidhjen dhe mirësinë dhe ringjalle o Allah Muhammedin në pozitën, të cilën ia ke premtuar, përveçse ai e ka merituar shefaatin (ndërmjetësimin)”⁶⁴.

Kur njeriu mediton në fjalët e ezanit, gjen se ato janë ajka e shpalljeve qiellore dhe përshkrim i Allahut, që ekziston në saj të vërtetës absolute, të vërtetës e cila nuk ndryshon nga lindja në perëndim!

Çfarë ka pas tekbitit (madhërimit) të Allahut, njësimi (teuhidit) dhe thirrjes së përhershme për adhurim të Tij?

Kjo është një thirrje që qarkullon mbi sipërfaqen e tokës, duke përshkuar meridianët e gjatësisë mbi dete dhe tokë, shoqëruar e tokës në lëvizjen e saj rreth nënës së vet, diellit. Dhe, detyra e madhe e Muhammedit është zbatimi i urdhrit që ka dalë për të: “Lavdëroje (bëji tesbih) me falënderim Zotit tënd, përpara lindjes së diellit dhe përpara perëndimit të tij. Edhe natën lavdëroje (bëji tesbih) dhe skajeve të ditës, ndoshta ti kënaqesh”.⁶⁵

Gjithë universi, jo vetëm toka, mishërohet me zërat e muezinëve, që thërrasin njerëzimi të nxitojnë drejt kënaqësisë së Allahut! Nuk është për tu habitur, që prej dëgjuesit të ezanit është e kërkuar, ndërkohë që jehona e ezanit vazhdon të tingëllojë në veshët e tij, të lutet për njeriun e madh, i cili i udhëzon ata drejt Allahut dhe u prin në siratul-mustekim (rrugën e drejtë! Pasha Allahut, nuk ka dyshim se e meriton të lutemi përherë, që Allahu t’ia

63. Transmetuar nga Muslimi.

64. Transmetuar nga Buhariu.

65. Kur'ani, TaHa: 130.

lartësojë gradën e tij e ta shpërblejë me të mira për hatër të myslimanëve.

Megjithatë, ëndrrat e njerëzve, sado që gjendja e tyre të jetë e përkushtuar, nuk janë burim i shpalljes e as argument, sikur të mos ta kishte miratuar Pejgamberi (a.s) dhe të mos e kishte urdhëruar që të punohet me të, sa herë që kërkohet të punohet me të! Ndoshta, Allahu ka pasur për qëllim qetësinë e Pejgamberit të Tij, se mesazhi i tij ka korrur sukses në formimin e një brezi me faqe të pastër e rrugë të dëlirë, takohen me krijesat e larta, dëgjojnë prej tyre dhe transmetojnë prej tyre. E thamë në përgjigjen e mësipërme, se melekët zbresin ndër besimtarët e drejtë e i frymëzojnë udhëzim, i mbështesin në të vërtetën dhe në zemrat e tyre u hedhin përgëzime: "Ata, të cilët thanë: Zoti ynë është Allahu, pastaj ecën në rrugën e drejtë, mbi ta zbresin melekët, që të mos frikësoheni e të mos hidhëroheni..."⁶⁶

Por, dera e iluzioneve dhe e pretendimeve, patjetër që duhet mbyllur, sepse nuk pranohet asnjë fjalë prej botës së gajbit (të fshehtë), përveçse vetëm nga i pagabuari ! Myslimanët janë të gjithë në konsensus, se Sheriati nuk ka burim tjetër, veçse Librin dhe Sunetin. Ndërkohë, në kohën tonë janë shfaqur bujq, që i kanë hyrë fushës fetare dhe kanë pretenduar se u vjen shpallje, por ilaçi më i mirë për ta është të dërgohen në spitalet e sëmundjeve mendore për marrje e tij!

66. Kur'ani, Fussilet: 30.

SINQERITETI

Islami është bindje në zemër, pastërti në qenie, nder në moral dhe lartësim në udhë, sipas asaj që ka thënë i Dërguari fisnik (a.s): "Allahu i do punët e larta dhe i urren punët e pakuptimta".⁶⁷ Në çdo pëllëmbë të tokës dhe në çdo sekondë të kohës mund ta prezatosh këtë Islam, të nxjerrë nga Libri (Kur'ani), Suneti (tradita profetike), zbatimet e kalifatit të drejtë, interpretimet e imamëve të mëdhenj dhe kuptimet e njerëzve të mençur.

Disa folësa për Islamin janë kritikuar sepse ata i bartin shkencat e tij prej periudhës së mbretërve të provincave, apo mbretërve të memlukëve që nuk dinin as të flisnin, apo politikave të shteteve të vockla, të cilat dolën prej trungut të shtetit abasit, ashtu siç dalin nga trugu i pemës, filiza parazitë, për ta dobësuar, jo për ta fuqizuar atë.

Shembulli në dije dhe qeverisje merret prej brezave të parë, e jo prej brezave të mëvonshëm të përhumur. Kam vënë re disa njerëz që debatojnë ashpër se, konsultimi me njerëzit e ditur dhe ekspertë është thjeshtë informacion dhe jo i detyrueshëm!

Me ironi thashë: Përse atëherë janë quajtur "njerëz të dijes" dhe "ekspertë"? Ka njerëz që qëndrojnë të heshtur e nuk lëvizin aspak, përpara çështjeve të të drejtave të njeriut,

67.Hadith i saktë.

sepse kjo temë nuk njihet në atë çfarë kanë lexuar në libra. Sikur Islami është një terminologji, e cila është shfaqur vetëm në të shkuarën, ndërsa kuptimet, të cilat janë nxjerrë prej Kur'anit Famëllartë dhe janë ngjizur në Sunetin Sherifë, nuk kanë lidhje me to..

Ka edhe diçka tjetër. Nuk ka fé, nëse nuk formohet zemra e përkushtuar dhe mendja besimtare, sepse kush humb ndërgjegjen vigjilente dhe mendimin e zgjuar, nuk ka hajr (mirësi) në të.

Të Dërguarit mbarë ishin të drejtuar nga njeriu; ta drejtojnë e ta edukojnë, larg shkopit të policit. Formuan burra e fëmijë, prodhuan shoqëri të ndritur e të qëndrueshme, në ditën kur pushteti ishte i idhujtarëve të gurit, apo të njeriut. Ata të cilët janë të paaftë të ndërtojnë këtë lloj shoqërie, është e pamundur të ndërtojnë qeveri islame! Dhe, ata që rezistojnë në ndërtimin e kësaj shoqërie, patjetër do t'i përfshijë ligji i Allahut në urbanizimin njerëzor: "E ndërsa shkuma shkon kot, atëherë ajo që i bën dobi njerëzve, do të qëndrojë në tokë"⁶⁸.

Nëse patjetër duhet të pranohet njëfarë dështimi, atëherë unë do preferoja një popull besimtar të suksesshëm në ndërtimin e tij të një qeverisjeje të keqe, të dështuar në largimin e saj! Ose, sipas përshkrimit të dr. Mustafa Mahmud: *"Është më e mirë për Islamit të zërë vend në ndërgjegjen e njerëzve dhe ta drejtojë jetën e tyre, se sa të zënë vend burrat e tij në karriget e pushtetit"*.

Besoj se suksesi i thirrjes (davitit) në përhapjen e singëritetit, mëshirës, bashkëpunimit, rregullimit, pastërtisë, aktivizimit dhe dhënies përparësi tjetrit, është diçka që nuk mund të çmohet. Këto cilësi morale janë djepi i vërtetë për t'u ngritur vetvetiu qeverisja e mirë.

68. Kur'ani, Err-Rrad: 17.

Për sa kohë që vendosëm se qeverisja është pamje e saktë e (gjendjes së) vetë popullit dhe se çështja është ashtu siç e ka thënë Kur'ani Famëllartë: "Kështu Ne i qeverisim disa zullumqarë me disa të tjerë, për shkak të asaj që kanë punuar"⁶⁹.

Kujtoj se një herë takova një person të zjarrtë në përhapjen e thirrjes (davitit), ashtu siç thoshte, por dyshoja në nijetin e tij dhe vendosa ta sprovtoj!

I thashë: A e do famën?

Tha: Përse jo!

- A do të të tregoj për rrugën më të shkurtër (më efikase) të famës?

Tha: Po.

- Shaj femrat dhe guxo të flasësh ndaj pushtetarëve! Dhe, pas kësaj unë të garantoj ty një pozitë te njerëzit dhe një vend në xhehenem!

Tha: Po, përse vendi në xhehenem, ndërkohë që unë them të vërtetën.

- E vërteta, nëse me të nuk merret për qëllim kënaqësia e Allahut, bëhet barrë për të zotin që e ka thënë. Kam lexuar një hadith të saktë, që thotë: "Hipokrizia (dyfytirësia) është shirk".

Tha: A të mahnit ajo çfarë sheh prej shthurjes, fesadit dhe rrëmujës?

- Jo, nuk më mahnit dhe as që luftohet me metodat, të cilat i vepron ti! Edukimi i matur, shpjegimi i vazhdueshëm, këshilla e mirë dhe debati i qeshur, janë më të dobishme për Islamin se sa sharjet dhe armiqësitë. Le të jetë Allahu pas nijetit dhe le ta dish se e ardhmja është në dorën e Tij!

69. Kur'ani, El-E'am: 129.

SUBHANALLAHI VE BIHAMDIHI!

Me vete po thoja: Sikur unë të jem njëqind milje larg planetit të tokës, çfarë do të shikoja dhe çfarë do të dëgjoja?

A do të shoh retë e tymit dhe të pluhurit, të cilat kanë ndotur atmosferën dhe kanë turbulluar tejdukshmërinë e saj?

A do të dëgjoj stuhitë e zhurmshme, që lindin prej mjeteve të transportit dhe të fabrikave, ku zhurmat kanë mbuluar çdo gjë?

E di, se ky planet e ka një exhel (afat) të përcaktuar, por a po e përshpejton dhe po e kërkon shkatërrimin e tij me duart e veta?

Pastaj, çfarë jemi ne në këtë univers të madh?

Kam lexuar se shkencëtarët e hapësirës kanë zbuluar, atë që besojnë se ekziston një vrimë e zezë në një galaktikë të largët, më e madhe se njëqind herë prej çdo vrimë të zezë, që është zbuluar më parë! Radio "Zëri i Amerikës" tregon se shkencëtarët besojnë se kjo vrimë gjigante përfshin një miliard yje! Dhe se, tubimi i yjeve dhe i materieve të tjera në të, formon një qendër të dendur graviteti, që arrin atë fuqi, sa nuk shpëton asgjë prej saj, madje as edhe drita!

Thashë: Nëse kjo vrimë është në një pjesë të universit, atëherë çfarë është universi vetë? Duket se ajo që është mes qiejve dhe tokës është edhe më e mahnitshme se këto të dyja!

Përpara meje m'u hap një horizont i gjerë i mbushur me argumente për madhështinë e Allahut dhe çështjen e Tij të lartë: "Allahu është Ai, i Cili ngrii qiejt pa shtylla që mund t'i shihni, pastaj u lartësua mbi Arsh. Nënshtrori diellin dhe hënën, secili udhëton për një exhel (afat) të përcaktuar. E drejton çështjen dhe i shkoqit argumentet, që ndoshta ju, për takimin me Zotin tuaj, të bindeni".⁷⁰

Ndoshta, rreth vetes mund të shoh turma të pafund njerëzish, e ndoshta shoh kufijtë e tokës, ndërkohë që unë jam brenda një sateliti artificial, por puna nuk është shikimi i njeriut në mesin e miliardave njerëzve!

Me të vërtetë ky njeri, i vetëm është një univers i vogël! Në lëkurën e tij ka njëqind mijë pemë, dua të them njëqind mijë qime, rriten dhe qëmtohen për t'u zëvendësuar me të tjera si këto! Ndoshta qimja është më e thjeshta tek njeriu, kështu që le të shikojmë mijëra e mijëra rruaza të gjakut, që notojnë në damarët e tij. Ato janë rruaza rinovuese, kanë fabrikat e tyre që i ndërtojnë dhe i dërgojnë sipas nevojës. E, le të shikojmë rrjetën e nervave të përhapur në trup. Ato marrin urdhrat, natë-ditë prej trurit, për të cilin njeriu është i paaftë të njohë labirintet e tij të ndërlikuara dhe punët e tij të rëndësishme.

Që nga agimi njerëzor, deri më tani dhe deri sa Allahu ta trashëgojë tokën e çfarë gjendet në të, Zoti ynë e drejton punën e këtyre trupave dhe çfarë ekspozohen prej vështirësive dhe kënaqësive: "Dhe, tek Zoti yt është

70. Kur'ani, Err-Rrad: 2.

përfundimi. Dhe Ai, Vet Ai bën për të qeshur e për të qarë. Dhe Ai, Vet Ai jep vdekje dhe ngjall!"⁷¹

Universi është i madh, siç e ka zbuluar shkenca, por Allahu është më i madh, siç duhet ta ndjejnë shkencëtarët.

Në shoqërinë tonë, ne njerëzit i shikojmë politikanët e mëdhenj, për shembull, të zënë me çështje të mëdha, të pavëmendshëm ndaj vogëlsirave, por Zotin e botëve, asnjë punë nuk e zë ndaj një pune tjetër. Ai dëgjon frymëmarrjen e maces të lënduar dhe e futë atë që e ka ndëshkuar në zjarr, ashtu siç dëgjon lutjet e njerëzve të vuajtur dhe i ndëshkon zullumqarët për shkak të asaj që kanë punuar. Ai dëgjon rënien e gjetheve nga pemët dhe shikon mpiksjet e gjakut në damarë, ashtu siç shikon dhe dëgjon shkretimën e vetëtimës në qiell dhe perëndimin e yllit në hapësirë! "Subhanallahi ve bihamdihi, sa numri i krijesave të Tij, sa të kënaqet Vetë Ai, sa pesha e Arshit të Tij dhe sa boja e fjalëve të Tij!"⁷²

71. Kur'ani, En-Nexh: 42-44.

72. Pjesë e hadithit të transmetuar nga Muslimi.

TË FSHEHTAT E NJERËZVE

A mjafton një eksperiencë e vetme për të zbuluar natyrën e njeriut dhe vendimin për të? Duket se qenia njerëzore është më e ndërlikuar se kaq, ose disa qenie (njerëz) mbesin në provim, një apo dy herë, dhe pas kësaj korrin sukses!

Kam medituarr rreth jetës së Halid Ibn Velidit, e kam parë se ky burrë ka qenë shkak në dështimin e myslimanëve në betejën e Uhudit dhe rënien dëshmorë të shtatëdhjetë trimave, prej më të mirëve të besimtarëve! E, megjithatë, pas kësaj iu hap gjoksi për Islamin dhe udhëhoqi ushtritë myslimane në betejë, që varrosën perandorinë romake, e cila i rezistoi zhdukjes për shekuj me radhë!

Kështu është edhe Amr ibnul-As, i cili hyri vonë në Islam, pak përpara se të çlirohej Meka, e megjithatë çliroi Egjiptin dhe gëzoi me Islam burra e breza të tërë!

Të fshehtat e qenieve (njerëzve) nuk i di askush, përveç Allahut. Ndoshta dikush ngushtohet për një çështje ndaj një çështjeje tjetër, pastaj ditët zbulojnë se në zemrën e tij ka thesare mirësie.

Kjo e vërtetë shfaqet në analizën e Kur'anit Famëlartë ndaj asaj që i goditi myslimanët në Uhud dhe dhimbjes së Pejgamberit (a.s) për shokët e tij të dëmtuar, e zemërimit të tij të madh ndaj idhujtarëve. Allahu i Madhëruar i thotë: "Ty

nuk të përket aspak kjo çështje. Pendohet ndaj tyre, apo i dënon, ata janë zullumqarë. Allahut i përket çfarë është në qiej dhe çfarë është në tokë, falë kë të dojë dhe dënon kë të dojë".⁷³

Shenja e pendimit të disa njerëzve prej armiqve të Islamit, që i luftuan me ashpërsi, përsëritet edhe në betejën e Ahzabit, në fjalën e Allahut (xh.sh): "Prej besimtarëve ka burra që ishin të sinqertë në atë çfarë i prematuan Allahut, disa prej tyre vdiqën dhe disa të tjerë presin..."⁷⁴, pastaj Allahu i Madhëruar thotë: "Për t'i shpërblyer Allahu të sinqertët me sinqeritetin e tyre dhe t'i dënojë hipokritët nëse do, apo t'ia pranojë pendimin atyre..."⁷⁵.

Vërtetë, pas kësaj hynë në Islam njerëz, me gjithë ngushtimin që kishin më parë rreth tij.

Ndoshta disa njerëz vonojnë në përqafimin e të Vërtetës për shkak të ndonjë rëndomësie që i ka rrethuar, prandaj nuk lejohet të na shtyjë kjo gjë për t'u bërë zullum, ndoshta Allahu bën prej tyre ndihmëtarë të fesë së Tij.

Kam vënë re se Allahu i Madhëruar ua ka zgjatur litarin disa lloje njerëzish prej jobesimtarëve, se mos ndalen.

Medito pak rreth fjalës së Allahut për hipokritët: "A nuk e shohin, se ata sprovohen në çdo vit një herë, apo dy herë, pastaj nuk pendohen dhe as nuk përkujtohen (marrin mësim)"⁷⁶? Allahu nuk e diskrediton robin e Tij me të parën herë, por duron ndaj tij dhe i lë afat, ndoshta ai turpërohet dhe pendohet. Nëse këmbëngulë në shtrembërimin e vet, atëherë "shërimi i fundit është djegia", dhe e diskrediton, sepse ai nuk përfitoi prej perdes (mbulimit) që i bëri Allahu

73. Kur'ani, Ali Imran: 128-129.

74. Kur'ani, El-Ahzab: 23.

75. Kur'ani, El-Ahzab: 24.

76. Kur'ani, Et-Teube: 126.

dhe durimit të Tij me të!

Allahu ka pranuar njerëz, që kanë përfituar prej perdes (mbulimit) dhe durimit të Tij, është përmirësuar besimi i tyre dhe gjendjen e kanë rregulluar, ashtu siç është zemëruar ndaj disa të tjerëve, kanë menduar se vonesa është heshtje, lënia afat është neglizhencë dhe kështu kanë vazhduar në rrugën e së keqes deri në fund. Për ta është edhe fjala e Allahut: "Bënë intriga të mëdha, por edhe Ne bëmë komplete ndaj tyre, e ata nuk e ndjenë. Shiko se, si ka qenë ndëshkimi i intrigës së tyre, ku Ne i shkatërroam ata dhe popullin e tyre, të gjithë".⁷⁷

Thirrësit duhet të kenë durim dhe kumtim të mirë, e të mos lejojnë që ndjenjat e zemërimit t'i shtyjnë në fjalë të ashpra dhe mendim të keq. Dhe, le të marrim shembull nga i Dërguari ynë fisnik në kujdesin ndaj njerëzve, keqardhjen për shtrembërimin dhe shpresën në udhëzimin e tyre.

77. Kur'ani, En-Neml: 50-51.

THËNIE TË SHEJKH MUHAMED EL-GAZALIT

"Shumë prej të rinjve mendojnë se devotshmëria është: Shpenzimi i kohës në dëgjimin e hytbeve, ligjëratave fetare dhe vëmendja e lehtë ndaj çështjeve të dynjasë dhe shkencave të jetës.

Islami nuk përfiton asnjë dobi prej kësaj rruge dhe akideja nuk triumfon, nëse anëtarët e tij janë mendjelehtët e indianëve të kuq, sado të jenë me nijete të pastra.

Zotëro, o mysliman, frenat e jetës me dituri dhe aftësi: Që të kesh mundësi të ndihmosh të vërtetën, të cilën e ke përqafuar!"

* * *

"Realiteti i mendimit politik tek shumica e fetarëve karakterizohet nga një neglizhencë e madhe. Ata e shohin fesadin, por nuk njohin shkaqet e tij. E lexojnë historinë, por nuk i zbulojnë mësimet e saj. U thuhet: Ne kemi pasur një të shkuar të lavdishme, por nuk e njohin sekretin e kësaj lavdie. Kemi pësuar disfatë në filan periudhë, por nuk arrijnë ta kuptojnë shkakun e kësaj rënieje. Ndjejnë se bota perëndimore ka arritur shkëlqimin e saj, por nuk studiojnë çfarë ka pas këtij shkëlqimi!"

Nga Kujtimet e Shejkh Muhamed El-Gazalit, "Kissatu hajat"

* * *

"Nuk e di, përse njerëzit nuk fluturojnë drejt Zotit të tyre me krahët e përmallimit, në vend që të shtyhen drejt Tij me kërbagjin e frikës?! Injoranca ndaj Allahut dhe fesë së Tij është shkaku i këtyre ndjenjave të ftohta, apo i këtyre ndjenjave braktisëse - thënë më saktë -; megjithëse njerëzimi kurrë nuk do të gjejë më të mirë për ta dhe më të dhembshur ndaj tyre, se sa Allahun e Madhëruar".

Nga libri "Xheddid hajatek"

* * *

"Kur mbreti diktator gjen dikë, që ia zbukuron politikën e tij dhe kur sunduesi matuf gjen dikë, që e lavdëron për budallallëkun e tij, atëherë kjo është katastrofa që i zhdukë popujt".

* * *

"Çfarë t'u bëjë Allahu arabëve, kur armiqtë e tyre respektojnë fjalët e pejgamberëve të tyre, ndërsa udhëheqësit e arabëve tallen me fjalët e të Dërguarit të tyre?

Çfarë t'u bëjë Allahu arabëve kur armiqtë e tyre i udhëheqin më të aftët dhe më guximtarët në çdo fushë, ndërsa udhëheqësit arabë janë disa përzierje njerëzish që fati i keq i ka bërë të jenë aty ku janë?

Çfarë t'u bëjë Allahu arabëve, nëse ata tallen dhe armiku i tyre e ka seriozisht"?

* * *

"Arabët, më këtë mënyrë, të cilën po jetojnë tani, nuk do të sulmohen vetëm nga jehuditë, por do të sulmohen nga gentë e tokës mbarë!

* * *

"Pas një rrugëtimi të gjatë të njerëzimit, shikoj veten dhe ata që janë përreth meje dhe gjej një ngjashmëri të madhe mes armiqve të parë të Muhamedit (a.s) dhe armiqve të tij të mbramë. Ndërkohë që shoh një ngjashmëri të largët mes pasuesve të parë të Muhamedit (a.s) dhe pasuesve të tij të mbramë".

* * *

"Çdo fetarizëm që braktis diturinë, kundërshton mendimin dhe refuzon marrëveshjet pajtuese të ndershme me jetën, ai është fetarizëm që ka humbur aftësinë e tij për vazhdimësi!"

* * *

"Çdo punë e shoqëruar me injorancë, ose me ekstremizëm e godit Islamin "për vdekje" dhe e bën të zotin e saj, pa e ditur, ndihmëtar të armiqve të kësaj feje".

Nga libri "Min huna"

* * *

"Islami do të qëndrojë mbi sipërfaqen e tokës, për sa kohë që toka bën për jetën dhe ekzistencën dhe për sa kohë që urtësia e Allahut e ka shkruar t'i sprovtojë banorët e saj me të mirë dhe me të keqe.

Ditën që mbaron Islami në këtë botë, kjo botë nuk do të jetë më, sepse dielli do të shuhet, yjet do të shkapërderdhen dhe goditja e fundit do ta palosë mbarë botën!

Prandaj, le të heshtin frikakakët propaganduesit e dështimit dhe le ta dinë se Allahu është më Triumfues për fenë dhe robërit e Tij, se sa ata e mendojnë".

Nga libri "Kadhaiful hakk"

* * *

"Gjysma e fajit për përhapjen e mosbesimit në botë i takon fetarëve që e kanë bërë Zotin të urreyer për krijesat e Tij me keqpërdorimin e sjelljeve dhe fjalëve të tyre".

Nga libri "Xheddid hajatek"

* * *

"Kam lexuar shumë lajme për konferencat arabo-islame që janë mbajtur për zgjidhjen e problemit të Palestinës. I lija gazetatat mënjanë, pastaj me vete pëshpërisja: Ekziston një hap që i paraprin të gjithë kësaj, hap pa të cilin kurrë nuk bëhet: Hyrja e myslimanëve në Islam!

Unë shoh në çdo drejtim neglizhencë të detyrave (farzeve), anim nga epsheet, largim prej vështirësive dhe përgjegjësive, prirje për sipërfaqësoren ndaj të thellave, formave ndaj të vërtetave dhe të gjitha këto shembin atë që është ndërtuar.

Atëherë, si do ta kthesh krenarinë e humbur, apo ta sprapsësh armikun që të ka pushtuar?

Sa të nevojshëm jemi për ta kuptuar paralajmërimin e të Dërguarit fisnik (a.s): "Për ju kam frikë epshet joshëse të barkut, të imoralitetit dhe humbjet e egos"⁷⁸. Nëse ia vëmë veshin këtyre paralajmërimeve, do të largohemi nga rënia, pas së cilën nuk ka, vetëm se humnerë pa fund, në të cilën kanë rënë përpara nesh shpërdoruesit dhe mohuesit".

Nga libri "Kadhaiful hakk"

* * *

"Në historinë tonë, hendeku mes dijes dhe pushtetit është thelluar shumë. Edhe pse një numër i konsiderueshëm prej imamëve dhe dijetarëve e kanë kryer detyrën e tyre si kolosë dhe njerëz madhështorë, ka pasur disa të tjerë, ndoshta më të shumtë në numër, që kanë preferuar të mënjanojnë dhe kanë pëlqyer që ndryshimin e të keqes ta bëjnë me mënyrën më të dobët të besimit (ta mohojnë me zemër të keqen, sipas hadithit - L.H. -).

Ka pasur edhe një grup tjetër, ndoshta shumë më tepër në numër, që ecën pas politikës duke i bërë komplimente asaj. Shijuan prej ëmbëlsirave të tyre dhe heshtën ndaj rrëshqitjeve. Nëse prishen dijetarët dhe udhëheqësit, atëherë ymeti merr rrugën e greminës."

* * *

78.Hadith i saktë.

"Fesadi vjen nga lart dhe zbret poshtë, ndërsa reformimi fillon nga poshtë dhe ngjitet lart!"

* * *

"Islami është dritë në mendim, plotësim në qenie, pastërti në trup, mirësi në punë, sistem që refuzon anarshinë, veprim që lufton përtacinë dhe jetë nxitëse në çdo fushë".

* * *

"Kam vënë re se, pas laikëve në botën islame, qëndrojnë njerëz që nxisin pasuesit e feve të tjera kundër Islamit, u krijojnë justifikime dhe madje u mveshin myslimanëve akuza që nuk i kanë njohur as çifutët e as të krishterët!"

* * *

"Ne nuk mundemi asnjëherë t'i respektojmë ata njerëz që kanë këputur lidhjet e tyre me Allahun dhe e konsiderojnë lidhjen me Të mitologji dhe iluzion.

Ndoshta është e drejta e tyre të jetojnë derisa të kuptojnë dhe t'u jepen mundësitë, njëra pas tjetrës, derisa të arrijnë udhëzimin e tyre e të kthehen tek Zoti.

Por ama, të udhëheqin njerëzimin drejt shkatërrimit në emër të njerëzimit, kjo nuk bën..!"

Nga libri "Rekaizul iman"

* * *

"Nuk ka gjë për mua të qëndroj në kalanë e Ebu Hanifes dhe të flas për sistemin e zekatit, apo të qëndroj në kalanë e Ibn Tejmijes dhe të flas për sistemin e divorcit. Apo të qëndroj në kalanë e Imam Malikut dhe të flas për sistemin e ushqimeve... Etj.

Këta të gjithë kanë qenë burra të mëdhenj të Islamit dhe i kanë shërbyer mesazhit të tij, e nuk ka gjë për mua të përthith mendjet e tyre për ato çështja me të cilat përballem!

Kryesorja tek unë është gjithëpërfshirja e Islamit, jo mendimi medhhebist!"

* * *

"Nuk konsiderohet kthim në Islam të shkruajmë mbi flamuj "Allahu Ekber", por kthim në Islam quhet të mbushim zemrat me "Allahu Ekber" dhe ta bëjmë Atë (Allahu Ekber) motiv të punëve dhe qëllim të jetës sonë!"

* * *

"Revolucionet i projektojnë idealistët, i zbatojnë heronjtë dhe i trashëgojnë mercenarët! Lind pyetja: Sikur idealistët dhe heronjtë të ishin si zemra e një njeriu të vetëm në altruizëm dhe rinovim, a do të kishin pasur vend mercenarët?"

* * *

"I thashë: A e do famën?

Tha: Përse jo!

- A do të të tregoj për rrugën më të shkurtër (më efikase) të famës?

Tha: Po.

- Shaj femrat dhe guxo të flasësh ndaj pushtetarëve!! Dhe, pas kësaj unë të garantoj ty një pozitë te njerëzit dhe një vend në xhehenem!

Tha: Po, përse vendi në xhehenem, ndërkohë që unë them të vërtetën?

- E vërteta, nëse me të nuk merret për qëllim kënaqësia e Allahut, bëhet barrë për të zotin që e ka thënë. Kam lexuar një hadith të saktë, që thotë: "Hipokrizia (dyfytërsia) është shirk".

* * *

"Sikur njeriu të përpiquej të kënaqte Allahun me gjysmën e përpjekjeve, të cilat i shpenzon për të fituar pasuri dhe pozitë në tokë, do të kishte përshkuar distanca të mëdha në rrugën e lartësimit shpirtëror dhe moralor.

Dhe, sikur njeriu të urrente djallin (shejtanin) dhe vesveset e tij me gjysmën e ndjenjave, me të cilat urren dhimbjet dhe armikun, do të kishte fituar pjesë (fat) prej pastërtisë së melekëve.

Allahu mund të pranojë gjysmë përpjekjeje në rrugën e Tij, por Ai nuk pranon gjysmë nijeti! Ose zemra të jetë e singërtë me Të, ose Ai e refuzon të tërën!"

Nga libri "Kadhaiful hakk"

* * *

"Unë i drejtohem myslimanëve në çdo pëllëmbë të tokës islame që të zgjohen prej gjumit dhe të përvishen për të mbrojtur trashëgiminë dhe ekzistencën e tyre. Armiqësitë e vjetra befas janë zgjuar dhe mendojnë se kushtet u ndihmojnë për të na fshirë dhe për ta eliminuar fenë tonë.

Në çdo lagje, apo fushë, në çdo fshat, apo qytet duhet të sillemi rrotull nesh, sepse mund të ketë intriga të planifikuara dhe ne nuk i dimë! Allahu do t'i përkrahë ata që e përkrahin fenë e Tij "Nëse e ndihmoni (fenë e Allahun), Ai ju ndihmon dhe ju forcon këmbët tua".

* * *

"Tragjedia, me të cilën përballemi ne thirrësit në këtë lëmsh të madh në fushën e medias është: Si të bindim një njeri se Islami është shtet, kur ai nuk beson se ai është fe?!

* * *

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

El Gazali, Muhammed

E vërteta e hidhur / Muhammed El Gazali;

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip Lavdrim Hamja;

Redaktor: Muhamed B. Sytari.

- Tiranë: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, 2017

[Pj.] 2, 135 f. ; 13.5 x 20.5 cm.

Titulli në arabisht: El-Hakk el-mur`r.

ISBN 978-9928-194-58-9

1. Feja islame 2. Doktrina fetare

28 -12

“E VËRTETA E HIDHUR 2”

“Nuk konsiderohet kthim në Islam të shkruajmë mbi flamuj “Allahu Ekber”, por kthim në Islam quhet të mbushim zemrat me “Allahu Ekber” dhe ta bëjmë Atë (Allahu Ekber) motiv të punëve dhe qëllim të jetës sonë!

Islami është dritë në mendim, plotësim në qenie, pastërti në trup, mirësi në punë, sistem që refuzon anarshinë, veprim që lufton përtacinë dhe jetë nxitëse në çdo fushë.”

